



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në**

**“Psikologji”**

**Universiteti “Aleksandër Moisiu” ,Durrës**

### Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Eglantina Dervishi

Dr. Eris Dhamo - Greca

**Janar / 2024**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Bachelor në “Psikologji”**

|    |   |  |
|----|---|--|
| 1  | IAL aplikues:   | Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës  |
| 2  | Njësia bazë që e ofron:                                   | Departamenti i Psikologjisë  |
| 3  | Emërtimi i programit të studimit:                         | Bachelor në Psikologji   |
| 4  | Urdhëri/VKM i licencimit:                                 | VKM Nr. 685, date 25.08.2010 (me emërtim Bachelor në Psikologji-Sociologji)  |
| 5  | Urdhëri/VKM i riorganizimit:                              | Vendim Senati Nr.63, date 14.06.2018, Miratuar me shkresë të MASR Nr. Prot. 7238/1, date 31.08.2018                  |
| 6  | Forma e regjistrimit të diplomës:                         | Urdhër QSHA Nr 295, datë 22.10.2020o   |
| 7  | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:                        | -  |
| 8  | Cikli i studimit:   | Cikli i Parë   |
| 9  | Kohëzgjatja e programit të studimit:                      | 3 vite akademike. 6 semestra   |
| 10 | Kreditet në total (ECTS):                                 | 180 kredite (ECTS)   |
| 11 | Forma e studimit:   | Me kohë të plotë   |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër):                                     | Gjuha Shqipe   |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | -  |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):                   | -  |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):                     | -  |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:            | Niveli 6   |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:          | 5 PAE / 1 PAKr   |
| 18 | Numri i studentëve:                                       | Viti akademik 2022-2023, 51 studentë<br>Viti akademik 2021-2022, 44 studentë<br>Viti akademik 2020-2021, 31 studentë |
| 19 | Komente / të tjera:                                       | -  |




## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Publik "Aleksandër Moisiu" në Durrës (UAMD) është hapur në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 801, datë 20.12.2005<sup>1</sup>. Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës është riorganizuar me Vendim Nr. 685, datë 25.08.2019<sup>2</sup>. Ky riorganizim përfshiu krijimin e njësisë kryesore në 5 Fakultete, përkatësisht: Fakulteti i Edukimit, Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Shkencave Politiko-Juridike dhe Fakultetin e Studimeve Profesionale. Fakulteti i Edukimit ka në përbërje të tij 4 njësi bazë, Departamentin e Pedagogjisë, Departamentin e Gjuhëve të Huaja, Departamentin e Sociologjisë dhe Departamentin e Psikologjisë. Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti Publik "Aleksandër Moisiu" në Durrës ka marrë akreditimin institucional me rekomandime me kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh me afat përfundimtar të vlefshmërisë së akreditimit deri më 23.03.2026<sup>3</sup>.

Programi i studimit Bachelor në "Psikologji" i ofruar nga njësia bazë, Departamenti i Psikologjisë është riorganizuar deri në masën 20% duke ndryshuar emërtimin e programit të studimit nga Bachelor në "Psikologji-Sociologji" në Bachelor në "Psikologji" me Vendim Senati Nr.63, date 14.06.2018<sup>4</sup>, miratuar me shkresë të MAS Nr. Prot. 7238/1, datë 31.08.2018<sup>5</sup>. Programi i studimit Bachelor në "**Psikologji**" realizohet me 180 kredite (ECTS), në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohezgjatje normale 3 vite akademike, të ndarë në 6 semestra, në gjuhën shqipe, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Bachelor në "**Psikologji**" dhe rregjistruar në rregjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për Arsimin e Lartë dhe kërkimit shkencor pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) me shkresë Nr. Prot. 2504/177, datë 05.06.2019<sup>6</sup>. Ky program studimi i cili i nënshtrohet procesit të vlerësimit për akreditim për herë të parë, është organizuar sipas ndarjes ku përfshihen lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore/integruese, si dhe lëndët plotësuese dhe detyrime përmbyllëse ku si pjesë e të cilit është provimi final ose punimi i temës së diplomës<sup>7</sup>. Numri i studentëve të rregjistruar në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "**Psikologji**" për vitin akademik 2022 – 2023 është 51 studentë<sup>8</sup>.

<sup>1</sup> Vendim Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu"

<sup>2</sup> Vendim Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës

<sup>3</sup> Vendim Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

<sup>4</sup> Vendim Senati Për riorganizimin e programit Bachelor në "Psikologji - Sociologji" (UAMD)

<sup>5</sup> Shkresë Për miratimin e riorganizimit të programeve të Fakultetit të Edukimit (UAMD)

<sup>6</sup> Urdhër Për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Psikologji", të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës

<sup>7</sup> Evidence 13. Rregullore Bachelor Psikologji

<sup>8</sup> Tabela 21 - Të dhëna studente nga sekretaria.



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi i këtij vlerësimi për programin e studimit të ciklit të parë bachelor në “Psikologji” është vlerësimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”<sup>9</sup>, si dhe në përputhje me Vendimin Nr. 825, datë 24.12.2021 Për disa shtesa dhe Ndryshime në Vendimin Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”<sup>10</sup>. Vlerësimi i programit të studimit është një proces vlerësimi nga ekspertë të jashtëm të përcaktuar me urdhër të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë “Për përcaktimin e Ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit të ciklit të parë, aplikuar nga Universiteti Publik “Aleksandër Moisiu” Durrës. Grupi i vlerësimit të jashtëm i përbërë nga Prof. Asoc. Dr. Eglantina Dervishi dhe Dr. Eris Dhamo/Greca, Msc. Anilda Beqiraj (koordinatore teknike) nisi punën për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të programit të studimit. Raporti përfundimtar do të shërbejë jo vetëm për akreditimin e programit bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve, por gjithashtu informon Universiteti Publik “Aleksandër Moisiu” Durrës, MASR, publikun e gjerë dhe studentët e programit të studimit të ciklit të parë, bachelor në “Psikologji” mbi përmbushjen e standardeve. Përmes këtij raporti njësi kryesore dhe ajo bazë kanë mundësi të identifikojnë prioritetet në drejtim të rritjes dhe zhvillimit, duke e vënë theksin tek përmirësimi i cilësisë në drejtim të një procesi që zhvillon kompetencat profesionale të studentëve. Standartet Shqiptare Shtetërore të Cilësisë<sup>11</sup> dhe Kodin e Cilësisë<sup>12</sup> janë të grupuara në gjashtë fusha kryesore vlerësimi bazuar tek Ofrimi, Organizimi dhe Drejtimi i Programit të Studimit Bachelor; Struktura dhe Përbajtja e Programit të Studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet për Realizimin e Programit të Studimit dhe Mbështetja e Studentëve; Studentët dhe Mbështetja e tyre, Sigurimi i Cilësisë së Programit të Studimit. Vlerësimi i secilës fushe bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve me 4 nivele: a- nuk përmbushen; përmbushen pjesërisht; përmbushen kryesisht; përmbushen plotësisht. Raporti në tërësinë e tij identifikon pikat e forta të programit të studimit bazuar në karakteristikat e praktikës së mirë, pikat e dobëta të cilat prekin çdo fushë, mundësitë që ka në

<sup>9</sup>Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

[https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE\\_djvu.txt](https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt) (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>10</sup> Vendimi Nr. 825, datë 24.12.2021 Për disa shtesa dhe Ndryshime në Vendimin Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë” <https://arsimi.gov.al/vendim-nr-825-date-24-12-2021-per-disa-shtesa-dhe-ndryshime-ne-vendimin-nr-109-date-15-2-2017-te-keshillit-te-ministrave-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-agjencise-se-sigurimit-te-cil-2/>. (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>11</sup> Manual për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017.

<https://www.ascal.al/sq/akreditimi/procedurat-e-vleresimit-dhe-akreditimit> (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>12</sup> Kodi i Cilësisë, miratuar me VKM Nr.531, datë 11.09.2018.

<https://www.ascal.al/media/documents/publikime/Kodi-Cilesise-se-Arsimit-te-Larte.pdf>. (Aksesuar më 09-09-2023).

dispozicion programi në drejtim të avancimit drejt cilësisë dhe pengesat, të cilat mund të vështirësojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara. Mbi bazën e këtyre indikatorëve grupi i vlerësimit të jashëm ka dhënë edhe rekomandimet profesionale që do të shërbejnë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të programit të studimit Bachelor në “Psikologji”.

**Universiteti A. Moisiu, është njohur me DRVJ më datë, 12.12.2023, përmes sistemit AMS, formë zyrtare me shkresë Nr 15/198 prot date 12.12.2023. Universiteti nuk dërgon komente .Në këtë mënyrë DRVJ merr formën përfundimtare si RVJ.**



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Psikologji"

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve  |
|---|---|
| <b>Standardi I.1</b><br><b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b> |   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.  | Universiteti Publik "Aleksandër Moisiu" Durrës është një institucion i arsimit të lartë që vepron në përputhje me vlerat dhe interesat kombëtare. Këtë kontribut të tij në sektorin e arsimit të lartë dhe zhvillimin e shoqërisë e përcakton misioni i tij, siç është përcaktuar në Statutit të Universitetit (2018) <sup>13</sup> . Ky mision përfshin ofrimin e një gamë të gjerë të programeve studimore në nivelet e bachelor, master dhe doktoraturë, ndërsa në fokus të veprimtarisë së tij janë tre shtyllat kryesore: kërkimi shkencor, edukimi, dhe shërbimi ndaj publikut. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji", i zhvilluar nga Departamenti i Psikologjisë (DP) në kuadër të Fakultetit të Edukimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës, është i përshtatur me interesat kombëtare dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë" <sup>14</sup> , si dhe aktet ligjore dhe nënligjore të tjera që janë aplikuar në implementimin e tij si VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" <sup>15</sup> dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019 <sup>16</sup> . Ky program i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" ndjek kornizën konceptuale të programit, e cila ka për qëllim të ofrojë një program mësimor konkurrues, të bazuar në cilësinë |

<sup>13</sup> Evidenca 2. Statuti UAMD 2018.

<sup>14</sup> Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri"

[https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE\\_djvu.txt](https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt) (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>15</sup> VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>16</sup> Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5IZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËE1Yjdi> (Aksesuar më 09-09-2023).

|  |   |
|--|---|
|  | <p>e mësimdhënies dhe kurrikulën bashkohore, me synim të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Republikës së Shqipërisë. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" përfshihet në nivelin 6 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është një program që përgatit studentët në disiplinën e psikologjisë, duke i pajisur ata me njohuri dhe aftësi të nevojshme për të kuptuar, analizuar, dhe trajtuar çështje psikologjike në një kontekst profesional dhe shoqëror. Këtë program e udhëheqin synime të qarta akademike dhe shkencore, duke u përpjekur për të ofruar një platformë të rëndësishme për zhvillimin e kompetencave dhe aftësive profesionale të studentëve në këtë fushë. Ky program synon të përmbushë nevojat e tregut të punës dhe të shoqërisë, duke kualifikuar dhe përgatitur studentët për të kontribuar në sfidat aktuale dhe të ardhshme të fushës së psikologjisë në Republikën e Shqipërisë.</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> | <p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" është i bazuar në qëllimin dhe misionin e Universitetit Publik "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD), dhe operon në përputhje me fushën e veprimtarisë së njësisë bazë që e ofron këtë program studimi, si dhe në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Këto parime dhe udhëzime janë shprehur në Statutin e UAMD, rregulloren e njësisë kryesore<sup>17</sup> dhe bazë<sup>18</sup>, si dhe në rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji"<sup>19</sup>.</p> <p>Ky program studimi zbaton me kujdes lirinë akademike dhe respekton të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve. Kjo zbatohet përmes një politike të brendshme që ka për qëllim të ndërlihdjen midis kompetencave profesionale të studentëve dhe plotësimit të standardeve të përcaktuara për nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve<sup>20</sup>. Gjithashtu, ky program ndjek të gjitha rregullat dhe ligjet e vendosura nga shteti në lidhje me arsimin e lartë.</p> <p>Programet e studimeve të ofruara nga UAMD, përfshirë programin e ciklit të parë Bachelor në "Psikologji", kujdesen</p> |

<sup>17</sup> Evidenca 4. Rregullore e UAMD 2018.

<sup>18</sup> Evidenca 10. Rregullore e Departamentit Psikologji.

<sup>19</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>20</sup> Ligj Nr. 23/2018 Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr. 10 247, Datë 4.3.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve" [http://qsha.gov.al/infos/njesim\\_diplome/ligj\\_23-2018\\_10052018.pdf](http://qsha.gov.al/infos/njesim_diplome/ligj_23-2018_10052018.pdf) (Aksesuar më 09-09-2023).




|  |   |
|--|---|
|  | <p>për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Këto synime janë në përputhje me Planin Strategjik të UAMD-së 2020-2025<sup>21</sup>, si dhe me Planin Strategjik të Njesisë Bazë<sup>22</sup>.</p> <p>Ky program i studimit Bachelor në "Psikologji" është një përpjekje për të përmbushur synimet e mëdha të Universitetit dhe i drejtohet kultivimit të një mjedisi të arsimit të lartë cilësorë, me përparësi të respektimit të traditave dhe vlerave akademike shqiptare.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p> | <p>Universiteti Publik "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) ka hartuar një sërë dokumentash të përcaktuara që synojnë ruajtjen e linjës akademike të tij dhe prioritetet kryesore të zhvillimit. Këto dokumente përfshijnë Strategjinë e Zhvillimit Institucional, Strategjinë e Zhvillimit të Njesisë Bazë, dhe dokumente të tjera relevante si Statuti i UAMD<sup>23</sup>, rregullorja e njesisë kryesore<sup>24</sup>, dhe rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji"<sup>25</sup> etj. Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" ka mbështetur misionin dhe vizionin e saj në katër objektiva strategjike të rëndësishëm<sup>26</sup>:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Ofrimi i një cilësie akademike në nivel kombëtar.</li> <li>Prodhimi i kërkimit shkencor bazik dhe të aplikuar me cilësi të lartë.</li> <li>Forcimi i lidhjeve me tregun e punës.</li> <li>Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit.</li> </ol> <p>Në kontekstin e ndërkombëtarizimit të programeve të studimit<sup>27</sup>, UAMD është duke iu përgjigjur një kërkesë të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë që synon përshtatjen e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri me standardet e EuroPsy. Ky veprim synon të unifikojë programe të cilat janë në përputhje me standardet europiane, duke lehtësuar në këtë mënyrë mobilitetin e studentëve dhe kualifikimin e tyre për studime dhe punësim në vendet e Bashkimit Evropian.</p> |

<sup>21</sup> Evidenca 3. Plani strategjik UAMD 2020-2025.

<sup>22</sup> Evidenca 12. Plani Strategjik Departamenti Psikologji 2020-2025.

<sup>23</sup> Evidenca 2. Statuti UAMD 2018.

<sup>24</sup> Evidenca 7. Rregullore FE.

<sup>25</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>26</sup> Evidenca 12. Plani Strategjik Departamenti Psikologji 2020-2025.

<sup>27</sup> Evidenca 31. Strategjia e Ndërkombëtarizimit UAMD.



|  |  |
|--|--|
|  | <p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" është në përputhje me qëllimin dhe misionin e UAMD dhe është integruar në linjë me fushën e studimit brenda njësisë bazë të tij, Departamentit të Psikologjisë. Gjithashtu, duke pasur parasysh kushtet specifike të zhvillimit të profesioneve psikologjike, ky profil ofron perspektivë të mirë për zhvillim të mëtejshëm dhe kontribut efikas në avancimin e studimeve në nivelin e dytë, në një nga shumë profilet e specializuara të fushës së psikologjisë.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p> | <p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" është Departamenti i Psikologjisë i cili është pjesë e Fakultetit të Edukimit. Ky program është ndryshuar dhe riorganizuar në kuadër të një procesi të përmirësimit të ofrimit të tij. Me Vendimin Senati Nr.63, datë 14.06.2018<sup>28</sup>, programi ka ndryshuar emërtimin e tij nga "Bachelor në Psikologji-Sociologji" në "Bachelor në Psikologji." Ky vendim është miratuar nga MAS me shkresë Prot. 7238/1, datë 31.08.2018<sup>29</sup>.</p> <p>Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e nevojshme në fushën akademike të specializuar për të ofruar një program studimi në atë fushë. Ky fakt është i dëshmuar përmes personelit akademik të angazhuar në zbatimin e programit të studimit, të cilët kanë tituj akademikë dhe grade shkencore<sup>30</sup> në përputhje me ligjet në fuqi<sup>32</sup>.</p> <p>Megjithatë, ndërsa personeli akademik i angazhuar në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" ka tituj akademikë dhe grada shkencore, është e rëndësishme të theksohet se aspektet që lidhen me angazhimin e stafit në profile të afërta ose të ndërmjetme me disiplinën e psikologjisë mund të paraqesin sfida në cilësinë e mësimdhënies<sup>33</sup>. Këto sfida përfshijnë mundësinë që stafi me profile të ndryshme të ketë një përvojë të kufizuar në disiplinën e psikologjisë dhe të jetë më pak i kualifikuar për të mbështetur nevojat e specifika të këtij programi studimi. Kjo mund të rezultojë në rreziqe për</p> |

<sup>28</sup> Vendim Senati Per riorganizimin e programit Bachelor ne "Psikologji - Sociologji" (UAMD)

<sup>29</sup> Shkresë Per miratimin e riorganizimit te programeve te Fakultetit te Edukimit (UAMD)

<sup>30</sup> Evidence46. Personeli akademik me kontratë dhe Ndhimësakademik Departamenti Psikologji.

<sup>31</sup> Evidenca 43. Ngarkesa mësimore e personelit akademik 2018-2023.

<sup>32</sup> Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri"

[https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE\\_djvu.txt](https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt) (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>33</sup> Evidenca 77. Cv stafi akademik I angazhuar ne Bachelor Psikologji 2022-2023.




|  |  |
|--|--|
|  | <p>cilësinë e mësimdhënies dhe për përmbushjen e objektivave të programit studimor.</p> <p>Megjithatë, është vërejtur që programi ka edhe disa sfida në cilësinë e tij, lidhur me kapacitetet e personelit akademik të përfshirë në hartimin e programeve të lëndëve dhe moduleve<sup>34</sup>. Duke iu referuar Ligjit 80/2015 të Arsimit të Lartë, neni 59, pika 3<sup>35</sup> shprehet - <u>“Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i asociuar”. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar”</u>.</p> <p><b><i>GVJ rekomandon</i></b> insitucionin se për të garantuar cilësinë në mësimdhënie dhe për të reduktuar rreziqet e ndonjë cenimi të cilësisë, është e rekomandueshme që institucioni të kujdeset për rekrutimin e stafit akademik që ka kualifikimin akademik, kompetencat dhe njohuritë e nevojshme në fushën e psikologjisë dhe të cilët janë në gjendje të sigurojnë një përvojë të pasur dhe cilësi të lartë në mësimdhënie për studentët e programit. <u>Rekomandohet që njësia bazë të angazhohet maksimalisht në përmbushjen e detyrimit ligjor për hartimin e moduleve dhe lëndëve nga titullarë të kategorisë “Profesor”</u>.</p> <p><i>Ky veprim do të ndihmojë në garantimin e cilësisë së mësimdhënies dhe do të përmbushë detyrimin e ligjor për sigurimin e një kornize akademike cilësore në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji”</i>.</p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të</p> | <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore<sup>36</sup> /bazë<sup>37</sup>, e cila është përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi, dhe përputhet me klasifikimin dhe kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane. Në këtë kontekst, Fakulteti i Edukimit është njësia kryesore që koordinon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në bashkëpunim me njësinë bazë, Departamentin e Psikologjisë. Departamenti i Psikologjisë është përgjegjës për ofrimin e programit të</p>   |

<sup>34</sup> Evidenca 37. Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023 Dp. Psikologji.

<sup>35</sup> Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”  
[https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE\\_djvu.txt](https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt)(Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>36</sup> Evidenca 4. Rregullore e UAMD 2018.

<sup>37</sup> Evidenca 10. Rregullore e Departamentit Psikologji.

|   |  |                                     |                                    |                                     |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>studimit Bachelor në "Psikologji" dhe është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore dhe asaj bazë. Ky program studimi ka kaluar një proces riorganizimi, duke përfshirë ndryshimin e emrit të tij nga "Psikologji-Sociologji" në "Psikologji". Ky riorganizim është bërë në përputhje me vendimet e Senatit të institucionit<sup>38</sup> dhe është miratuar nga MAS<sup>39</sup>. Programi i studimit Bachelor në "Psikologji" ka një strukturë që përfshin 180 kredite ECTS dhe është i organizuar në 6 semestra. Ky program studimi ofrohet në gjuhën shqipe dhe përfundon me dhënien e diplomës "Bachelor në Psikologji," e cila është regjistruar në Rregjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Çertifikatave për Arsimin e Lartë nga QSHA<sup>40,41</sup>. Kështu, programi i studimit Bachelor në "Psikologji" respekton kërkesat për përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe është në përputhje me ligjet dhe udhëzimet vendore dhe evropiane në lidhje me programe të studimit në arsimin e lartë.</p>  |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>GVJ gjykon se përmbushja e standartit është e garantuar me dokumentacionin dhe mekanizmat që rregullojnë veprimtarinë e institucionit. Personeli akademik i programit Bachelor në "Psikologji" ka tituj akademikë dhe grade shkencore në përputhje me ligjet aktuale, megjithatë, mund të ndodhin kufizime në ekspertizën e tyre në disiplinën e psikologjisë, që mund të ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe përmbushjen e objektivave programore. Për të garantuar cilësinë e mësimdhënies, UAMD duhet të përqëndrohet në rekrutimin e stafit akademik me kompetenca të specializuara në psikologji. Gjithashtu, është e rëndësishme që njësia bazë të punojë në hartimin e moduleve dhe lëndëve nga titullarë të kategorisë "Profesor," në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimin të Lartë. Këto veprime do të ndihmojnë në sigurimin e cilësisë së lartë të mësimdhënies dhe në përmbushjen e detyrimeve ligjore për një kornizë akademike cilësore në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" në UAMD. Bazuar në evidencat e mësipërme GVJ gjykon se shkalla e përmbushjes së standartit <u>përmbushet kryesisht.</u></i></p> |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standartit</b></p>                                     | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>   | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |

<sup>38</sup> Vendim Senati Per riorganizimin e programit Bachelor ne "Psikologji - Sociologji" (UAMD)

<sup>39</sup> Shkresë Per miratimin e riorganizimit te programeve te Fakultetit te Edukimit (UAMD)

<sup>40</sup> Urdhër Për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Psikologji", të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës

<sup>41</sup> Evidenca 15. Kodifikimi i programeve UAMD.




|  |  |  |   |  |
|--|--|--|---|--|
|  |  |  | X |  |
|--|--|--|---|--|

| <b>Standardi I.2</b>   |   |
|--|---|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>                    |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> | <p>Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka implementuar një strategji të përpiluar për të siguruar funksionimin e harmonizuar të strukturave të tij, përfshirë njësitë dhe zyrat me natyrë akademike dhe ndihmës akademike, me qëllim të garantimit të një ecurie të suksesshme në të gjitha aspektet e aktivitetit të tij. Ky koordinim i detajuar është bazuar në një gamë dokumentesh zyrtare, duke përfshirë: Statutin<sup>42</sup> dhe Rregullorjën e UAMD-së<sup>43</sup> që caktojnë rregullat dhe strukturën themelore të universitetit. Rregullorjen e njësisë kryesore dhe bazë<sup>44</sup> e cila ofron udhëzime të nevojshme për të ndihmuar njësitë në zbatimin e detyrave të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik. Rregullorjen e programit të studimit<sup>45</sup>, që ndihmon në përcaktimin dhe menaxhimin e procesit mësimor. Në të njëjtën kohë, rregullorja e sekretarisë mësimore<sup>46</sup>, njësia e burimeve njerëzore<sup>47</sup> dhe njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë<sup>48</sup> kanë rol të rëndësishëm në sigurimin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve akademike. Përveç kësaj, njësia bazë dhe strukturat e saj, përfshirë kordinatorin<sup>49</sup> e programit dhe drejtuesin e departamentit, mbajnë përgjegjësi për monitorimin dhe koordinimin e procesit mësimor në kuadër të këtij programi studimi. Për të siguruar bashkëpunimin e mirë brenda institucionit, ekzistojnë një sërë dokumentash që përcaktojnë ndarjen e detyrave midis njësive dhe personelit. Ky koordinim struktural dhe organizativ ka një rol kyç në funksionimin e suksesshëm të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.</p> |

<sup>42</sup> Evidenca 2. Statuti UAMD 2018.

<sup>43</sup> Evidenca 4. Rregullore e UAMD 2018.

<sup>44</sup> Evidenca 10. Rregullore e Departamentit Psikologji.

<sup>45</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>46</sup> Evidenca 92. Rregullore e Sekretarisë.

<sup>47</sup> Evidenca 25. Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

<sup>48</sup> Evidence 17. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.

<sup>49</sup> 133. Përcaktimi i kordinatorëve të Programeve të Studimit Departamenti Psikologji.

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>                         | <p>Për të përmbushur nevojat e procesit mësimor, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka ndërmarrë nisma me qëllim të garantimit të suksesit të aktiviteteve të njësisë të saj. Përmes shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga UAMD, i cili është konfirmuar më pas gjatë takimeve të mbajtura me drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë, si dhe përmes konsultimeve me studentët, evidentohet se në institucion ekzistojnë rreth 143 marrëveshje institucionale të lidhura me institucione në nivel kombëtar<sup>50</sup> dhe ndërkombëtar<sup>51</sup>.</p> <p>Këto marrëveshje janë të orientuara drejt arritjes së objektivave formuese të procesit mësimor dhe kontribuojnë në një ecuri të përmirësuar të veprimtarive arsimore. Vlen të theksohet se këto marrëveshje janë shfrytëzuar me sukses për të promovuar praktikat profesionale, aktivitete ekstrakurrikulare, seanca të hapura me lektorë të ftuar, sesione pune, dhe shanse të ndryshme për mobilitet të stafit<sup>52</sup> dhe studentëve<sup>53</sup>.</p> <p>Bazuar në evidencat e paraqitura<sup>54</sup>, është e qartë se ky model bashkëpunimi ka një ndikim pozitiv në arritjen e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve në UAMD<sup>55, 56, 57</sup>. Ky shembull reflekton përkushtimin e institucionit ndaj përmirësimit të cilësisë së arsimit dhe formimit të studentëve në nivel të lartë akademik dhe profesional.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p> | <p>Në kontekstin e realizimit të programit të studimit Bachelor në "Psikologji", institucioni ka arritur një aspekt shumë të rëndësishëm të bashkëpunimit duke nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione dhe organizata të rëndësishme në fushën e psikologjisë<sup>58</sup>. Këto marrëveshje sigurojnë një burim të vyer për përvojën e studentëve dhe i japin atyre një shans të vërtetë për të njohur kontekstin specifik të punës së një psikologu. Disa nga institucionet dhe organizatat kyçe të përfshira në këto marrëveshje përfshijnë "Qendrën Ditore të Moshuarve" Durrës, e cila ofron një kontekst të rëndësishëm të punës me grupmoshën e moshuar, "Qendrën e Shërbimeve Psikologjike" Durrës; "Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar" Durrës; "Klinikën</p>   |

<sup>50</sup> Evidenca 94. Marrëveshje Bashkëpunimi midis AADF dhe UAMD.

<sup>51</sup> Evidenca 49. Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-së.

<sup>52</sup> Evidenca 64. Mobilitete e Stafit Akademik FE.

<sup>53</sup> Evidenca 62. Shëmbull Aktiviteti Alumni UAMD.

<sup>54</sup> Evidenca 65. Raporti Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.

<sup>55</sup> Evidenca 108. Shëmbuj Aktivitete Promovuese Departamenti Psikologji.

<sup>56</sup> Evidenca 97. Shëmbuj Aktivitetesh të Publikuara në Facebook Departamenti Psikologji.

<sup>57</sup> Evidenca 78. Kalendari I Aktiviteteve të Departamentit të Psikologjisë 2022-2023.

<sup>58</sup> Evidenca 129. Marrëveshje Departamenti Psikologji.

|  |   |
|--|---|
|  | <p>Butterfly"; "Shoqatën Ryder Albania"; "Urdhrin e Psikologëve të Republikës së Shqipërisë"; Qendrën për Zhvillimin Komunitar 'Sot për të Ardhmen', " "Qendrën Rezidenciale" Durrës; Qendrën e Shëndetit Mendor 'Drejt Zhvillimit' Durrës; "Shkollën për Fëmijë me Aftësi të Ndryshme"; "World Vision Albania," etj. Këto marrëveshje u ofrojnë studentëve mundësinë e një njohje të afërt me kontekstin e punës së një psikologu në një gamë të gjerë të konteksteve dhe profileve profesionale. Përmes këtij bashkëpunimi, studentët mund të fitojnë përvojë të çmuar praktike, të njohin më mirë sfidat dhe mundësitë e fushës së tyre dhe të kuptojnë më thellë rolin dhe përgjegjësitë e psikologut në shoqëri. Ky pasurim i përvojës së tyre është i vlefshëm për zhvillimin e tyre profesional dhe për përgatitjen e tyre për sfidat e punës në fushën e psikologjisë.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> | <p>Duke konsideruar dokumentacionin në dispozicion, identifikohet që njësia bazë e UAMD-së është përgjegjëse për monitorimin e ecurisë së përgjithshme të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologjisë." Ky monitorim është kryer përmes disa mekanizmave monitorues të veçantë, përfshirë analizën vjetore të departamentit<sup>59,60</sup> dhe udhëzuesin për praktikën profesionale<sup>61</sup> etj.</p> <p>Në veçanti, Departamenti i Psikologjisë ka dokumentuar dhe bën të qasshme rezultatet e programit të studimit, duke përfshirë përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, aktivitetet e mobilitetit të stafit dhe studentëve në nivel institucional. Kërkimi i fokusuar është kryer në mënyrë të veçantë në lidhje me mobilitetet midis Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) dhe të tjerëve<sup>62</sup>.</p> <p>Megjithatë në bazë të dokumentacionit të prezantuar identifikohet në mënyrë të qartë niveli i përfshirjes së studentëve të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" në këto aktivitete dhe mobilitete të ofruara në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>Institucioni i arsimit të lartë UAMD, duke zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi të qëndrueshme me institucione, kompani, palë të treta, dhe aktorë të biznesit vendas dhe ndërkombëtarë, ka demonstruar një përkushtim të vazhdueshëm ndaj aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe</i></p>   |

<sup>59</sup> Evidence 65. Raporti Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.

<sup>60</sup> Evidenca 102. Miratimi i Raportit të Aktivitetit Vjetor të UAMD.

<sup>61</sup> Evidenca 116. Rregullore e Praktikave Profesionale Departamenti PSikologji 2019.

<sup>62</sup> Evidenca 123. Marrëveshje Bashkëpunimi për Programin Erasmus, UAMD.




|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <i>mobilitetit. GVJ vlerëson se standartet e përmbushura në fushën e vlerësuar, siç është shprehur përmes kriterëve të sipërpërmendura nga vlerësuesit e jashtëm, ka indikatorët e nevojshëm për t'u konsideruar se është përmbushur plotësisht.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | X                            |

|   |                       |                              |                             |                              |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |                       |                              |                             | X                            |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

|  |   |
|--|---|
| <b>Standardi II.1</b>  |   |
| <b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b>  |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe | Departamenti i Psikologjisë ka të përcaktuar në rregulloren e tij <sup>63</sup> përvec të tjerash edhe aspektet që lidhen me elementët përbërës të strukturës së programit Bachelor në “Psikologji” duke u përpjekur të jenë konform Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” <sup>64</sup> duke ofruar programe studimi të organizuara në module dhe vlersuar në kredite, në përputhje me Sistemin European të Trasferimit të Krediteve (ECTS) dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <sup>65</sup> ; <sup>66</sup> . Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në |

<sup>63</sup> Evidenca 10. Rregullore e Departamentit Psikologji.

<sup>64</sup> Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

[https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE\\_djvu.txt](https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt) (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>65</sup> VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>. (Aksesuar më 04-02-2023).

<sup>66</sup> Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

|   |  |
|---|--|
| <p>Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>  | <p>“Psikologji” ofruar nga UAMD realizohet me 180 kredite (ECTS). Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga ana e studentit është 60 ECTS. Programi ofrohet në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohezgjatje normale 3 vite akademike, të ndarë në 6 semestra akademik, në gjuhën shqipe, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Bachelor në “<b>Psikologji</b>”, dhe paisjen me diplomë referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve<sup>67</sup>. Ky program studimi është organizuar sipas ndarjes ku përfshihen lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore/integruese, si dhe lëndët plotësuese dhe detyrime përmbyllëse ku si pjesë e të cilit është provimi final ose punimi i temës së diplomës, konform bazës ligjore në fuqi.</p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | <p>Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh në fushën e psikologjisë. Kjo është në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe vizionin e njësisë bazë<sup>68</sup>, që synon të sigurojë njohuri bazë mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme, si dhe aftësi të caktuara në një gamë të gjerë profesionale dhe specialitetesh. Rregullorja e programit të studimit paracakton misionin e programit Bachelor në "Psikologji" për të ofruar njohuri bazë në fushat që lidhen drejtpërdrejt me shkencën e psikologjisë, si dhe njohuri mbi profilet aktuale të psikologjisë, në kontekstin vendas dhe ndërkombëtar. Synohet që studentët të pajisen me njohuri dhe kompetenca të përgjithshme të një psikologu. Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të planit mësimor<sup>69</sup> të këtij programi studimi, ka një angazhim të njësisë për të përmirësuar këtë program studimi në vijim. Kjo është në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe të ndërkombëtarizimit të programeve, me qëllim të unifikimit me standardet e vendeve të Bashkimit Europian. Për të lehtësuar mobilitetin e studentëve për studime dhe punësim në BE, Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë ka kërkuar unifikimin e programeve me standardet e EuroPsy. Kjo është një nevojë e vazhdueshme dhe kërkon angazhim të të gjitha palëve të përfshira në procesin e përmirësimit të strukturës dhe përmbajtjes së këtij programi studimi. Përfshirja e njësisë në</p> |

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5IZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËE1Yjdi> (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>67</sup> Ligj Nr. 23/2018 Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr. 10 247, Datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” [http://qsha.gov.al/infos/njesim\\_diplome/ligj\\_23-2018\\_10052018.pdf](http://qsha.gov.al/infos/njesim_diplome/ligj_23-2018_10052018.pdf) (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>68</sup> Evidenca 12. Plan Strategjik Departamenti Psikologji 2020-2025.

<sup>69</sup> Evidenca 34. Kurrikula Bachelor Psikologji, Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tcl:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



|   | këto lloj nismash gjykojmë se mund të ketë impakt pozitiv në drejtim të përmirësimit të strukturës dhe përmbajtjes së këtij programi studimi.  |                        |                         |                        |                         |   |            |                     |               |   |                         |                     |               |
|---|--|------------------------|-------------------------|------------------------|-------------------------|---|------------|---------------------|---------------|---|-------------------------|---------------------|---------------|
| <b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Duke iu referuar planit mësimor <sup>70</sup> kemi të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimorë bazuar në Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” <sup>71</sup> ; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <sup>72</sup> dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019 <sup>73</sup> dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021 <sup>74</sup> , përgjithësisht duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe shoqëruar me kredite përkatëse. Ky program studimi është i organizuar në lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore/ integruese, si dhe lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Pjesë e programit është edhe provimi final ose punimi i temës së diplomës, në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë si më poshtë vijon <sup>75</sup> : |                        |                         |                        |                         |   |            |                     |               |   |                         |                     |               |
|   | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Kategor<br/>ia</th> <th>Përshkrimi</th> <th>Sipas<br/>VKM 185, 2021</th> <th>Sipas planit<br/>mësimor</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Lëndë bazë</td> <td>15–20%<br/>(kredite)</td> <td>22% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Lëndë<br/>karakterizuese</td> <td>50–55%<br/>(kredite)</td> <td>47% (kredite)</td> </tr> </tbody> </table>  | Kategor<br>ia          | Përshkrimi              | Sipas<br>VKM 185, 2021 | Sipas planit<br>mësimor | A | Lëndë bazë | 15–20%<br>(kredite) | 22% (kredite) | B | Lëndë<br>karakterizuese | 50–55%<br>(kredite) | 47% (kredite) |
| Kategor<br>ia   | Përshkrimi   | Sipas<br>VKM 185, 2021 | Sipas planit<br>mësimor |                        |                         |   |            |                     |               |   |                         |                     |               |
| A   | Lëndë bazë   | 15–20%<br>(kredite)    | 22% (kredite)           |                        |                         |   |            |                     |               |   |                         |                     |               |
| B   | Lëndë<br>karakterizuese  | 50–55%<br>(kredite)    | 47% (kredite)           |                        |                         |   |            |                     |               |   |                         |                     |               |

<sup>70</sup> Evidenca 34. Kurrikula Bachelor Psikologji, Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

<sup>71</sup> Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

[https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE\\_djvu.txt](https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt) ( Aksesuar më 04-09-2023).

<sup>72</sup> VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> ( Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>73</sup> Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUUyE8ZnNobnxneDo3NzYxM2UeZEHMEEIYjdi> (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>74</sup> Vendim Nr. 185, Datë 25.3.2021 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, “Për Elementet E Programeve Të Studimit Të Ofuara Nga Institucionet E Arsimit Të Lartë”, Të Ndryshuar. <https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofuara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/> (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>75</sup> Evidenca 20. Tabelat ASCAL, Tabela 9, faqja 31.

|  |          |                       |                  |               |
|--|----------|-----------------------|------------------|---------------|
|  | <b>C</b> | Lëndë ndërdisiplinore | 12-15% (kredite) | 14% (kredite) |
|  | <b>D</b> | Lëndë plotësuese      | 10-15% (kredite) | 13% (kredite) |
|  | <b>E</b> | Detyrime përmbyllëse  | 3-5% (kredite)   | 4% (kredite)  |

Krahasimi i krediteve të shprehura në % për çdo kategori të programit të studimit Bachelor në “Psikologji” të paraqitura në Planin Mësimor 2022-2023<sup>76</sup> dhe kreditet e shprehura në % të përcaktuara në VKM Nr.185, datë 25.03.2021<sup>77</sup>, për programet e ciklit të parë, nxjerr në pah se disa të dhëna kanë nevojë të përafrohen me vendimin në fjalë. Shqyrtimi i tyre tregon se për kategorinë A (Lëndë bazë) në planin mësimor të shprehura në përqindje është 22% nga 15-20% (kredite) të lejuara, dhe në kategorinë B - Lëndë karakterizuese në planin mësimor të shprehura në përqindje është 47% nga 50-55% (kredite) të lejuara.

***GVJ** sugjeron njësinë që në vijimësi të punës së nisur për përafrimin e kurrikulës së programit të studimit me standartet shtetërore të cilësisë të përafrojtë edhe përqindjet për komponentin mësimorë të kategorisë A – Lëndë bazë e cila është 22% (kredite), dhe kategorisë B - Lëndë karakterizuese e cila është 47% (kredite).*

|   |   |
|---|---|
| <b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Duke iu referuar kurrikulës mësimore <sup>78</sup> të programit të studimit Bachelor në “Psikologji”, Provimi i formimit/ tema e diplomës është pjesë e “Detyrimeve përmbyllës” si pjesë e kategorisë E, me 7 ECTS, duke përfshirë 45 orë në auditor dhe 175 orë të studimit individual nga ana e studentit. Lënda mësimore “Praktikë profesionale” është pjesë e kategorisë D-tipi i Lëndë Plotësuese, me 13 ECTS, 75 orë në semestër <sup>79</sup> , realizohet në vitin e tretë të studimeve, të shtrirë përgjatë semestrit të dytë akademik. Praktika realizohet në terren me institucionet përkatëse me të cilat UAMD ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në funksion të mbarvajtjes së këtij |
|---|---|

<sup>76</sup> Evidenca 20. Tabelat ASCAL, Tabela 9, faqja 31.

<sup>77</sup> Vendim Nr. 185, Datë 25.3.2021 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, “Për Elementet E Programeve Të Studimit Të Ofruara Nga Institucionet E Arsimit Të Lartë”, Të Ndryshuar. <https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/> (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>78</sup> Evidenca 34. Kurrikula Bachelor Psikologji, Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

<sup>79</sup> Evidence 113. Vendimi nr 26. Për Ndryshimin e Kurrikulave te Programet që ofrojnë Praktikë Mësimore, 2019.

|  |   |
|--|---|
|  | <p>procesi. Duke iu referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit<sup>80</sup> mund të përmendim disa institucione kyçe për profilin e psikologut si "Qendrën Ditore të Moshuarve" Durrës, e cila ofron një kontekst të rëndësishëm të punës me grupmoshën e moshuar, "Qendrën e Shërbimeve Psikologjike" Durrës; "Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar" Durrës; "Klinikën Butterfly"; "Shoqatën Ryder Albania"; "Urdhrin e Psikologëve të Republikës së Shqipërisë"; Qendrën për Zhvillimin Komunitar 'Sot për të Ardhmen', "Qendrën Rezidenciale" Durrës; Qendrën e Shëndetit Mendor 'Drejt Zhvillimit' Durrës; "Shkollën për Fëmijë me Aftësi të Ndryshme"; "Eorld Vision Albania," etj.</p>   |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> | <p>Studimet në programin e ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" të ofruar nga UAMD UniBa mbështeten në 3 dokumente kryesore që janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a) Plani mësimorë<sup>81</sup></li> <li>b) Syllabuset e lëndëve mësimore<sup>82,83</sup></li> <li>c) Rregullorja e programit të studimit<sup>84</sup></li> </ol> <p>Programi është organizuar në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike, dhe studentët duhet të kenë grumbulluar 180 ECTS në përfundim të studimeve që të mund të fitojnë një diplomë Bachelor në "Psikologji". Programi i studimit është i organizuar në module dhe të vlersuar në kredite (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara nga studenti me kohë të plotë përgjatë një viti akademik është 60 ECTS. Tërësia e veprimtarive formuese gjendet e shprehur në Planin Mësimor, i cili është dokumenti themelor i programit të studimit. Plani mësimor përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ, në të cilën parashtrohen në mënyrë të sintetizuar: emërtimi i programit të studimit, objektivat formuese, kohëzgjatja normale e studimeve, tërësia e veprimtarive formuese (disiplinave) që përbëjnë programin e studimit, të grupuara nëpër semestra dhe të renditura sipas semestrave, kreditet për çdo veprimtari formuese, shpërndarjen e krediteve brenda një disipline sipas aktiviteteve formuese të saj (leksione/ seminare/ laboratorë/ detyra/ projekte, etj), ngarkesa në auditor, ngarkesa javore në auditor, karakteristikat e tezës së diplomës. Pranimi i kandidatëve në programin e studimi të ciklit të parë Bachelor</p> |

<sup>80</sup> Evidenca 129. Marrëveshje Departamenti Psikologji.

<sup>81</sup> Evidenca 34. Kurrikula Bachelor Psikologji, Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

<sup>82</sup> Evidenca 41. Sillabusi sipas VKM-s nr. 41.

<sup>83</sup> Evidencë-37-Syllabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.

<sup>84</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.




|  |  |
|--|--|
|  | <p>në "Psikologji" bëhet në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi dhe në Statutin e Universitetit UAMD. Miratimi i kuotave të pranimit<sup>85</sup> për çdo program studimi bëhet me vendim senati sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku kriteri i pranimit për aplikim është nota mesatare 7.5 e studimeve të arsimit të mesëm të lartë, përcaktuar me vendimin të Këshillit të Ministrave sipas vitit përkatës<sup>86</sup>. Bazuar në vendimin e senatit për miratimin e kuotave të pranimit për vitin akademik 2022-2023 për programin Bachelor në "Psikologji" janë miratuar 60 kuota, ku 50 janë për shtetas shqiptar brenda vendit, 2 kuota për aplikantë për program të dytë studimi, 3 kuota për transferimet e studentëve, 1 koutë për minoritetin Romë dhe Egjiptian dhe nga 1 koutë të lirë janë për aplikantët nga trojet shqipfolëse<sup>87</sup>.</p>   |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p> | <p>Programi i studimit Bachelor në "Psikologji" i ofruar nga Departamenti i Psikologjisë është me të njëjtën emërtesë dhe ka në përmbajtjen e tij lëndë module që synojnë të japin njohuri dhe të zhvillojnë kompetenca në linjë me profilin përkatës. Duke iu referuar këtij profili ka një përputhje midis komponentëve kryesorë që e përbëjnë atë si në stukturë, përmbajtje dhe emërtimin e programit të studimit duke qenë përgjithësisht konform edhe fushës së kompetencave profesionale të programit. Bazuar në ndarjen e lëndëve mësimore që e përbëjnë këtë program studimi të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë përkatëse. Përgjithësisht lëndët e fushës së psikologjisë zënë mbi 70%<sup>88</sup> të peshës në këtë program duke dominuar njohuritë dhe dijet për profilin përkatës. Vlen të theksohet gjithsesi se një kujdes më i shtuar duhet të tregohet në lidhje me disa lëndë që i përkasin profilit shoqërorë por ndoshta mund të përafroheshin më shumë me nevojat e këtij profili, nisur dhe nga kërkesat e Urdhrit të Psikologut në drejtim të unifikimit të progrmave të studimit me standartet e EuroPsy-së<sup>89</sup>.</p> |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra</p>  | <p>Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, ka zbatuar të gjitha procedurat ligjore në fuqi në lidhje me regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Psikologji", me kohë të plotë. Ky proces përfshiu regjistrimin e programit të studimit</p>  |

<sup>85</sup> Evidenca 54. Vendim senati për kriteret e pranimit të studentëve.

<sup>86</sup> Evidence 134. Kriteret e pranimit të studentëve UAMD.

<sup>87</sup> Evidenca 55. Vendim Senati Për shpërndarjen e kuotave në ciklet e studimit UAMD.

<sup>88</sup> Evidenca 34. Kurrikula Bachelor Psikologji, Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

<sup>89</sup> European Certificate in Psychology.(2022). Professional Qualification Directive (2005/36/ec)

[https://ëëë.europsy.eu/policies/professional-qualifications-directive-200536ec#3\\_Ëhich\\_professions](https://ëëë.europsy.eu/policies/professional-qualifications-directive-200536ec#3_Ëhich_professions) (Aksesuar më 09.09.2023)




|   |  |                              |                             |  |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|--|
| <p>publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>  | <p>në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor<sup>90</sup>. Në këtë proces, çdo program i studimit është identifikuar me një numer unik identifikimi të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore pranë Ministrisë së Arsimit. Bazuar në përcaktimin e komponentëve që përbëjnë planin mësimor të programit të studimit, institucioni ka gjithashtu identifikuar dhe dokumentuar kodin e secilës lënde mësimore që përfshihet në këtë program të studimit<sup>91</sup>. Kjo është një masë e rëndësishme administrative që ndihmon në identifikimin e lëndëve mësimore në programin e studimit dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë së regjistrave dhe dokumentacionit arsimor. Këto hapa të zbatuara në përputhje me procedurat dhe rregullat ligjore tregojnë se Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës ka vepruar në përputhje me ligjin dhe ka siguruar dokumentacionin e nevojshëm për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji", duke përfshirë regjistrimin e tij në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave. Ky proces është i rëndësishëm për të siguruar që diplomat e studentëve janë të vlefshme dhe të pranueshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> |                              |                             |  |
| <p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> | <p>Programi i studimit Bachelor në "Psikologji" i ofruar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) është një program i ciklit të parë me një kohëzgjatje prej 3 vjetësh. Ky program nuk është i zhvilluar në bashkëpunim me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë vendas ose të huaj. UAMD e mbulon plotësisht këtë program studimi me burimet njerëzore dhe financiare të veta, në përputhje me rregullat dhe udhëzimet përkatëse të aplikueshme në vend.</p>  |                              |                             |  |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i><b>GVJ</b> gjykon se bazuar në evidencat e mësipërme dhe disa aspekteve që lidhen me komponentëve mësimore me të cilat po punohet për t'i përafuar me ligjet në fuqi, nisur nga angazhimi i njësisë bazë, gjykojmë se në tërësinë e tij ky standard <b>përmbushet plotësisht</b>.</i></p>  |                              |                             |  |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p>Nuk përmbushet</p>  | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p> |

## Standardi II.2

<sup>90</sup> Evidenca 15. Kodifikimi i Programeve UAMD.

<sup>91</sup> Evidenca 34. Kurrikula Bachelor Psikologji, Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.



**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

| Kriteret   | Vlerësimi i ekspertëve   |                             |           |          |           |          |           |  |     |     |     |     |     |     |           |   |  |   |  |   |  |                 |   |  |   |  |   |  |           |   |  |   |  |   |  |      |   |   |   |   |   |   |              |           |          |           |          |           |          |
|--|--|-----------------------------|-----------|----------|-----------|----------|-----------|--|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----------|---|--|---|--|---|--|-----------------|---|--|---|--|---|--|-----------|---|--|---|--|---|--|------|---|---|---|---|---|---|--------------|-----------|----------|-----------|----------|-----------|----------|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p> | <p>Fakulteti i Edukimit si njësi kryesore e organizuar sipas ligjeve për strukturën akademike dhe administrative të institucioneve të arsimit të lartë përbëhet nga 6 departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1- Departamentin e Pedagogjisë;</li> <li>2- Departamentin e Gjuhëve të Huaja;</li> <li>3- Departamentin e Sociologjisë;</li> <li>4- <b>dhe Departamentin e Psikologjisë;</b></li> <li>5- Departamenti i Letërsisë;</li> <li>6- Departamenti i Gjuhës Shqipe;</li> </ol> <p>GVJ konstaton se departamenti i <b>Psikologjisë</b> për vitin akademik 2022-2023, ka 11 personel akademik gjithsej, 10 pedagogë me kohë të plotë dhe 1 pedagogë me kohë të pjesshme. Njësia bazë, <b>Departamenti i Psikologjisë</b>, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Psikologji”, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë <sup>92</sup>:</p> <p>Të dhënat e stafit akademik për programin e studimit sipas kualifikimit sipas viteve 2020-2021; 2021-2022; 2022-2023</p> <table border="1" data-bbox="590 1120 1380 1556"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Departamenti i Psikologjisë</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>1</td> <td></td> <td>1</td> <td></td> <td>1</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc. Dr.</td> <td>2</td> <td></td> <td>2</td> <td></td> <td>2</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Dr./ Phd.</td> <td>7</td> <td></td> <td>7</td> <td></td> <td>7</td> <td></td> </tr> <tr> <td>MSc.</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td><b>Total</b></td> <td><b>10</b></td> <td><b>1</b></td> <td><b>10</b></td> <td><b>1</b></td> <td><b>10</b></td> <td><b>1</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Mësohet nga takimi me përgjegjësen e Departamentit dhe antarë të departamentit se njësia bazë ngre grupin e vlerësimit të brendshëm<sup>93</sup> për këtë program studimi sipas detyrimeve ligjore për funksionimin normal të tij, si dhe në linjë me statutin dhe rregulloren e institucionit. Kjo njësi përmbush kushtet për vijimin</p> | Departamenti i Psikologjisë | 2022-2023 |          | 2021-2022 |          | 2020-2021 |  | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK | Prof. Dr. | 1 |  | 1 |  | 1 |  | Prof. Asoc. Dr. | 2 |  | 2 |  | 2 |  | Dr./ Phd. | 7 |  | 7 |  | 7 |  | MSc. | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | <b>Total</b> | <b>10</b> | <b>1</b> | <b>10</b> | <b>1</b> | <b>10</b> | <b>1</b> |
| Departamenti i Psikologjisë  | 2022-2023  |                             | 2021-2022 |          | 2020-2021 |          |           |  |     |     |     |     |     |     |           |   |  |   |  |   |  |                 |   |  |   |  |   |  |           |   |  |   |  |   |  |      |   |   |   |   |   |   |              |           |          |           |          |           |          |
|  | PAE  | PAK                         | PAE       | PAK      | PAE       | PAK      |           |  |     |     |     |     |     |     |           |   |  |   |  |   |  |                 |   |  |   |  |   |  |           |   |  |   |  |   |  |      |   |   |   |   |   |   |              |           |          |           |          |           |          |
| Prof. Dr.  | 1  |                             | 1         |          | 1         |          |           |  |     |     |     |     |     |     |           |   |  |   |  |   |  |                 |   |  |   |  |   |  |           |   |  |   |  |   |  |      |   |   |   |   |   |   |              |           |          |           |          |           |          |
| Prof. Asoc. Dr.  | 2  |                             | 2         |          | 2         |          |           |  |     |     |     |     |     |     |           |   |  |   |  |   |  |                 |   |  |   |  |   |  |           |   |  |   |  |   |  |      |   |   |   |   |   |   |              |           |          |           |          |           |          |
| Dr./ Phd.  | 7  |                             | 7         |          | 7         |          |           |  |     |     |     |     |     |     |           |   |  |   |  |   |  |                 |   |  |   |  |   |  |           |   |  |   |  |   |  |      |   |   |   |   |   |   |              |           |          |           |          |           |          |
| MSc.   | 0  | 1                           | 0         | 1        | 0         | 1        |           |  |     |     |     |     |     |     |           |   |  |   |  |   |  |                 |   |  |   |  |   |  |           |   |  |   |  |   |  |      |   |   |   |   |   |   |              |           |          |           |          |           |          |
| <b>Total</b>   | <b>10</b>  | <b>1</b>                    | <b>10</b> | <b>1</b> | <b>10</b> | <b>1</b> |           |  |     |     |     |     |     |     |           |   |  |   |  |   |  |                 |   |  |   |  |   |  |           |   |  |   |  |   |  |      |   |   |   |   |   |   |              |           |          |           |          |           |          |

<sup>92</sup> Evidenca 20. Tabelat ASCAL, Tabela 12.1; 12.2; 12.3, faqja 49.

<sup>93</sup> Evidenca 32. Vendim Dekani mbi krijimin e GVB mbi Akreditimin e Programeve FE.

|  |   |
|--|---|
|  | e procesit të vlerësimit dhe akreditimit për këtë program studimi, referuar ndjekjes së procedurës pranë ASCAL konform Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2018 <sup>94</sup> , UAMD ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Bachelor në "Psikologji", nëpërmjet shërbimit në AMS <sup>95,96</sup> .   |
| <b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Në kuadër të programit Bachelor në "Psikologji", njësia bazë, përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e trajtimit akademik të studentëve ka bërë përpjekje të rëndësishme për të siguruar që programi të ofrojë një përvojë të pasur mësimore. Për këtë qëllim, ata kanë angazhuar personel ndihmës akademik që janë të kualifikuar dhe të përkushtuar për të ndihmuar studentët të përvetësojnë njohuri praktike të nevojshme për fushën e psikologjisë <sup>97</sup> . Në mënyrë që studentët të jenë të përgatitur për rolin e tyre të ardhshëm në fushën e psikologjisë, programi ka investuar në infrastrukturën e duhur që i lejon studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre praktike <sup>98</sup> . Kjo infrastrukturë siguron që praktikat e tyre të jenë efikase dhe të pasura me përvojë <sup>99,100</sup> . Në përgjithësi, programi i studimit Bachelor në "Psikologji" ka angazhuar resurse <sup>101</sup> dhe personel të kualifikuar për të siguruar një përvojë të pasur mësimore për studentët dhe për të përgatitur ata për sfidat profesionale që do të hasin në fushën e psikologjisë. |
| <b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo   | Njësia kryesore është organizuar në 6 departamente. Njësia bazë që e ofron programin Bachelor në “Psikologji” është Departamenti Psikologjisë, i cili është pjesë e Fakultetit të Edukimit. Mënyra si funksionon njësia kryesore përgjegjëse për  |

<sup>94</sup> Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (2017). Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit.

<https://www.ascal.al/media/documents/publikime/Manual%20afatet%20e%20akreditimit%20IAL%20dhe%20programet%202017.pdf> (Aksesuar më 09.09.2023).

<sup>95</sup> Aneks/Shtojce Aplikim mbi akreditimin e programeve të studimit Bsc Gjuhë Angleze, Bsc Arsim Parashkollor, Bsc Gjuhë Letërsi Anglisht, Bsc Gjuhë Gjermane dhe Angleze, Bsc Psikologji, Bsc Arsim Fillor, Mp Didaktikë, Mp Psikologji Shkollore dhe Zhvillimore, Mp Mësue

<sup>96</sup> Shkresë Përcillen formularët e aplikimit mbi akreditimin e programeve të studimit, Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës.

<sup>97</sup> Evidence 116. Rregullore e Praktikave Profesionale Departamenti Psikologji 2019.

<sup>98</sup> Evidenca 143. Pyetësor për vlerësimin e praktikës mësimore nga studentët Departamenti i Psikologjisë.

<sup>99</sup> Evidenca 141. Pyetësor për marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet për praktikat profesionale.

<sup>100</sup> Evidenca 144. Anketim me Përfaqësues të Institucioneve që kanë Marrëveshje me Departamentin Psikologji.

<sup>101</sup> Evidence 129. Marrëveshje Departamenti Psikologji.




|  |  |                                    |                                   |                                    |
|--|--|------------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| <p>program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> | <p>këtë program studimi në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë” sipas propozimit të përgjegjës të Departamentit miraton në rolin e kordinatorit për programin e studimit Dr. O. H. dhe J.B. në rolin e kordinatorit institucional<sup>102</sup>. Koordinatorit i programit referuar informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion realizohet në vijimësi përmes një sër formash si kordinimin e veprimtarisë mësimore dhe kujdesin në përgatitjen e procesit mësimorë. Ai raporton në mënyrë periodike tek drejtuesi i njësisë përgjegjëse për çdo problematikë të evidentuar lidhur me procesin mësimorë dhe mënyrën e realizimit të tij nga cdo pedagog. Koordinatorit i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>  |                                    |                                   |                                    |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>Në konkluzion, GVJ pas analizës së informacioneve të paraqitura në këtë standart, vlerësojmë se njësia kryesore/bazë e institucionit për programin e studimit ka arritur me sukses të përbushë kriteret në përputhje me kërkesat ligjore aktuale dhe direktivat e përcaktuara në manualin e sigurimit të cilësisë. Kjo përfshin një vlerësim pozitiv për organizimin e strukturës së institucionit, duke theksuar rëndësinë e rolit të njësisë kryesore dhe atij baze në sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin e praktikës profesionale. Ky konkluzion dëshmon për përkushtimin ndaj standardeve të cilësisë dhe ndërhyrjes së efektshme në organizim për të përbushur kërkesat dhe nevojat e programit të studimit.</i></p> <p><i>GVJ bazuar në informacionet e paraqitura në këtë standart gjykon se përgjithësisht keni të përbushura kriteret konform kërkesave ligjore në fuqi dhe në linjë me direktivat e manualit të sigurimit të cilësisë. Për sa më sipër ky standart <b><u>përbushet plotësisht.</u></b></i></p> |                                    |                                   |                                    |
| <p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>   | <p><b>Nuk përbushet</b></p>  | <p><b>Përbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përbushet plotësisht</b></p> |
|  |  |                                    |                                   | <p>X</p>                           |

**Standardi II.3**

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.**

|                        |                                      |
|------------------------|--------------------------------------|
| <p><b>Kriteret</b></p> | <p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> |
|------------------------|--------------------------------------|

<sup>102</sup> Evidenca 32. Vendim Dekani mbi krijimin e GVB mbi Akreditimin e Programeve FE.






|  |   |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p> | <p>Duke iu referuar shqyrtimit të dokumentacionit institucional rezulton se njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë, disponon informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Struktura dhe përmbajtja e programit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” të ofruar nga UAMD mbështetet në 3 dokumente kryesore që janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Plani mësimor<sup>103</sup></li> <li>b) Syllabuset e lëndëve mësimore<sup>104;105</sup></li> <li>c) Rregullorja e programit të studimit<sup>106</sup></li> </ul> <p>Nga takimet me dekanin e institucionit, përgjegjësen e departamentit apo zyra ndihmës akademike, mësohet se protokollet e institucionit dhe burimet njerëzore e materiale në funksion të organizimit të këtij programi studimi duket se i japin mundësi institucionit të avancojë në drejtim të realizimit të tij konform rregullave që i lejojnë funksionimin normal, në përputhje me statutin e tij të brendshëm<sup>107</sup>, rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, (UAMD)<sup>108</sup> e hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”<sup>109</sup>; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<sup>110</sup> dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019<sup>111</sup>. Kjo është evidentuar edhe në Rregulloren e njësisë kryesore<sup>112</sup> dhe bazë<sup>113</sup>, si dhe atë të programit të studimit<sup>114</sup>.</p> |
|--|---|

<sup>103</sup> Evidenca 34. Kurrikula Bachelor Psikologji, Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

<sup>104</sup> Evidenca 41. Sillabusi sipas VKM-s nr. 41.

<sup>105</sup> Evidencë-37-Syllabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.

<sup>106</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>107</sup> Evidenca 2. Statuti UAMD 2018.

<sup>108</sup> Evidenca 4. Rregullore e UAMD 2018.

<sup>109</sup> Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

[https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE\\_djvu.txt](https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt) ( Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>110</sup> VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>( Aksesuar më 09-09-2023).


<sup>111</sup> Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUUyE8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZëNhMëE1Yjdi> (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>112</sup> Evidenca 7. Rregullore FE.

<sup>113</sup> Evidenca 10. Rregullore e Departamentit Psikologji.

<sup>114</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.



**Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.

Programi i studimit i ciklit të parë, Bachelor në “Psikologji” është konform rregullores së programit<sup>115</sup> dhe përcaktimeve ligjore në fuqi. Departamenti i Psikologjisë ka një hierarki në mënyrën e funksionimit të tij kjo dhe konform udhëzimeve të MASR dhe konform rregullave që monitorojnë aspektin e ligjshmërisë. Programi i studimit është i organizuar në module dhe të vlersuar në kredite (ECTS) duke respektuar ndarjen e veprimtarive formuese sipas tipit të komponentëve mësimor në kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/ integruese, lëndë plotësuese (praktika) dhe detyrime përmbyllëse<sup>116</sup>.

| Kategori<br>a | Përshkrimi            | Sipas<br>VKM 185, 2021 | Sipas planit<br>mësimor |
|---------------|-----------------------|------------------------|-------------------------|
| A             | Lëndë bazë            | 15–20% (kredite)       | 22% (kredite)           |
| B             | Lëndë karakterizuese  | 50–55% (kredite)       | 47% (kredite)           |
| C             | Lëndë ndërdisiplinore | 12–15% (kredite)       | 14% (kredite)           |
| D             | Lëndë plotësuese      | 10–15% (kredite)       | 13% (kredite)           |
| E             | Detyrime përmbyllëse  | 3–5%<br>(kredite)      | 4% (kredite)            |

Bazuar në planin mësimor të programit të studimit rezultojnë se kurrikula e programit të studimit është e organizuar në lëndë, module, praktika, laboratore, orë të studimit individual, projekte etj, të cilat janë të shtrira në 3 vite akademike dhe të ndara në 2 semestra për çdo vit akademik. Përqindjet sipas tipologjive të lëndëve mësimore të përlogaritura bazuar në Planin mësimor 2022-2023, të cilat krahasur me përcaktimet në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<sup>117</sup> dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019<sup>118</sup>, Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021<sup>119</sup>,

<sup>115</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>116</sup> Evidenca 34. Kurrikula Bachelor Psikologji, Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

<sup>117</sup> VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>118</sup> Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/vieçer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobiSIZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËEiYjdi> (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>119</sup> Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021. Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr.41, Datë 24.1.2018, "Për Elementët e Programeve të Studimit Të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Të Ndryshuar. <https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa->

|  |   |
|--|---|
|  | <p>përgjithësisht janë konform tyre, dhe përgjatë viteve akademike ka një angazhim të UAMD për ta përafuar me standardet e kërkuara duke ruajtur masën e 20 % të lejuar. Një mospërputhje në % për kategorinë A, “Lëndë Bazë”, e cila aktualisht ka peshën e 22% (kredite) në krahasim me standardin duhet nga 15-20 % (kredite), dhe për kategorinë “Lëndë karakterizuese” e cila ka peshën 47% (kredite) në krahasim me standardin 50-55% (kredite). Gjithsesi bazuar në takimet e realizuar me përfaqësues të institucionit ky aspekt ishte në fokus të ndryshimeve në vijimësi për unifikimin e tyre me kriteret ligjore në fuqi.</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> | <p>Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës nëpërmjet dokumentacionit që shoqëron bazën materiale të këtij programi studimi sic janë Rregullorja e Programit<sup>120</sup>, Kapacitetet pritëse të UAMD<sup>121</sup>, Rregulloren e transferimeve të studentëve<sup>122</sup> etj përshkruan procedurat e procesit të rekrutimit, aplikimit, rregjistrimit, transferimit dhe për aplikantët për një program të dytë studimi. Të gjitha procedurat që lidhen me këtë proces realizohen përmes Zyrës së Pranimit dhe Rregjistrimit<sup>123</sup>. Miratimi i kuotave të pranimit<sup>124</sup> për cdo program studimi bëhet me vendim senati sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku kriteri i pranimit për aplikim është nota mesatare 7.5 e studimeve të arsimit të mesëm të lartë, përcaktuar me vendimin të Këshillit të Ministrave sipas vitit përkatës<sup>125</sup>.</p> <p>Bazuar në vendimin e senatit për miratimin e kuotave të pranimit për vitin akademik 2022-2023 për programin Bachelor në “Psikologji” janë miratuar 60 kuota, ku 50 janë për shtetas shqiptar brenda vendit, 3 kuota për aplikantë për program të dytë studimi, 1 kuota për transferimet e studentëve, 1 kuota për minoritetin Romë dhe Egjiptian dhe 1 kuota të lira janë për aplikantët nga trojet shqipfolëse<sup>126,127</sup>. Në rregulloren mësimore të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Psikologji” ka të specifikuar kriteret që duhet të plotësohen për t’u pranuar në programin e studimit. Kjo rregullore e programit të studimit<sup>128</sup> është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin</p> |

[ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/](#). (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>120</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>121</sup> Evidenca 52. Tabela e Kapaciteteve, 2019-2020.

<sup>122</sup> Evidenca 56. Procedurë për Trasferim Studimesh dhe rregjistrim për Program të Dytë Studimit.

<sup>123</sup> Evidenca 92. Rregullore e sekretarisë.

<sup>124</sup> Evidenca 55. Vendimi Senati për Shpërndarjen e Kuotavenë Ciklet e Studimit UAMD.

<sup>125</sup> Evidenca 134. Kriteret e Pranimit të studentëve UAMD.

<sup>126</sup> Evidenca 55. Vendimi Senati për Shpërndarjen e Kuotavenë Ciklet e Studimit UAMD.

<sup>127</sup> Evidenca 54. Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studentëve.

<sup>128</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




|  |   |
|--|---|
|  | <p>e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij. Institucioni përmes njësive të saj monitoron respektimin e kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit<sup>129</sup> në këtë program studimi si dhe procedurat e ndjekura në pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e programit të studimit bazuar në rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve në UAMD<sup>130</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> | <p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” është program studimesh universitar i organizuar në lëndë dhe vlerësuar me kredite sipas Sitemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve ECTS. Bazuar në Planit Mësimor<sup>131</sup> të programit të studimit dëshkohet se komponentët mësimorë (lëndët/modulet) janë klasifikuar dhe vlerësuar me kredite, sipas sistemit vendas e evropian, të ndara në tre vite dhe dy semestra për çdo vit akademik. Ky program studimi ka një informacion të detajuar konform rregullave në fuqi ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, kreditet dhe ndarjen sipas semestrave akademike edhe në syllabuset e lëndëve mësimore<sup>132</sup>. Në funksion të këtij procesi është dhe rregullorja e këtij program studimi<sup>133</sup>, në të cilën specifikohen rregullat e frekuentimit të procesit mësimor dhe mënyrat e kontrollit dhe vlersimit të dijeve, si dhe dokumente të tjera<sup>134,135, 136</sup>. Nga kjo pikëpamje, programi studimit i marrë në vlerësim rezulton në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<sup>137</sup> dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019<sup>138</sup>, Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021<sup>139</sup>.</p> |

<sup>129</sup> Evidenca 134. Kriteret e Pranimit të studentëve UAMD.

<sup>130</sup> Evidenca 56. Procedurë për Trasferim Studimesh dhe regjistrim për Program të Dytë Studimit.

<sup>131</sup> Evidenca 34. Kurrikula Bachelor Psikologji, Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

<sup>132</sup> Evidenca 41. Sillabusi sipas VKM-s nr. 41.

<sup>133</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>134</sup> Evidenca 116. Rregullore e praktikave profesionale Departamenti Psikologji, 2019.

<sup>135</sup> Evidencë 58 Shembull i Ndarjes së Mentorimit në Departamentin e Psikologjisë.

<sup>136</sup> Evidencë 122 Rregullore Diplomimi Departamenti i Psikologjisë.

<sup>137</sup> VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlova.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>138</sup> Vendimi nr. 879. datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUUyE8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËE1Yjdi> (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>139</sup> Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021. Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr.41, Datë 24.1.2018, "Për Elementët e Programeve të Studimit Të Ofuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Të Ndryshuar. <https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa->

|  |  |                             |                            |   |
|--|--|-----------------------------|----------------------------|---|
| <p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p> | <p>Duke iu referuar procedurave që ndjek institucioni në drejtim të përmirësimit të programit të studimit kemi një informacion të pasur me të dhëna që rregullojnë punën në drejtim të hartimit të syllabuseve të lëndëve sipas ligjeve shtetërore<sup>140</sup> dhe sipas formatit të miratuar nga MASR, dhe i njëjti drejtim ndiqet edhe nga rregullorja mësimore e programit të studimit, e cila përcakton parimet e përgjithshme për këtë program studimi. Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Psikologji” duket se është objekt monitorimi nga njësia bazë lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm në drejtim të planeve mësimore çdo vit akademik dhe miratimit të tyre nga njësia bazë, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu bazuar edhe në strategjinë e zhvillimit të njësisë bazë<sup>141</sup> dhe nxitur nga kërkesa e Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë drejtuar IAL-ve publike e private si një nevojë për unifikimin e programeve me standartet e EuroPsy keni një angazhim të formlizuar nga UAMD.</p> |                             |                            |   |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>GVJ bazuar më vlerësimin e kriterëve lidhur me detajet, informacionin, strukturën dhe organizimin e objektivave formuese të programit Bachelor në “Psikologji”, gjykon se ky standart <b>përbushet plotësisht.</b></i></p>   |                             |                            |   |
| <p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>   | <p>Nuk përbushet</p>   | <p>Përbushet pjesërisht</p> | <p>Përbushet kryesisht</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p> |

|  |  |
|--|--|
| <p><b>Standardi II.4</b></p> <p><b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b></p> |  |
| <p><b>Kriteret</b></p>   | <p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>   |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe</p>   | <p>Programi i studimit Bachelor në "Psikologji" respekton rregulloren dhe vendimet zyrtare, përfshirë VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e</p> |

[ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/](#). (Aksesuar më 09-09-2023)

<sup>140</sup> Evidenca-72-VKM nr.418, “Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin e Programeve.

<sup>141</sup> Evidencë-12-Plani Strategjik Departamenti Psikologjisë 2020-25.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




|   |   |
|---|---|
| aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.   | arsimit të lartë <sup>142</sup> dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019 <sup>143</sup> , Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 <sup>144</sup> . Ky program ofron kushte të përshtatshme për të zhvilluar njohuritë, aftësitë, licencimin dhe përfshirjen në tregun e punës në fushën e psikologjisë. Përmes përmbajtjes së tij, veprimtarive, si dhe strukturës së lëndëve dhe praktikave, programi krijon mundësi për të ndërtuar një profil të përgjithshëm që lejon të vijosh studimet në profile të ndryshme të psikologjisë.   |
| <b>Kriteri 2.</b><br>Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. | Ky program përgjithësisht reflekton një koherencë me parashkimet e akteve ligjore referuar planit mësimorë <sup>145</sup> përsa i përket numrit të krediteve 180 ECTS, me 60 kredite për cdo vit akademik, duke respektuar ndarjen e ECTS me nga 30 ECTS në semestër, me kohëzgjatje normale në 3 vite akademike, tipologjia e lëndëve sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin duke u mbështetur në VKM.Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, dhe legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në Statutin dhe Rregullores së UAMD. Shpërndarja e lëndëve në përgjithësi i jep mundësi studentit të marrë njohuri nga disiplina të psikologjisë, praktika gjithashtu bazuar në mënyrën e organizimit në përgjithësi të japin mundësi për qartësi brenda fushës dhe thellim të njohurive dhe kompetencave praktike. Një balancë e ngjashme është bërë përpjekje të respektohet edhe në shpërndarjen e krediteve në kurrikulën e programit të studimit duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, lëndë plotësuese.<br><br>Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimore janë konform ligjit për arsimin e lartë <sup>146</sup> dhe udhëzimeve ndihmës të vet |

<sup>142</sup> VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 04-02-2023).

<sup>143</sup> Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”  
<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5IZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËE1Yjdi> (Aksesuar më 04-02-2023).

<sup>144</sup> Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021. Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr.41, Datë 24.1.2018, “Për Elementët e Programeve të Studimit Të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Të Ndryshuar. <https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/>. (Aksesuar më 09-09-2023).

<sup>145</sup> Evidenca 34. Kurrikula Bachelor Psikologji, Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

<sup>146</sup> Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

[https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE\\_djvu.txt](https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt)(Aksesuar më 04-02-2023).

|   |   |
|---|---|
|   | <p>UAMD-së me qëllim që të respektohen elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite.</p> <p>Gjithsesi duke iu refruar lëndëve<sup>147,148</sup> “<u>Hyrje në Antopologji Sociale</u>” dhe “<u>Psikologji Kulturore</u>”; “<u>Etnologji</u>” shihen si tepër të ngjashme midis tyre referuar fokusit por edhe syllabuseve. Ndërsa lëndët “<u>Integrimi European</u>” dhe “<u>Komunikim me publikun</u>” nuk shihen si tepër të lidhura me profilin e Psikologjisë për t’u përfshirë si pjesë e kategorisë së lëndëve plotësuese ndërdisiplinare të lidhura me nevojat e fushës së psikologjisë. Duke iu referuar Europsy<sup>149</sup>; APA<sup>150</sup>, këto module nuk janë pjesë e tyre, dhe nuk përmbushin ndonjë nevojë me për të zhvilluar njohuri të përgjithshme për fushën e psikologjisë. Bazuar në evidencat e mësipërme gjykojmë se vijimi i punës në lidhje me përshtatjen e kurrikulës së programit me standartet e cilësisë por edhe me ato ndërkombëtare (EuroPsy) kërkon një angazhim më të madh institucional.</p> <p><i>GVJ sugjeron hapa konkrete në drejtim të përmirësimit të kurrikulës së programit të studimit në linjë me standartet e cilësisë.</i></p> |
| <p><b>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</b></p> | <p>Struktura e programit të studimit duke iu referuar lëndëve dhe emërtimit të tyre, ngarkesës në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit Bachelor në “Psikologji”. Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimore përgjithësisht janë konform ligjit për arsimin e lartë<sup>151</sup> dhe duke u përpjekur të respektojnë elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite. Ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas kategorisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 22% (35 ECTS);</li> <li>- Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 47 % (90 ECTS);</li> <li>- Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisiplinore/Integruese 14 % (25 ECTS);</li> <li>- Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 13 % (23 ECTS);</li> <li>- Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 4 % (7 ECTS);</li> </ul>  |

<sup>147</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.

<sup>148</sup> Evidenca 41. Sillabusi sipas VKM-s nr. 41.

<sup>149</sup> European Certificate in Psychology.(2022). Professional Qualification Directive (2005/36/ec) <https://ëëë.europsy.eu/policies/professional-qualifications-directive-200536ec#3> Ëhich professions (Aksesuar më 09.09.2023)

<sup>150</sup> American Psychological Association (2022) Divisions of APA. [https://ëëë.apa.org/about/division/join?\\_ga=2.130410703.1588092786.1661858527-1523236655.1613575706](https://ëëë.apa.org/about/division/join?_ga=2.130410703.1588092786.1661858527-1523236655.1613575706) (Aksesuar më 09.09.2023)

<sup>151</sup> Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri.

[https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE\\_djvu.txt](https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt)(Aksesuar më 09-09-2023).

|  |   |
|--|---|
|  | <p>Gjithashtu programi përfshin njohuri dhe shprehje profesionale që e ndihmojnë studentin në drejtim të zhvillimit të njohurive të përgjithshme në fushën e psikologjisë. Një element pozitiv në drejtim të përmbushjes së këtij kriteri është edhe ftesa që IAL-et publike e private në vend kanë marrë nga ana e Urdhrit të Psikologut lidhur me unifikimin e programeve të studimit në fushën e psikologjisë me standartet e EuroPsy.</p> <p><i>Sugjerimet e GVJ për vijimësinë lidhen me angazhimin në rritje lidhur me kërkesën e urdhrorit të psikologut në drejtim të unifikimit të programve të studimit konform udhëzimeve dhe standardeve të Europsy, duke "pastruar" këtë program nga lëndë "amfibe" që nuk janë pjesë e direktivave të EurPsy apo APA-s përse i përket përmbajtjejs së programeve të studimit në fushën e psikologjisë.</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>                    | <p>Mbështetur në disa element të rëndësishëm që kanë të bëjnë me përmbajtjen e tij gryojmë se programi i studimit Bachelor në "Psikologji" pasqyron ato si pjesë të tij. Kemi një balancë midis mënyrës së paraqitjes së informacionit mbi ngarkesën mësimorë, ndarjen sipas semestrave, orë në auditor dhe frekuentimin, vlersimin e dijeve dhe një sër akvitetesh specifike që synojnë të mbështesin aspektin praktik të përvetësimit të dijeve të akumuluar nga studentët. Ky program studimi ka një përpjekje në lidhje me elementët që synon të zhvillojë tek studentët në mënyrë që të lehtësojë realizimin e detyrave të kërkuara në tregun e punës për profesionin e psikologut. Bazuar në ngjashmëritë në emërtim në planin mësimorë ky program lehtëson mobilitetin e studentëve brenda dhe jasht vendit.</p>   |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p> | <p>Mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar<sup>152</sup> mund të parashatrojmë se programi i studimit Bachelor në "Psikologji" duhet të jetë gjithmonë në përmirësim të vazhdueshëm përmes përmirësimit të planeve mësimore çdo vit akademik dhe monitorimit me kujdes e miratimit të tyre nga njësia bazë, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie<sup>153</sup>; <sup>154</sup>.</p> <p>Duke iu referuar syllabuseve të lëndëve evidentohen disa problematika të cilat duhen adresuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Syllabuset në një pjesë të tyre janë hartuar nga titullare me gradën Dr. dhe MSc, duke shkuar ndesh me direktivat dhe ligjin përse i përket titullarëve të lëndëve mësimore, të cilët duhet t'i përkasin kategorisë "Profesor".</li> <li>2. Syllabuset kryesisht kanë një literaturë të vjetëruar, kryesisht të para një dekade në një pjesë të lëndëve: - i</li> </ol> |

<sup>152</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.

<sup>153</sup> Evidenca 41. Sillabusi sipas VKM-s nr. 41.

<sup>154</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.



referohemi lëndëve “Hyrje në Psikologji”; Menaxhim Stresi”; “Pedagogji”; “Menaxhim Klase”; “Shkrim Akademik”; “Komunikim me Publikun”; “Etnologji”; “Psikologji Zhvillimi”; “Psikologji Sociale”; “Motivacion dhe Emocion”; “Psikologji Anormale”; “Hyrje në Socialogji”; “Psikoterapi” etj. Në disa raste kemi edhe përfshirje të teksteve që nuk kanë natyrë akademike dhe nuk mund të japin njohuri të thelluara të studentët, “Psikologji Komunikimi” me literaturë bazë të detyrueshme “*Saqellari, S. (2003). Fëmija im akoma nuk flet. Tirnaë, Albin*”. Pasi nuk mund të përdoren broshura informuese për masën e gjerë të popullsisë si tekst akademik për studentet e arsimit të lartë.


3. Apo literatura nuk përkon me nevojat e lëndës mësimore dhe që nuk janë në linjë me emërtimin e lëndës si: “Etika Profesionale” ku si literaturë bazë kemi: *Rachels, J., & S. Elementët e Filozofisë morale. Dita 2000; Stumpf, S.E. Filozofia: Historia dhe Problemet. Toena. Tiranë, 2000*, apo për lëndën “Psikopatologji Zhvillimi” ku si tekst bazë përdoret teksti: - “*Hoxha M., Xhakollari L. (2010). Psikologjia e Zhvillimit gjatë gjithë jetës, Vllamasi, Tiranë*”. Këto tekste nuk përmbushin nevojat e psikologut dhe janë jashtë linjës së tipologjisë së lëndës mësimore dhe emërtimit për profilin profesional për programin Bachelor në “Psikologji”.
4. Në disa lëndë kemi një përsëritje të temave mësimore si psh. - “Psikologji Komunikimi” ka ngjashmëri në tema të vecanta me lëndët “Psikologjinë e Edukimit”; “Psikologji Zhvillimi”; “Psikopatologji zhvillimi” etj, duke dubluar në këtë mënyrë informacionin për studentët, apo dhe përfshirjen e temave që nuk kanë lidhje me emërtimin dhe profilin e lëndës mësimore si “Psikologji Komunikimi”. Gjithashtu e njëjta problematikë evidentohet edhe në syllabusin e lëndës mësimore “Psikologji Kulturore” ku temat mësimore dublojnë informacionin e marrë në lëndët të tjera mësimore si “Psikologji Sociale”, “Psikologji Edukimi”, “Psikologji Zhvillimi”, ky konstatim lidhet me temat e trajtuara në këtë lëndë si: tema 5- Zhvillimi kognitiv; tema 6- Zhvillimi socio-afektiv; tema 10- Natyra dhe kultura; tema 13- Individidi dhe konteksti, etj.
5. Lënda “Psikopatologji Zhvillimi” duke iu referuar temave mësimore duket sikur trajton sërish aspektet e psikologjisë së zhvillimit dhe jo psikopatologjisë e zhvillimit, i referohemi temave mësimore si: tema 1- “Shkenca e psikologjisë zhvillimore”; tema 2- “Mënyrat e studimit të

|  |  |
|--|--|
|  | <p>zhvillimit”; tema 3- “Teoritë e zhvillimit dhe teoria e sjelljes”, tema 4- “Kujdesi para lindjes”, tema 5- “Lindja dhe përshtatja me botën e jashtme”, tema 6- “Piaget dhe stadet e zhvillimit” etj, duke dalë jasht profilit, tipologjisë së lëndës dhe duke dubluar informacionin që jepet në lëndë të tjera si “Psikologji komunikimi”; “Psikologji Zhvillimi”, “Psikologji Edukimi”.</p> <p>6. Përfshirja e teksteve në gjuhë të huaj si pjesë e teksteve të literaturës bazë mund të shihet me skepticizëm duke marrë në konsideratë faktin se tekstet e përdorura janë kryesisht të para një dekade. Dhe se ky program zhvillohet në gjuhën shqipe dhe në ciklin e parë të studimeve gjuha e huaj nuk është kriter për studentët. Kjo mund të krijoj vështirësi tek studentët përta përket përvetësimit të tekstit.</p> <p><i>GVJ sugjeron njësinë bazë të rriste vëmendjen në drejtim të monitorimit të syllabuseve mësimore duke treguar kujdes në mënyrën sesi harmonizohen temat mësimore të trajtuara në lëndë të ndryshme me emërtimin e lëndës dhe fokusin e saj, gjithashtu përdorimi i literaturës në gjuhën shqipe dhe të huaj, të përfshijë disa element sigurie që ruajnë standardet e cilësisë së njohurive akademike që u ofrohen studentëve. Edhe pse tekstet në gjuhën shqipe janë të limituara dhe ky është një shqetësim i përgjithshëm i institucioneve të arsimit të lartë në vend, minimalisht përfshirja e teksteve në gjuhë të huaj të garantoj pjesërisht disa element sigurie duke iu referuar teksteve akademike dhe të një viti botimi të fundit. Kjo lidhur me mënyrën sesi ndryshon dinamika e prespektivës shkencore në fushën e psikologjisë përgjatë viteve, nëse literatura është e para 1 apo 2 dekadash atëherë kemi arsye serioze për të vënë në dyshim cilësinë.</i></p> |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> | <p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit përcaktohet si qëllimi kryesor ofrimin i njohurive bazë në fushat që lidhen drejtpërdrejt me shkencën e psikologjisë, si dhe të njohurive mbi degët më të aplikuara aktualisht të psikologjisë në botë e në vendin tonë. Gjithashtu programi synon të pajisë studentin me aftësitë kryesore të një psikologu të përgjithshëm. Mënyra sesi janë ndërtuar modulet e lëndëve duhet tu japin mundësi studentëve për fitimin e shprehive shkencore dhe profesionale. Një sër aktiviteteish të formimit teorik dhe praktik duhet të fokusohen në hapsirat e nevojshme për të përthyer në mënyrë të duhur aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme që i lejojnë psikologut të zhvillojë disa kompetenca profesionale të lidhura me procesin e vlersimit të problemit dhe të ndërhyrjes psikologjike, të nevojshme për një vizibilitet më të madh në tregun e punës. Mënyra sesi do implemetojë në planin mësimorë të lëndës idetë inovative, studimet</p>   |

|   |   |
|---|---|
|   | <p>e avancuara kërkimore e shkencore në mbështetje të nevojave të studentit në lidhje me avancimin në njohuri kërkon angazhim të vazhdueshëm. Duke iu referuar disa çështjeve që kanë të bëjnë me lëndë të caktuar që mund të mos jenë të lidhura drejtpërdrejtë me fushën e këtij programi studimi apo lëndë që dublojnë njëra-tjetrën, me tekste të para 1 dekadë, mundet që këto aspekte të rrezikojnë përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale të plota.</p> <p><i>GVJ sugjeron njësinë që përmbajtja e programit të studimit të krijojë kushtet për zhvillimin e njohurive dhe kompetencave profesionale të nevojshme në linjë me profilin e psikologjisë.</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> | <p>Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe kritereve për licensimin e psikologëve sipas Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë. Nëse i referohemi planit mësimor<sup>155</sup> kemi një ndarje midis veprimtarive formuese të cilat zhvillohen në auditor dhe jasht tij. Këto veprimtari kanë të ndërthurura aspektet teorike dhe praktike që të lejojnë aftësimin e studentit në përvetësimin e shprehive të nevojshme për të realizuar punën konkrete gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Praktika profesionale gjithashtu mbështet nevojat e programit për zhvillim kompetencash dhe aftësish të nevojshme përmes njohjes së terrenit të punës. Referuar marrëveshjeve institucionale për praktikën profesionale që njësia disponon, studentët kanë mundësi për të përzgjedhur institucionet e praktikës në linjë me interesat e tyre kërkimore dhe profesional, që tu shërbejnë nevojave të tyre për t'u qartësuar lidhur me profilet e ndryshme të psikologjisë.</p> <p>Duke iu referuar përmbajtjes së programit, ai mundëson vijimin e studimeve në ciklin e dytë të studimeve por punësimi i tyre në këtë profil profesional duke qenë profesion i rregulluar kërkon më tepër kohë. Duke u bazuar në ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe në mbështetjen të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me Propozim të Këshillit të Ministrave vendosi që profesioni i psikologut të përfshihet në grupin e profesioneve të rregulluar<sup>156</sup>. Profesion i rregulluar është një veprimtari apo grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale të veçanta. Autoriteti kompetent është</p> |

<sup>155</sup> Evidenca 34. Kurrikula Bachelor Psikologji, Plani mësimor dhe Veprimtaritë Formuese.

<sup>156</sup> Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë, si autoritet, i ngarkuar me akt ligjor apo nënligjor, si përgjegjës e rregullator për një apo më shumë profesione të rregulluara, institucion që monitoron dhe arbitron të drejtën e ushtrimit të profesionit të psikologut. Për të gjithë të diplomuarit në Bachelor në “Psikologji” kërkohet edhe përfundimi i ciklit të dytë të studimeve me qëllim vijimin e procedurave për licesim dhe më pas punësimin e tyre. Pas përfundimit të dy cikleve të studimit, studentët mund të kryejnë praktikën profesionale <sup>157</sup> nën supervizionin e një psikologu të licensuar dhe pas përmbylljes me sukses të saj të futen në provimin e shtetit, vetëm pas marrjes së provimit të shtetit kandidatët psikolog mund të përfitojnë licencën për ushtrimin e profesionit të psikologut në Republikën e Shqipërisë. |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>                         | <i>GVJ gjykon se disa aspekteve u duhet dhënë një vëmendje më e madhe me qëllim adresimin e duhur të çështjeve që lidhen me hartimin e syllabuseve nga personel akademik të kategorisë “Profesor” sic e kërkon ligji, kujdes në dublimin e temave mësimore për lëndë të përafërta ose jo, kujdes në literaturën e përdorur që minimalisht të përmbush kriterin e një teksti akademik dhe në linjë me tipologjinë dhe emërtimin e lëndës mësimore. Por edhe lëndë të formimit që nuk lidhen me profilin e psikologjisë të zëvendësohen me lëndë të tjera që përmbajtja e programit të studimit të krijojnë kushtet për zhvillimin e njohurive dhe kompetencave profesionale të nevojshme në linjë me profilin e psikologjisë. Bazuar në shqyrtimin e kriterëve specifike që përbejnë këtë standard, GVJ gjykon se ai <u>përmbushet kryesisht</u>.</i>                |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              | X                           |                              |

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

| Kriteret                             | Vlerësimi i ekspertëve   |
|--------------------------------------|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e | Njësia bazë që ofron programin e studimit Bachelor në “Psikologji” është Departamenti i Psikologjisë i cili duhet të konsultohet dhe |

<sup>157</sup> Urdhër Nr. 418/2, datë 22.01.2018 MASR dhe Nr 574/1 datë 30.01.2018 MSHMS, i Përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. “Për miratimin e Rregullores së Praktikës Profesionale për profesionin e rregulluar të psikologut në Republikën e Shqipërisë”.

|   |  |
|---|--|
| <p>përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p> | <p>mbështetet në përmirësimin e këtij program studimi dhe në përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës në strukturën e ngritur nga UAMD sic është Sektori i Komunikimit, Alumni dhe i Karrierës<sup>158,159, 160</sup> apo krijimi i Shoqatës Alumni<sup>161</sup> apo dhe përfshirja e përfaqësuesve të institucioneve<sup>162</sup> në përbërje të të cilit janë drejtues të institucioneve me të cilat UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi. Fokus-grupet me student e ish-student janë praktika<sup>163</sup> të mira që konsiderohen me ndikim pozitiv në përmirësimin<sup>164</sup> e këtij program studimi, edhe pse nuk kuptohet sesi dhe në çfarë kushtesh do të shfrytëzohet nga njësia bazë. Duke u bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar mbetet disi i paqartë sesi do të përdoren këto element në drejtim të përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit.</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>              | <p>Njësia bazë monitoron në vijimësi përshtypjet e studentëve të këtij program studimi përmes rolit të kordinatorit<sup>165</sup> të këtij programi studimi, përmes pyetësorëve për studentët<sup>166</sup> dhe strukturave monitoruese<sup>167</sup> në të cilat studentët janë pjesë e tyre etj. Në takimet me drejtuesen e njëzisë bazë, GVJ u informua se njësia bazë organizon takime periodike me studentët për të marrë feedback-un e tyre për mënyrën e realizimit të procesit mësimor dhe aspektin e realizimit të eksperiencave të praktikës profesionale pranë institucioneve me të cilat UAMD ka një marrëveshje përmes kordinatorit dhe drejtuesit të njësisë. Në funksion të përmirësimit të programit të studimit, Njësia Bazë e Senati Akademik, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC), Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC)<sup>168</sup>. Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve</p> |

<sup>158</sup> Evidencë-26-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.

<sup>159</sup> Evidencë-63-Udhëzues i Karrierës UAMD

<sup>160</sup> Evidencë-66-DATABAZË PUNËSIMESH ALUMNI UAMD

<sup>161</sup> Evidencë-27- Shoqata Alumni UAMD

<sup>162</sup> Evidencë-144-Anketim me Përfaqësues të Institucioneve që kanë Marrëveshje me Departamentin Psikologji

<sup>163</sup> Evidencë-76-Raport Sektori i Karrierës dhe Alumni UAMD

<sup>164</sup> Evidencë-145-Shembull Fokus Grup me Studentë Bachelor Psikologji për Cilësinë e Mësimdhënies.

<sup>165</sup> Evidencë-133-Përcaktimi koordinatorëve të programeve të studimit Departamenti Psikologji

<sup>166</sup> Evidencë-18- Rezultatet mbi Anketimin e Studentëve, Stafit Akademik dhe Administrativ mbi Institucionin.

<sup>167</sup> Evidencë-19-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, FE

<sup>168</sup> Evidenca-22-Komisioni i Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë FE UAMD.

|  |   |
|--|---|
|  | <p>(NjBSC Fakulteti) Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program - Koordinatorët e Programeve në bashkëpunim me njësinë bazë realizon monitorim përmes pyetësorëve me student <sup>169</sup> në lidhje me lëndën dhe pedagogët<sup>170</sup> si dhe nga vlersuesit e brendshëm dhe të jashtëm. Përmes Zyrës Alumni e Karrierës institucioni ka marr një pozicion aktiv në drejtim të vijimit të zhvillimit të kompetencave të studentëve dhe ish-studentëve të tij<sup>171</sup> shfrytësimin e këtyre burimeve njerëzore për nevojat e veta institucionale. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar<sup>172; 173; 174; 175</sup>. Të gjitha këto struktura dhe nisma konsiderohen me ndikim pozitiv për mbështetjen e alumnit.</p> <p><i>Gjithsesi nuk kemi evidence që na lejojnë të vlersojmë sesa merren në konsideratë sugjerimet e alumni në drejtim të përmirësimit të këtij program studimi.</i></p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p> | <p>Duke iu referuar raportit vjetor<sup>176</sup>, njësia bazë ka marrë angazhim për të përmirësuar në vijimësi këtë program studimi, kjo në linjë edhe me kërkesat e tregut të punës dhe të ndërkombëtarizimit të programve për ti unifikuar me ato të vendeve të BE-së<sup>177</sup>. Kjo në linjë me një sër hapash që janë ndërmarrë nga njësia bazë lidhur me ecurinë e përmirësimit të programit të studimit në drejtim të praktikave profesionale<sup>178</sup>. Gjithsesi duhet të evidentojmë se kërkohet një punë dhe angazhim i të gjitha palëve të përfshira në proces që të mund të realizohet konform pritshmërive dhe realisht të ndërmerren hapa në drejtim të përmirësimit të programit të studimit duke ndjekur standartet ndërkombëtare të licensimit dhe akreditimit në fushën e psikologjisë përmes ofrimit të cilësisë në mësimdhënie.</p>  |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>GVJ duke iu referuar këtyre kriterëve reflekton se bazuar në angazhimin formal dhe të shoqëruar me dokumentacionet</i></p>  |

<sup>169</sup> Evidencë-30-Pyetësor për Alumni UAMD

<sup>170</sup> Ev. 18. Formular Raport I punës semestrale staf akademik.

<sup>171</sup> Evidencë-142-Takim Alumni Departamenti i Psikologjisë, 2023.

<sup>172</sup> Evidencë-62-Shembull Aktiviteti Alumni UAMD

<sup>173</sup> Evidencë-28-Takime Alumni.

<sup>174</sup> Evidencë-30-Pyetësor për Alumni UAMD

<sup>175</sup> Evidencë-142-Takim Alumni Departamenti i Psikologjisë, 2023.

<sup>176</sup> Evidencë-65-Raporte Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.

<sup>177</sup> Evidencë-31-Strategjia e Ndërkombëtarizimit UAMD.

<sup>178</sup> Evidencë-116-Rregullore e Praktikave Profesionale Departamenti Psikologjisë 2019.

|                                     | <i>përkatëse në lidhje me përmbushjen e këtij standardi gjykojmë se <u>përmbushet plotësisht.</u></i> |                       |                      |                       |
|-------------------------------------|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet  | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|                                     |   |                       |                      | X                     |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|   |                |                       | X                    |                       |

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| <b>Standardi III.1</b>   |  |
|--|--|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>  |  |
| Kriteret   | Vlerësimi i ekspertëve   |
| <b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Rregullorja e programit <sup>179</sup> ka të paraqitura “Format e mësimdhënies” duke i përshkruar veprimtaritë mësimore si aktivitete që realizohen nëpërmjet orëve teorike dhe praktike, leksioneve, seminareve, detyrave të kursit <sup>180</sup> , prezantimeve, projekteve të kërkimit, praktikës. Një informacion më i detajuar lidhur me elementët e lëndëve mësimore <sup>181</sup> është paraqitur edhe në syllabuset e këtij programi studimi. Në vijim të saj “Praktika profesionale” parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional, ku udhëzimet më të hollësishme lidhur me praktikën jepen në paketën e praktikës. Departamenti i Psikologjisë ka hartuar Rregulloren e Praktikës Profesionale <sup>182</sup> ku janë përcaktuar kriteret për zgjedhjen e institucioneve të praktikës vëzhguese, informacion për zgjedhjen e agjencisë së praktikës psikologjike, procedurat e vlerësimit të dosjes së praktikës dhe përbajtja e saj, vlerësimi i praktikës <sup>183</sup> , detyrimet e studentit, aspekte që lidhen me respektimin e kodit etik të profesionit, detyrimet e supervizorit |

<sup>179</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>180</sup> Evidencë-67-Model i një detyre kursi Bachelor Psikologji.

<sup>181</sup> Evidencë-37-Syllabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.

<sup>182</sup> Evidencë-116-Rregullore e Praktikave Profesionale Departamenti Psikologjisë 2019.

<sup>183</sup> Evidencë-130- Vlerësimi i mbikëqyrësit për praktikantin Bachelor Psikologji.

|  |   |
|--|---|
|  | <p>të praktikës, grafiku i shlyerjes së detyrimeve<sup>184</sup>, institucionet e mundshme për praktikën, si dhe literatura e nevojshme për cdo lëndë mësimore të cilat janë pjesë e syllabuseve të lëndës. Departamenti i Psikologjisë ka hartuar një udhëzues të dedikuar paketës së provës finale për mbrojtjen e diplomës Bachelor në Psikologji<sup>185</sup> ku përshkruhen standardet lidhur me metodologjinë e punimit, mënyrën e prezantimit, kërkesat teknike dhe etikën e kërkimit. Gjithashtu, në këtë dokument janë pasqyruar përgjegjësitë e studentit dhe udhëheqësit të tij, si dhe tërësia e procedurave të propozimit<sup>186</sup> paraqitjes dhe mbrojtjes së diplomës<sup>187</sup>.</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> | <p>Personeli akademik duket se ka kërkesa të vazhdueshme<sup>188</sup> në drejtim të përmirësimit<sup>189</sup> të lëndës/modulit me forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies<sup>190</sup>, <sup>191</sup>, <sup>192</sup> gjithashtu liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë së informacionit<sup>193</sup> për nevojat mësimore si videoprojektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>           |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>                                | <p>Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike<sup>194</sup>, jo vetëm përmes stukturave monitoruese<sup>195</sup> por edhe përmes udhëzuesve për</p>  |

<sup>184</sup> Evidencë-119-Formati i Miratimit të Praktikës Bachelor Psikologji.

<sup>185</sup> Evidencë-122-Rregullore Diplomimi Departamenti i Psikologjisë.

<sup>186</sup> Evidencë 58 Shembull i Ndarjes së Mentorimit në Departamentin e Psikologjisë.

<sup>187</sup> Evidencë-127-Shembull Takime për Temën e Diplomës Bachelor Psikologji.

<sup>188</sup> Evidencë-50-Vlerësimi i Performancës së mësimdhënies nga Kolegu apo Eprori Departamenti Psikologjisë.

<sup>189</sup> Evidencë-65-Raporte Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.

<sup>190</sup> Evidencë-140-Trajnim i stafit nga QEV FE.

<sup>191</sup> Evidencë-73-Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të personelit akademik dhe njësisiv.

<sup>192</sup> Evidencë-78-Kalendari i Aktiviteteve të Departamentit Psikologjisë 2022-2023

<sup>193</sup> Evidencë-110-Perdorimi i Sistemit Elektronik.

<sup>194</sup> Evidenca-123-Marrëveshje Bashkëpunimi për Programin Erasmus, UAMD.

<sup>195</sup> Evidencë-65-Raporte Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.



|  |  |
|--|--|
|  | <p>mësimdhënien. Këto udhëzues<sup>196; 197; 198; 199; 200</sup> synojnë përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie për stafin akademik të UAMD duke mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Mbështetur në raportin e fushës kërkimore të stafit akademik<sup>201</sup> dhe të mobilitetit të tyre<sup>202</sup> krijohen kushte për rritjen e kompetencave profesionale dhe cilësisë në mësimdhënie.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</b></p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> | <p>Duke iu referuar personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie duke iu referuar sylabuseve<sup>203</sup>, metodave të mësimdhënies sipas tematikave të ndryshme UAMD, përgjithësisht duket se krijon kushte për një të nxënë efektiv bazuar në titujt dhe gradat e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi. Kjo evidentohet edhe nga diskutimi me studentët e stafin akademik të cilët shprehen me nota pozitive. Ndërkohë nëse i referohemi sylabuseve të dërguara ku janë shënuar krahas të dhënave të tjera edhe titullari i lëndës, profili i tyre duhet të integrohet më mirë me nevojat e programit të studimit dhe me rregullat e fushës së kompetencës së personave të angazhuar<sup>204</sup> në lëndë dhe module specifike, pasi profili i tyre del jashtë fushës së psikologjisë në disa raste, duke qenë në profile të përafërta.</p> <p>Referuar kualifikimit akademik dhe përvojave profesionale rezultojnë problematike çështja e mbulimit të profilit psikologji me staf akademik, cili duhet të ketë kualifikime dhe/ose përvojë profesionale në këtë kontekst. Kjo me qëllim që stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në Bachelor në “Psikologji” të jetë në gjendje të njohë mirë terrenet profesionale të psikologut dhe t’u përgjigjet drejt kërkesave të studentëve për njohuri të thelluara dhe zhvillim të kompetencave profesionale në këtë kontekst pune të zgjedhura</p> |

<sup>196</sup> Evidencë-116-Rregullore e Praktikave Profesionale Departamenti Psikologjisë 2019.

<sup>197</sup> Evidencë-73-Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të personelit akademik dhe njësisiv.

<sup>198</sup> Evidencë-110-Përdorimi i Sistemit Elektronik

<sup>199</sup> Evidencë-111-Literaturë mbështetëse për Programin Bachelor Psikologji që gjenden në Bibliotekën e FE UA.

<sup>200</sup> Evidencë-40-Shembull trajnimi për Mësimdhënie Stafi FE 2023.

<sup>201</sup> Evidencë-137- Fushat Kërkimore Shkencore të personelit akademik Departamenti i Psikologjisë.

<sup>202</sup> Evidencë-64- Mobilitetet e Stafit Akademik FE.

<sup>203</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.

<sup>204</sup> Evidencë-77-CV Stafit Akademik i Angazhuar në Bachelor Psikologji 2022-23.




prej tyre. Duke iu referuar Europsy<sup>205</sup> por edhe APA-s<sup>206</sup> këto terrene ndryshojnë shumë nga profilet e tjera si nga forma dhe përmbajtja, njohuritë, fusha e ekspertizës, dhe si e tillë konsiderohet një sfidë e madhe zhvillimi i njohurive të studentëve të psikologjisë nga stafi i cili vetë nuk ka një kualifikim në këtë fushë. Mbetet për t'u parë sesi institucioni do të menaxhojë kërkesat e tregut të punës për profesionist të kualifikuar të cilët do të jenë në gjendje të përmbushin kërkesat për licensim tek urdhri i psikologut dhe të pozicionit të punës që aspirojnë. Duke u mbështetur në ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009<sup>207</sup>, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe në mbështetjen të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me Propozim të Këshillit të Ministrave vendosi që profesioni i psikologut të përfshihet në grupin e profesioneve të rregulluara. Profesion i rregulluar është një veprimtari apo grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale të veçanta. Bazuar në sa më sipër, e njëjta praktikë duhet të ndiqet edhe në përzgjedhjen e stafit akademik që angazhohet për të zhvilluar njohuritë dhe kompetencat profesionale të studentëve që duan të profilizohen në fushën e psikologjisë.

Bazuar në rregulloren e programit të studimit, por edhe mënyrës sesi janë hartuar sylabuset, përgjithësi ka larmishmëri përsa i përket formave të përdorura në mësimdhënie si role-play, studim rastesh, fokus-grupe që e vënë studentin në një pozicion aktiv gjatë orës së mësimi. Këto forma i përshtaten shumë mirë disiplinës së psikologjisë dhe ndihmojnë studentin të fitojë njohuri praktike mbi fushën e psikologjisë. Format dhe metodat e mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga pedagogu. Mbështetur në informacionin e marrë nga takimi me studentët dhe pedagogët, por edhe nga rregulloret dhe udhëzimet e institucionit mbi rregullat e ndërtimit të marrëdhënies pedagog –student,

<sup>205</sup> European Certificate in Psychology.(2022). Professional Qualification Directive (2005/36/ec) [https://ëëë.europsy.eu/policies/professional-qualifications-directive-200536ec#3\\_Ëhich\\_professions](https://ëëë.europsy.eu/policies/professional-qualifications-directive-200536ec#3_Ëhich_professions) (Aksesuar më 10.09.2023)

<sup>206</sup> American Psychological Association (2022) Divisions of APA. [https://ëëë.apa.org/about/division/join?\\_ga=2.130410703.1588092786.1661858527-1523236655.1613575706](https://ëëë.apa.org/about/division/join?_ga=2.130410703.1588092786.1661858527-1523236655.1613575706) (Aksesuar më 10.09.2023)

<sup>207</sup> Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

|  |  |
|--|--|
|  | <p>respektohet dinjiteti dhe integriteti i çdo studentit<sup>208</sup>. Proçesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies realizohet në një klimë positive dhe liria e mendimit respektohet duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë e të menduarit kritik të studentit<sup>209</sup>.</p> <p><i>GVJ rekomandon njësinë bazë dhe UAMD që përzgjedhja e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi duhet të jetë në një profil kualifikimi të psikologjisë, më qëllim që të jenë në gjendje të zhvillojnë kompetenca profesionale dhe shprehi punë tek studentët në linjë me profilin për të cilin po studiojnë. Kjo qasje pritet të ketë një ndikim pozitiv në mësimdhënie cilësore dhe aftësi akademike në realizimin e lëndëve mësimore.</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p> | <p>Vlerësimi i këtij kriteri mbështet në kërkesën e zyrës së zhvillimit, kurrikulës dhe cilësisë për përmirësimin e formave dhe metodave në mësimdhënie ndërsa përsa i përket përfshirjes së studentëve në këtë proces ka një përpjekje përmes rolit të kordinatorit të departamentit<sup>210</sup> dhe komisionit të sigurimit të cilësisë në nivel institucional<sup>211</sup> si dy struktura që monitorojë kompetencat e personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie përmes një sër formash monitorimi<sup>212, 213, 214, 215, 216, 217</sup>. Përfshirja e studentit në vlersimin periodik<sup>218</sup> të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët<sup>219</sup> realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angazhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies. Administrimi i pyetësorit i lejon atyre ruajtjen e anonimatit gjatë dhënies së vlerësimit.</p> |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi</p>   | <p>Institucioni ka ngritur disa struktura, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm në</p>   |

<sup>208</sup> Evidencë-5-Kodi i Etikës UAMD.

<sup>209</sup> Evidenca-70-Urdhër Rektorati mbi Transparencën e Marrëdhënies Student-Pedagog

<sup>210</sup> Evidencë-133-Përcaktimi koordinatorëve të programeve të studimit Departamenti Psikologji

<sup>211</sup> Evidenca-22-Komisioni i Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë FE UAMD.

<sup>212</sup> Evidencë-18- Rezultatet mbi Anketimin e Studentëve, Stafit Akademik dhe Administrativ mbi Institucionin.

<sup>213</sup> Evidencë-28-Takime Alumni.

<sup>214</sup> Evidencë-30-Pyetësor për Alumni UAMD

<sup>215</sup> Evidencë-142-Takim Alumni Departamenti i Psikologjisë, 2023.

<sup>216</sup> Evidenca-81-Formulari i Vetëvlerësimit të Personelit Akademik, 2019.

<sup>217</sup> Evidencë-48-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit nga studentët.

<sup>218</sup> Evidencë-50-Vlerësimi i Performancës së mësimdhënies nga Kolegu apo Eprori Departamenti Psikologjisë.

<sup>219</sup> Evidencë-65-Raporte Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.

|   |   |
|---|---|
| <p>në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> | <p>mësimdhënie, përmes Zyrave studentore, Alumni dhe Karrierës, Njësisë për zhvillimin kurrikularë dhe Cilësisë, Kordinatorit të programit të studimit. Puna e këtyre strukturave synon monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standartet shtetërore dhe ato ndërkombëtare, në funksion të kësaj çështje është hartuar edhe rregullorja për standartet e cilësisë<sup>220</sup>. Sistemi i brendshëm i menaxhimit të cilësisë sigurohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Strukturave organizative të UAMD dhe FE.</li> <li>- Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (GSBC) në UAMD</li> <li>- Grupi për vlerësimin e brendshëm të cilësisë (GVBC) të Fakultetit të Edukimit</li> </ul> <p>Të gjitha strukturat drejtuese (autoritetet dhe organet drejtuese), janë përgjegjëse për ndjekjen e përditshme të sigurimit të cilësisë nëpërmjet planifikimit, organizimit, zbatimit dhe monitorimit të zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave drejt arritjes së vizionit të UAMD dhe FE. GSBC-ja, dhe GVBC-ja janë ngritur me synim kryerjen periodike të vlerësimit të brendshëm të veprimtarisë së UAMD dhe FE, publikimin dhe diskutimin e rezultateve të raportit të vlerësimit me stafin drejtues dhe njësitë kryesore dhe bazë, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së performancës në të ardhmen.</p> <p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin e sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standarteve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, kanë ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. Përmes raportit të vlerësimit të studentëve<sup>221</sup> i cili lejon të mbledhi një informacion të detajuar mbi një sër aspektesh si vështrimi i përgjithshëm i gjendjes së programit të studimit, ndyshimet apo praktikën profesionale, plani i veprimit për vitin e ardhshëm, raportimi mbi veprimtaritë e ndërmarra, feedback-u i marrë nga studentët dhe stafi akademik në nivel institucional, statistika të regjistrimit të studentëve dhe të kalueshmërisë së tyre, burimet mbështetëse të programit të studimit, vlersimi i jashtëm, karriera dhe alumnit, profesionet e rregulluara si dhe praktikat e mira nga institucionet e tjera. Ky vlersim kryhet nga komisioni i sigurimit të cilësisë, i cili monitoron programin në</p> |
|---|---|

<sup>220</sup> Evidencë-19-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë\_së Brendshme, FE

<sup>221</sup> Evidencë-18- Rezultatet mbi Anketimin e Studentëve, Stafit Akademik dhe Administrativ mbi Institucionin.

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | vijimësi, duke u siguruar informacione të rëndësishme si Njesisë për Zhvillimin Kurrikularë dhe Cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njesisë kryesore dhe asaj bazë <sup>222</sup> . Prania e këtyre elementëve konsiderohen me ndikim pozitive në drejtim të mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me studentët.   |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>                         | <i>Bazuar në këtë standardi përgjithësisht është në përmbushje të kriterve, por një çështje e rëndësishme që ka nevojë të adresohet nga ana e institucionit ka të bëjë me kujdes për angazhimin e stafit akademik me një profil të pastër në fushën e psikologjisë dhe gjithashtu titullarët që hartojnë syllabuset e lëndëve të jenë të kategorisë "profesor" konform ligjeve në fuqi. Për sa më sipër vlerësohet se në mungesë të këtyre elementëve të rëndësishëm ky standart <u>përmbushet kryesisht</u>.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              | X                           |                              |

### Standardi III.2

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
|--|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive shkencore e profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit të studimit <sup>223</sup> , sistemin e vlersimit të studentit, formatin e punimit të diplomës <sup>224</sup> , apo provimit të formimit përfundimtar etj. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive <sup>225</sup> bëhen publike dhe njihen nga studentët në kohë reale edhe duke shfrytëzuar platforma elektronike si Pitagora <sup>226,227,228</sup> që përdoren nga studentët e këtij program studimi. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët edhe përmes sekretarisë mësimore dhe vetë pedagogut të lëndës <sup>229</sup> në fillim të çdo semestri, në të cilën specifikohen rregullat e frekuentimit |

<sup>222</sup> Evidencë-65-Raporte Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.

<sup>223</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>224</sup> Evidencë-122-Rregullore Diplomimi Departamenti i Psikologjisë.

<sup>225</sup> Evidencë-130- Vlerësimi i mbikëqyrësit për praktikantin Bachelor Psikologji.

<sup>226</sup> Evidencë-110-Perdorimi i Sistemit Elektronik.

<sup>227</sup> Evidenca-93- Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH).

<sup>228</sup> Evidenca-91-Manuali i Përdorimit të Pitagorës nga Personeli Akademik.

<sup>229</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.

|   |   |
|---|---|
|   | të procesit mësimor dhe mënyrat e kontrollit dhe vlersimit të dijeve.   |
| <b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Studentët e programit të studimit Bachelor në “Psikologji” në fillim të çdo semestri informohen në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive nga titullari ose lektori i parë i lëndëve përkatëse. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një vlerësimi më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecurisë së kursit gjatë semestrit <sup>230</sup> , nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlersimin e performancës akademike të studentit.  |
| <b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.                            | Studentit i jepen hapësirat e nevojshme për të demonstruar përvetësimin e njohurive <sup>231</sup> përmes vlersimit nga detyrat e kursit (100 pikë), mendimet dhe reflektimet personale të shpalosura në auditor, formës së hartimit të testit të ndërmjetëm (400 pikë) dhe testit final (500 pikë) me diversitet pyetjesh dhe formash të nxitjes së të nxënit, përmes grup pyetjeve për kontrollin e njohurive, grup pyetje analizuese dhe grup pyetje zhvilluese. Duke i dhënë në këtë mënyrë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në varësi të stilit personal të të nxënit. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma, për programin e studimit. Nuk kemi evidenca për realizimin e testimit përmes sistemit elektronik. Për provimet finale përdoret edhe sistemi CleanScore për korrigjimin e automatizuar të provimeve. |
| <b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar   | UAMD dhe njësia kryesore/bazë përmes strukturave të saj synon të angazhohet në monitorim dhe nxitje të stafit në drejtim të vlerësimit dhe përmirësimit të formave të mësimdhënies. Por në lidhje me këtë kriter në mënyrë të drejtpërdrejt nuk kemi evidence të qartë përse i përket vlerësimit dhe përmirësimit të formave e metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike nga ana e stafit duke përfshirë studentët në këtë proces. Por vërtetohet se ka procedura që ndiqen nga institucioni për   |

<sup>230</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.

<sup>231</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.

|  |  |
|--|--|
| mendimet e sugjerimet e tyre.  | monitorimin <sup>232</sup> e udhëzimin e stafit akademik lidhur me procesin e mësimdhënies <sup>233,234,235</sup> . Por edhe përmes formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti, dhe formulari i vlerësimit të performances nga kolegu apo eprori apo njësia e zhvillimit kurrikular dhe cilësisë <sup>236,237, 238, 239</sup> , procedura që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie.   |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | UAMD duke u mbështetur në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie ka zhvilluar një sër aktivitetesh dhe është angazhuar në krijimin e hapsirave të nevojshme për stafin akademik në funksion të rritjes së cilësisë në mësimdhënie <sup>240</sup> , gjithashtu në këtë drejtim një rol ndihmës japin edhe aktivitete si ëorkshope, konferenca, trajnime, mobilitete të stafit <sup>241</sup> dhe studentëve duke siguruar bashkëpunim dhe përfshirje të vazhdueshme të partnerëve për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies të stafit akademik dhe implementimit të metodave të reja duke ftuar trajnues/lektorë vendas dhe të huaj <sup>242</sup> . Në këto programe trajnimi është përfshirë personeli akademik efektiv, duke realizuar/ drejtuar procesin trajnues, ose leksionet e hapura të cilat krijojnë një klimë bashkëpunimi dhe shkëmbimi përvoja <sup>243</sup> . Një sër platformash elektronike <sup>244,245,246,247</sup> janë vënë në funksion të përmirësimit të mësimdhënies dhe nevojave të tjera administrative që lehtësojnë vijimin e punës në funksion të nevojave të studentëve dhe stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi. |

<sup>232</sup> Evidencë-65-Raporte Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.

<sup>233</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>234</sup> Evidencë-116-Rregullore e Praktikave Profesionale Departamenti Psikologjisë 2019.

<sup>235</sup> Evidencë-122-Rregullore Diplomimi Departamenti i Psikologjisë.

<sup>236</sup> Evidencë-142-Takim Alumni Departamenti i Psikologjisë, 2023.

<sup>237</sup> Evidenca-81-Formulari i Vetëvlerësimit të Personelit Akademik, 2019.

<sup>238</sup> Evidencë-48-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit nga studentët.

<sup>239</sup> Evidencë-50-Vlerësimi i Performancës së mësimdhënies nga Kolegu apo Eprori Departamenti Psikologjisë.

<sup>240</sup> Evidencë-65-Raporte Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.

<sup>241</sup> Evidenca-123-Marrëveshje Bashkëpunimi për Programin Erasmus, UAMD.

<sup>242</sup> Evidencë-64- Mobilitetet e Stafit Akademik FE.

<sup>243</sup> Evidencë-73-Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të personelit akademik dhe njësiv.

<sup>244</sup> Evidencë-110-Perdorimi i Sistemit Elektronik

<sup>245</sup> Evidencë-110-Perdorimi i Sistemit Elektronik.

<sup>246</sup> Evidenca-93- Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH).

<sup>247</sup> Evidenca-91-Manuali i Përdorimit të Pitagorës nga Personeli Akademik.

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Konkluzione</b>                         | <p>Bazuar në komentet dhe diskutimet e realizuara nga GVJ lidhur me kriteret e cituara mësipër gjykojmë se ky standart në tërësi nuk ka hapsira për sugjerime duke u konsideruar i përmbushur plotësisht.</p> <p>Institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të hollësishme për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve, dhe aftësive profesionale, dhe siguron zbatimin e tyre. Pas analizës së komenteve dhe diskutimeve të realizuara nga GVJ lidhur me kriteret e përcaktuara mësipër, vlerësojmë se ky standart në përgjithësi nuk ka hapësira për sugjerime dhe mund të konsiderohet i përmbushur plotësisht.</p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | X                            |

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
|---|--|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> | <p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në programin Bachelor në “Psikologji” duke iu referuar syllabuseve të lëndëve mësimore<sup>248</sup> realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Mbështetur në procedurën e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit<sup>249</sup>, vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecurisë së kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlerësimin e performancës akademike të studentit. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim</p> |

<sup>248</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.

<sup>249</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.



|   |   |
|---|---|
|   | ose me gojë. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma për programin e studimit.   |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma për programin e studimit Bachelor në “Psikologji”. Institucioni vë në zbatim të testimit dhe vlerësimit përmes sekretimit të provimeve dhe platformën elektronike “Pitagora” <sup>250,251,252</sup> që është në funksion të testimit dhe vlerësimit duke iu dhënë akses stafit akademik dhe studentëve në kohë reale për t’u regjistruar për provimet, për t’u njohur me vlerësimin dhe për të ankimuar atë. Përdorimi i sistemit <b>CleanScore</b> për korrigjimin e automatizuar të provimeve u ofrohet studentëve me qëllimin që të eliminojë mundësitë dhe format e abuzimit, si dhe të rrisë transparencën në testim dhe vlerësim.  |
| <b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.   | Njësia bazë ka një procedurë të mirëorganizuar <sup>253</sup> në drejtim të hapave e afateve kohore që ndjek në drejtim të miratimit, dhe kohës së përgatitjes së tezës së provimit nga pedagogu i lëndës. Disa prej këtyre aspekteve kanë të bëjnë me; dorëzimin përpara zhvillimit të provimit për t’u miratuar nga Përgjegjësi i njësisë bazë, kur numri i studentëve në sallën e provimit e tejkalon 50% të kapacitetit të saj, pedagogu duhet të përdorë dy teza të ndryshme. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për zhvillimin e provimit, por ai shoqërohet nga një anëtar i stafit akademik. Praktikrat profesionale, dhe mbrojta e diplomave apo provimi i formimit përfundimtar realizohen me komision prej dy ose më shumë anëtarësh. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim nga ana e personelit ndihmës akademik të departamentit që bën sekretimin e tezave. Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të monitoruesve të ngarkuar nga drejtuesi i departamentit, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Tezat janë të sekretuara dhe provimi realizohet duke ruajtur anonimatit e çdo studenti. Ç’sekretimi i tezave të korrigjuara të provimit dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, e cila bën |

<sup>250</sup> Evidencë-110-Perdorimi i Sistemit Elektronik.

<sup>251</sup> Evidenca-93- Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH).

<sup>252</sup> Evidenca-91-Manuali i Përdorimit të Pitagorës nga Personeli Akademik.

<sup>253</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

|   |   |
|---|---|
|   | <p>çsekretimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin student. Nuk kemi evidenca për përdorimin e mjeteve të tjera tëurvejimit të provimit me qëllim që të shmangen abuzimet.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> | <p>Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen, bazuar edhe në rregulloren e departamentit cdo student ka të drejtë të konsultoj tezën, të kërkoj sqarim për notën, të kërkoj rivlersim të notës përmes komisioneve të posacme që ngrihen nga njësia bazë për këtë qëllim<sup>254</sup>. Proçedura të mirëorganizuar për mënyrën, sesi hartohet teza dhe realizimi i vlerësimit në mënyrë të copëzuar që t'u japë mundësi studentëve që iu përshtaten stileve të ndryshme të të nxënimit. Pedagogu i lëndës pas provimit dorëzon në departament tezën orgjinale dhe çelësin e zgjidhjes së tezës, të cilat mund t'i vihen në dispozicion studentit, nëse dëshiron të qartësohet.</p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>  | <p>Njësitë përgjegjëse të UAMD si: - njësia kryesore<sup>255</sup> /bazë<sup>256</sup> dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Respektimi i proçedurave dhe realizimi me korrektësi nga stafi akademik synojnë që përmes rregullave që lidhen me kushtet si mospërdorimi i së njëjtës tezë provimi për grupe që e zhvillojnë provimin në orare të ndryshme, dhe as përsëritja e së njëjtës tezë brenda të njëjtit vit akademik (përfshirë sezonin e riprovimit) japin mundësi të mira për të shmangur plagjiaturën dhe kopjimin në provime dhe detyra. Drejtuesi i Departamentit<sup>257</sup> garanton zbatimin e këtij rregulli.</p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>   | <p>UAMD disponon një proçedurë të mirëfilltë për sa i përket gjithë proçesit që lidhet me proçedurat e provimit, vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimimit nga ana e studentit të programit të studimit Bachelor në "Psikologji". Proçedura që zbatohet nga institucioni përfshin rregullat sipas përcaktimeve përkatëse sesi bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij proçesi të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit<sup>258</sup> dhe në syllabusin e lëndës<sup>259</sup>. Gjithashtu kontrolli i cilësisë realizon kontrolle lidhur me trasparencën në vlersimin me notë duke</p>  |

<sup>254</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>255</sup> Evidenca 4. Rregullore e UAMD 2018.

<sup>256</sup> Evidenca 10. Rregullore e Departamentit Psikologji.

<sup>257</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>258</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>259</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.

|  |   |                             |                            |                             |
|--|---|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
|  | monitoruar komponentët e caktuar të krahasimit të vlerësimit të realizuar nga stafi akademik për lëndë specifike.   |                             |                            |                             |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p> | <p>Institucioni respekton procedurat e njohjes me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlersimit. Këto procedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së programit të studimit<sup>260</sup>. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Komunikimi i vlerësimeve bëhet në respektim të plotë të privatësisë së studentit. Studenti njihet me rezultatet në portalin e studentit ose përmes sekretarisë mësimore. Cdo student ka të drejtë të konsultoj tezën, të kërkoj sqarim për notën, të kërkoj rivlersim të notës përmes komisioneve të posacme që ngrihen nga njësia bazë për këtë qëllim. Duke u bazuar te rregullorja e njësisë bazë<sup>261</sup> por edhe te rregullorja e programit<sup>262</sup> dhe dokumenti mbi sistemin e vlerësimit të studentëve ekziston një procedurë, e cila i jep mundësi studentëve të ndjekin këtë proces në mënyrë korrekte. Rivlerësimi i testimit bëhet nga një komision i posaçëm konform rregullave ligjore dhe në mbështetje të të drejtave të studentit.</p> |                             |                            |                             |
| <b>Konkluzione</b>   | <p><i>GVJ duke iu referuar informacionit dhe dokumentacionit të shqyrtuar për kriteret përkatëse vlerëson se ky standart <b>përbushet plotësisht.</b></i></p> <p><i>Në konkluzion, institucioni siguron një proces vlerësimi të drejtë dhe transparent, duke i bazuar vlerësimet në meritën e secilit student dhe duke përfshirë një procedurë të strukturuar për ankimim. GVJ, duke u nisur nga analiza e informacionit dhe dokumentacionit për kriteret e përcaktuara, vlerëson se ky standard për vlerësimin e drejtë dhe transparent përbushet plotësisht nga institucioni.</i></p>   |                             |                            |                             |
| <b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përbushet</b>  | <b>Përbushet pjesërisht</b> | <b>Përbushet kryesisht</b> | <b>Përbushet plotësisht</b> |
|  |   |                             |                            | X                           |

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<sup>260</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>261</sup> Evidenca 10. Rregullore e Departamentit Psikologji.

<sup>262</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

|  |   |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>                          | <p>Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” i jep mundësi studentëve të zgjerojnë njohuritë në një gamë të gjerë të profileve interdisiplinare në kontekstin e fushës së psikologjisë. Kjo larmishmëri synon të zhvillojë aftësi dhe kompetenca në drejtim të rolit të psikologut bazuar në lëndët mësimore, literaturën e përdorur duke garantuar deri diku njohuri të thelluara që studentët i marrin në ciklin e parë të studimeve. Në drejtim të thellimit të njohurive për aspektet që lidhen me fushën e psikologut dhe në një aftësim për të zhvilluar kompetenca profesionale tek studentët, programi i studimit duhet të garantojë studentëve thellim njohurish dhe të zhvillojë aftësi profesionale, gjë e cila bazuar në stafin akademik<sup>263</sup> të angazhuar në mësimdhënie, syllabuseve<sup>264</sup> dhe literaturës së përdorur duhet të integrohen në mënyrë më të plotë që të përmbushet me sukses ky kriter.</p>                        |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p> | <p>Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” përmes lëndëve specifike të integruar si pjesë e kategorisë D, Lëndëve plotësuese përmes moduleve të teknologjisë së informacionit dhe gjuhës së huaj të cilat mundësojnë që studentët të zhvillojnë aftësi dhe kompetenca të nevojshme për përmbushjen e detyrave të ndryshme profesionale, të komunikimit dhe ndërveprimit duke përdorur njohuri dhe shprehje ndërdisiplinare. UAMD dhe njësia bazë për këtë program studimi synojnë krijimin e kushteve që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit në aspektin praktik përmes trajnimit të studentit për të përdorur sistemin “Pitagora”<sup>265,266,267,268</sup> dhe sistemin online të shfrytëzimit të literaturës në bibliotekat online, apo portalit studentor. Në drejtim të komunikimit dhe ndërveprimit, angazhimi i stafit bashkë me studentët në këto aktivitete ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton student, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen</p>                    | <p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton student, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës përmes udhëzimeve të veçanta dhe vlersimit të njohurive në përfundim të semestrit përkatës. Në vijimësi njësi të tjera si Departamenti<sup>269</sup> dhe</p>   |

<sup>263</sup> Evidencë-77-CV Stafit Akademik i Angazhaur në Bachelor Psikologji 2022-23 .

<sup>264</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjisë.

<sup>265</sup> Evidencë-110-Perdorimi i Sistemit Elektronik

<sup>266</sup> Evidencë-110-Perdorimi i Sistemit Elektronik.

<sup>267</sup> Evidenca-93- Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH).

<sup>268</sup> Evidenca-91-Manuali i Përdorimit të Pitagorës nga Personeli Akademik.

<sup>269</sup> Evidencë-50-Vlerësimi i Performancës së mësimdhënies nga Kolegu apo Eprori Departamenti Psikologjisë.

|  |   |
|--|---|
| <p>në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>   | <p>Njësia e Sigurimit të Cilësisë<sup>270</sup> monitorojnë vijimësinë e realizimit të objektivave formative dhe aspekte të tjera përmes formave të ndryshme të marrjes së të dhënave nga studentet në lidhje me lëndën dhe pedagogët<sup>271; 272; 273,274; 275</sup>. Raporti i punës semestrale analizohet nga ana e cdo pedagogu në përfundim të lëndës së tij duke u ndalur në në sër aspekteve që kanë të bëjnë me mësimdhënien, mësimnxënien të cilat më tej përmbledhen në analizën vjetore të departamentit<sup>276</sup>.</p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijojnë klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p> | <p>Përsa i përket mundësisë për zhvillimin e mësimdhënies mbi bazë kompetencash nuk ka evidenca të qarta që na ndihmojnë të gjykojmë mbi këtë aspekt. Disa module të lëndëve mund të kenë element që krijojnë hapsira për njohuri teorike të marra përmes kualifikimit akademik, por gjithashtu njohuri dhe kompetenca praktike që janë zhvilluar përmes përvojës praktike të fituar drejtpërdrejtë në fushë të cilat përmes diskutimit të studimeve të rasteve të sjella nga vetë pedagogu zhvillojnë kompetencat profesionale të studentëve. Duke iu referuar syllabuseve të lëndëve mësimore<sup>277</sup> por edhe informacionit të marrë në institucion në takimet me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit Bachelor në “Psikologji”, personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të caktuara në kontekstin e profilit të studimit. Përsa i përket bashkëpunimit në drejtim të mësimdhënies me institucionet e tjera kemi nisma me një sër institucionesh brenda dhe jashtë vendit të organizuara nga UAMD si konferenca, ëorkshop-e, leksione të hapura, trajnime të stafit lidhur me rritjen e cilësisë në mësimdhënie<sup>278</sup> Gjithashtu ka një klimë pozitive të ndërveprimit midis stafit dhe studentëve për çështjet mësimore. Procesi i mësimdhënies bazohet në diskutimet e ndryshme, studimet e rasteve, nxitjen e mendimit kritik mbi çështjet që trajtohen duke e vendosur studentin në një pozicion aktiv në drejtim të përvetësimit të dijeve dhe të nxënies në tërësi.</p> |

<sup>270</sup> Evidencë-18- Rezultatet mbi Anketimin e Studentëve, Stafit Akademik dhe Administrativ mbi Institucionin.

<sup>271</sup> Evidencë-28-Takime Alumni.

<sup>272</sup> Evidencë-30-Pyetësor për Alumni UAMD

<sup>273</sup> Evidencë-142-Takim Alumni Departamenti i Psikologjisë, 2023.

<sup>274</sup> Evidenca-81-Formulari i Vetëvlerësimit të Personelit Akademik, 2019.

<sup>275</sup> Evidencë-48-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit nga studentët.

<sup>276</sup> Evidencë-65-Raportet Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.

<sup>277</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.

<sup>278</sup> Evidencë-65-Raportet Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.

|   |  |                                    |                                   |  |
|---|--|------------------------------------|-----------------------------------|--|
| <p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p> | <p>Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë në UAMD ka praktika të mira përsa i përket hapësirave që ka për të përfituar nga përfshirja në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare<sup>279,280</sup>; që janë fituar nga institucioni, përfitimi nga mobiliteti i stafit dhe studentëve përmes projekteve të BE, eventet e ndryshme, të cilat realizohen përgjatë vitit akademik<sup>281</sup> si trajnime, konferenca, simpoziume, leksione të hapura me të ftuar vendas apo të huaj, veprimtari promovuese<sup>282, 283, 284</sup>. Personeli akademik dhe studentët janë të angazhuar në pjesëmarrjen në këto veprimtari. Përmes krijimit të mundësisë për pjesëmarrje në konferencat që UAMD organizon pa pagesë për stafin e tij akademik, mbështjetjen financiare për publikime në revista me faktor impakti etj, krijohen mundësi për përfitimin e përvojave nga kolegë e të tjerëve që do të kenë impakt edhe në këtë program studimi. Gjithashtu veprimtari të vlefshme janë ato me Erasmus +<sup>285,286</sup> për realizimin e mobiliteti i stafit dhe studentëve të tij, që kanë impakt tepër pozitiv për stafin dhe studentët e këtij programi studimi.</p> |                                    |                                   |  |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>GVJ gjykon se indikatorët e shqyrtuar më sipër dhe të përfshirë në këtë standart <b>përbushen plotësisht.</b></i></p> <p><i>GVJ vlerëson angazhimin e Institucionit në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie me struktura të posaçme. Aktivitetet e ndryshme dhe angazhimi i vazhdueshëm, përfshirë mobilitetin, ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e studentëve. Nevojitet përpjekje të vazhdueshme për të siguruar një cilësi të qëndrueshme në arsimin e lartë. GVJ gjykon se ky standart <b>përbushet plotësisht</b></i></p>  |                                    |                                   |  |
| <p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>  | <p><b>Nuk përbushet</b></p>  | <p><b>Përbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p> |

### Standardi III.5

<sup>279</sup> Evidencë-65-Raporte Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.

<sup>280</sup> Evidenca-123-Marrëveshje Bashkëpunimi për Programin Erasmus, UAMD.

<sup>281</sup> Evidencë-64- Mobilitetet e Stafit Akademik FE.

<sup>282</sup> Evidencë-73-Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të personelit akademik dhe njësisiv.

<sup>283</sup> Evidencë-110-Perdorimi i Sistemit Elektronik

<sup>284</sup> Evidencë-40-Shembull trajnimi për Mësimdhënie Staf FE 2023.

<sup>285</sup> Evidencë-64- Mobilitetet e Stafit Akademik FE.

<sup>286</sup> Evidenca-123-Marrëveshje Bashkëpunimi për Programin Erasmus, UAMD.

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

| Kriteret   | Vlerësimi i ekspertëve  |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p> | <p>Bazuar në rregulloren e programit<sup>287</sup> të studimit Bachelor në “Psikologji” dhe në rregulloren e posaçme të diplomimit<sup>288</sup> institucioni ka hartuar procedurë të posaçme për studentët, të cilët mbrojnë diplomën përmes punimit të temës së diplomës për ato student me mesatare mbi 8 (tetë) dhe provimit të formimit. Kriteret për mbrojtje diplome me temë për këtë program studimi bëhen të ditura përmes njësisë bazë dhe kordinatorit të programit. Rregullorja e Diplomimit vendos rregullat normative të marrëdhënieve midis subjekteve të përfshira në procesin e diplomimit, të cilat përcaktojnë të drejtat e detyrimit e diplomantëve, rregullat për organizimin e procesit. Rregullorja ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm rregullator të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit të diplomimit, si dhe të garantojë standarte të cilësisë në hartimin e tezës së diplomës. Rregullorja e Diplomimit mbështetet në ligjin Nr. 80, datë 22.07. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, ligjin nr.8576, datë 03.02.2000 për bibliotekat, Statutin, Rregulloren e këtij universiteti dhe në VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 ‘Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë’. Mbrojtja e diplomës realizohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në përfundim të programit të plotë të studimeve, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës.</li> <li>- Diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar diplomimi.</li> <li>- Studentët të cilët plotësojnë kushtet duhet të paraqesin pranë sekretarisë mësimore të fakultetit “Kërkesën për t’u regjistruar në provimin/temën e diplomës”, të plotësuar sipas formatit të miratuar të paktën dy javë nga data e shpallur nga njësia kryesore për zhvillimin e provimit të diplomimit dhe mbrojtjen e temave të diplomës.</li> </ul> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione,</p>   | <p>Njësia bazë dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e</p>   |

<sup>287</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>288</sup> Evidencë-24- Rregullore e diplomimit FE.




|  |   |
|--|---|
| <p>udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>  | <p>nevojshme<sup>289</sup> ; <sup>290</sup>; <sup>291</sup>; <sup>292</sup> në funksion të mbrojtjes së diplomës. Përsa i përket realizimit të provimit të formimit apo temës së diplomës studentët e këtij programi në përfundim të këtij cikli studimi, diplomohen në profilin e psikologjisë së përgjithshme pas mbrojtjes së diplomës. Departamenti, me fillimin e semestrit të dytë të studimit, përcakton studentët që diplomohen nëpërmjet tezës së diplomës. Njësia bazë përcakton kriteret për studentët të cilët mund të diplomohen me mbrojtje teze diplome. Tezat e diplomës udhëhiqen nga punonjësit mësimor shkencor të departamentit që kanë titull ose gradë shkencore (së paku Master Shkencor për programet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë Master Profesional), nga punonjësit shkencorë të instituteve kërkimore që i përshtaten studimeve të ofruara nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” dhe që kanë kualifikim të lartë, si dhe nga kërkues të fushës përkatëse të diplomimit. Mbrojtja e diplomës ka një procedurë që e lehtëson punën e studentit në drejtim të materialeve që duhet të mësojnë apo të përzgjedhjes së pedagogut udhëheqës sipas profilit të temës dhe monitorimin e punës përmes seancave të konsultimit që janë të detyrueshme nga studenti për t’u ndjekur përgjatë gjithë procesit. Monitorimin e zbatimit të këtyre procedurave për të dyja opsionet sipas kategorive ku bëjnë pjesë studentët, realizot nga njësia bazë.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> | <p>Bazuar në udhëzimin<sup>293</sup> e lidhur me procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së provës finale për diplomimin e studentëve Bachelor në “Psikologji”<sup>294</sup> njësia bazë ngre një komitet shkencor i cili është përgjegjës për të gjitha procedurat që lidhen me diplomimin e studentëve që përmbyllin detyrimet përmbyllëse me mbrojtje teme diplome apo provim të formimit të përgjithshëm përfundimtar. Në rastin e provimit të përgjithshëm përfundimtar komisioni shkencor mbështetet në udhërrëfyesin që u është dhënë studentëve që të rifreskojnë njohuritë e marra. Ky udhërrëfyes bazohet në njohur të marra nga studentët përgjatë 3 viteve të studimit në lëndët e formimit të përgjithshëm dhe ato të specialitetit, që lidhen njohur të thelluara të fushës së psikologjisë dhe njohjen e prespektivave kryesore lidhur me ushtrimin e profesionit.</p>  |

<sup>289</sup> Evidencë-137- Fushat Kërkimore Shkencore të personelit akademik Departamenti i Psikologjisë.

<sup>290</sup> Evidencë-122-Rregullore Diplomimi Departamenti i Psikologjisë.

<sup>291</sup> Evidencë 58 Shembull i Ndarjes së Mentorimit në Departamentin e Psikologjisë.

<sup>292</sup> Evidencë-127-Shembull Takime për Temën e Diplomës Bachelor Psikologji.

<sup>293</sup> Evidenca 13. Rregullore Bachelor Psikologji.

<sup>294</sup> Evidencë-122-Rregullore Diplomimi Departamenti i Psikologjisë.



|   |  |
|---|--|
| <p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> | <p>Stafi akademik ofron mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të punimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. Udhëheqësi e ndihmon studentin të përmirësojë stilin e të shkruarit, por nuk ka përgjegjësi që të bëjë redaktimin e materialit. Udhëheqësi ka përgjegjësinë të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës. Përmes takimeve të rregullta me studentin (të paktën 2-3 orë në javë) për të dhënë këshilla dhe për të qenë në dijeni të ecurisë së punimit e të vlerësojë progresin e studentit rregullisht duke i kërkuar atij të paraqesë një raport të shkruar dhe duke monitoruar punën e tij përkundrejt standardit të kërkuar.</p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>  | <p>Në drejtim të krijimit të mundësive për realizimin e punëve kërkimore nga ana e studentëve jashtë institucionit, ai ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi<sup>295,296; 297; 298</sup>. Megjithatë kemi pak evidenca që na lejojnë të arrijmë në përfundime në lidhje me asistimin e ofruar nga institucioni në terma faktik. Përsa i përket asistimit brenda kemi një sërë lehtësirash që e ndihmojnë studentin, si seancat e konsultave individuale, konsultat me pedagogët e tjerë, aksesin në bibliotekat online, mjedisin e brendshëm të mbuluar me Wi-Fi, biblioteka dhe salla leximi. Përsa i përket përgatitjes së temës së diplomës kemi një procedurë formale të përcaktuar nga rregullorja e programit të studimit dhe monitoruar nga njësia bazë, e cila detyron studentin të paraqesë një projektpropozim pranë njësisë bazë dhe më pas përcaktohet nga komiteti shkencor dhe pedagogu udhëheqës. Për studentin dhe pedagogun udhëheqës janë të detyrueshme seancat e konsultimit individuale përgjatë gjithë procesit të përgatitjes së punimit, si dhe të nënshkrimit nga pedagogu udhëheqës të punimit final para se të dorëzohet tek komisioni i mbrojtjes. Udhëheqësi i diplomës përmes seancave të konsultimit individual i ofron mundësi studentit të ndjekë kriteret në përcaktimin e metodave kërkimore që i lejojnë të mbledh, të administrojë dhe përpunojë të dhënat në mënyrë shkencore.</p> |

<sup>295</sup> Evidenca 129. Marrëveshje Departamenti Psikologji.

<sup>296</sup> Evidenca 108. Shëmbuj Aktivitete Promovuese Departamenti Psikologji.

<sup>297</sup> Evidenca 97. Shëmbuj Aktivitetesh të Publikuara në Facebook Departamenti Psikologji.

<sup>298</sup> Evidenca 78. Kalendari I Aktiviteteve të Departamentit të Psikologjisë 2022-2023.




|   |  |
|---|--|
|   | Roli i udhëheqësit fokusohet në mbështetjen dhe ndihmën e studentit që të njoh dhe respektojë kriteret për realizimin e një punimi shkencor origjinal.   |
| <b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.  | Studenti e mbron temën verbalisht para një komisioni të propozuar nga Komiteti Shkencor i programit. Bazuar në rregulloren e institucionit dhe rregulloren e brendshme të programit të studimit vlerësimi i studentëve në përfundim të provimit të përgjithshëm dhe punimit të diplomës realizohet para komisionit të diplomimit dhe vlerësohet me notë nga ky komision. Komiteti shkencor propozon dhe komisionin e vlerësimit i cili miratohet nga njësi bazë. Ky komision i përbërë nga 3 anëtarë bën dhe vlerësimin e provimit përfundimtar apo të mbrojtjes së diplomës sipas kriterëve të përcaktuara nga institucioni bazuar në sistemin e pikëve. Studentët që nuk vlerësohen me notë kaluese kanë mundësinë e riparimit të punimit. Studentit zakonisht i jepet 15-20 minuta kohë për të paraqitur rezultatet e hulumtimit të tij (duke përdorur kompjuterin ose mjete të tjera sipas nevojës); pastaj, komisioni drejton pyetje. Pyetjet shpeshherë mund të drejtohen dhe nga pjesëmarrësit e tjerë (publiku). Kandidati ka të drejtë të kërkojë pak kohë në mënyrë që të përgatisë përgjigjet (zakonisht deri në 30 minuta). Komisioni i dëgjon përgjigjet dhe jep komentet e tij lidhur me to, ose kërkon shpjegime shtesë. Në fund, komisioni tërhiqet për t'u konsultuar për vlerësimin e punimit të shkruar të kandidatit dhe mbrojtjen e bërë prej tij/saj dhe shpall publikisht rezultatin. Vlerësimi përfundimtar bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse nga nota 4 (katër) deri në 10 (dhjetë). |
| <b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" është konform ligjeve dhe procedurave të Q.SH.A.-së <sup>299</sup> për miratimin e Suplementit të diplomës dhe aneksin e listës së notave <sup>300</sup> . Forma e paraqitjes së diplomës është konform profilit dhe njohurive të fituara përgjatë këtij rrugëtimi profesional të studentëve. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën, listë notash dhe suplementin e diplomës në programin e studimit "Bachelor" në "Psikologji" <sup>301</sup> . Kjo formë e paraqitjes së diplomës është konform dokumentacionit që shoqëron këtë rrugëtim profesional të studentëve. Ky kualifikim emërtohet në të njëjtën formë si në modelin e  |

<sup>299</sup> Urdhër Për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Psikologji", të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës

<sup>300</sup> Evidencë-38-Model Diplome dhe Suplementi Bachelor Psikologji.

<sup>301</sup> Evidencë-38-Model Diplome dhe Suplementi Bachelor Psikologji.

|  |  |                             |                            |                             |
|--|--|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
|  | <p>diplomës dhe në listën e notave e suplementin e diplomës dhe janë të unifikuara dhe me emërtimin, me të cilin programi ka marrë vendimin për hapjen dhe licensimin e tij. Ky program studimi synon ndërthurjen midis kompetencave të përgjithshme kërkimore e profesionale të fushës së psikologjisë dhe pajisjen e studentit me diplomë Bachelor referuar nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).</p>                               |                             |                            |                             |
| <p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p> | <p>Institucioni për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe pajisjen e studentit me informacionin e nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat<sup>302</sup>. Nga takimi me aktorët përkatës mësohet se institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve<sup>303</sup>, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.</p> |                             |                            |                             |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>Bazuar në të dhënat e evidentuara mësipër GVJ gjykon se kriteret e lidhura me standartin <b>përbushen plotësisht</b>.</i></p> <p><i>UAMD demonstroi përkushtim në ndjekjen e një procedurë të qartë për përfundimin e detyrimeve të studentit në programin e studimit dhe siguron dokumentacionin e nevojshëm. GVJ, pas vlerësimit të të dhënave, konkludon se kriteret për këtë standard <b>përbushen plotësisht</b>, dëshmuar nga angazhimi dhe efikasiteti i institucionit në këtë proces.</i></p>  |                             |                            |                             |
| <p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>   | <p>Nuk përbushet</p>   | <p>Përbushet pjesërisht</p> | <p>Përbushet kryesisht</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> |
|  |  |                             |                            | X                           |

|   |                      |                             |                            |                             |
|---|----------------------|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| <p><b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</b></p> | <p>Nuk përbushet</p> | <p>Përbushet pjesërisht</p> | <p>Përbushet kryesisht</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> |
|   |                      |                             |                            | X                           |

<sup>302</sup> Evidenca-98-Rregullore për Arshivimin e Dokumentacionit.

<sup>303</sup> Evidencë-120-Tabela e Numrit të Studentëve FE 2019 2023.

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Standardi IV.1**

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

| Kriteret   | Vlerësimi i ekspertëve  |             |             |      |             |      |             |  |     |     |      |      |      |      |         |   |   |   |   |   |   |
|--|---|-------------|-------------|------|-------------|------|-------------|--|-----|-----|------|------|------|------|---------|---|---|---|---|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin<sup>304</sup> e shqyrtuar përsa i përket nivelit të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe lidhur me lëndët që mbulojnë<sup>305</sup>, gjykojmë se të dhënat bazohen vetëm në CV<sup>306</sup> e stafit PAE/PAK të angazhuar në këtë program studimi. Nga CV e shqyrtuar rezulton se një pjesë e stafit kanë kualifikimin akademik në fusha të ndërjetme studimi pasi profili i tyre del jashtë fushës së psikologjisë në disa raste (S.P. (ekonomik); L.R. (Gjuhë e huaj); E. D (ekonomik.) kualifikime të cilat mund të ketë impakt negativ në cilësinë e mësimdhënies, duke mos qenë brenda fushës së tyre të kompetencës. Një aspekt tjetër që konsiderohet me ndikime negative lidhet me një pjesë të stafit akademik efektiv i cili nuk i zotëron kualifikimit e të tre niveleve (BA, MA, DR) në fushën e psikologjisë. Shqetësim për tu adresuar është dhe fakti se janë evidentuar raste kur pedagogë, të cilët i përkasin kategorisë “Doktor”, janë titullarë të lëndëve dhe moduleve (Dr. O.H., Dr. H.G., Dr. M.P, etj) <sup>307, 308, 309, 310, 311</sup>.</p> <p><i>Bazuar në tabelat 6.1 – 6.3 të RVB, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Psikologji” për tre vite akademike është si më poshtë vijon, ku vihet re se tabela nuk është plotësuar saktë pasi mungonë të dhënat e PAK:</i></p> <table border="1" data-bbox="624 1406 1386 1576"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2020 - 2021</th> <th colspan="2">2021 - 2022</th> <th colspan="2">2022 - 2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table> | Tituj/grada | 2020 - 2021 |      | 2021 - 2022 |      | 2022 - 2023 |  | PAE | PAK | PAE: | PAK: | PAE: | PAK: | Prof.Dr | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| Tituj/grada  | 2020 - 2021   |             | 2021 - 2022 |      | 2022 - 2023 |      |             |  |     |     |      |      |      |      |         |   |   |   |   |   |   |
|  | PAE   | PAK         | PAE:        | PAK: | PAE:        | PAK: |             |  |     |     |      |      |      |      |         |   |   |   |   |   |   |
| Prof.Dr  | 1   | 0           | 1           | 0    | 1           | 0    |             |  |     |     |      |      |      |      |         |   |   |   |   |   |   |

<sup>304</sup> Evidencë-77-CV Stafit Akademik i Angazhuar në Bachelor Psikologji 2022-23 .pdf

<sup>305</sup> Evidencë-43-Ngarkesa mësimore e personelit akademik 2018-2023.pdf

<sup>306</sup> Evidencë-77-CV Stafit Akademik i Angazhuar në Bachelor Psikologji 2022-23 .pdf

<sup>307</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.pdf

<sup>308</sup> Evidencë-46-Personeli Akademik, me Kontratë dhe Ndihmës Akademik Departamenti Psikologji .pdf

<sup>309</sup> Evidencë-132-Personeli akademik i angazhuar në programin Psikologji 2022-2023.pdf

<sup>310</sup> Ev 38. Ngarkesa totale e personelit akademik te programit bachelor Psikologji ne nje vit akademik

<sup>311</sup> Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf

|            |   |   |   |   |   |   |
|------------|---|---|---|---|---|---|
| Prof.As.Dr | 2 | 0 | 2 | 0 | 2 | 0 |
| Dr/PhD     | 2 | 0 | 2 | 0 | 2 | 0 |
| Msc        |   | 1 |   | 1 |   | 1 |
| Në total   | 5 | 1 | 5 | 1 | 5 | 1 |

Për sa i përket kualifikimeve të personelit akademik:

- Për 2020-2021, 80 % e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 30% janë Msc;
- Për 2021-2022, 81% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 19% janë Msc;
- Për 2022-2023, 90% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 10% janë Prof.Dr.; 20 % Prof Asoc.dr. dhe 70 % Dr.) dhe vetëm 10% MSc (vetëm 1).

Sektori i Burimeve Njerëzore<sup>312, 313</sup> i cili ka si mision të siguroj menaxhim efektiv të burimeve njerëzore kanë të dhënat për personelin e angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi. Ky sektor sipas rregullores së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore<sup>314</sup> kujdeset për kushtet e punës, merret me procedurat e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe me stafin ndihmës akademik. Përpilon dokumentacionin për konkurset për marrjen dhe pranimin e punonjësve në punë, plotësimin e tyre me librezat e punës si dhe bën shënimet përkatëse në këto librezat. Përgjigjet për plotësimin e dosjes personale me dokumentacionin e nevojshëm për çdo punonjës të institucionit, mban (në kartotekë) dokumentacionin e plotë dhe të rregullt mbi të dhënat biografike, të kualifikimit dhe të aktivitetit mësimor-shkencor dhe të administratës qendrore, mbi bazën e analizës së të dhënave që disponon. Nga vizita<sup>315</sup> në institucion dhe përzgjedhja rastësore e dosjeve të stafit akademik dhe ndihmës akademik rezulton se dosjet personale me të dhëna të plota ruhen dhe administrohen sipas parashikimeve ligjore.

*GVJ duke u bazuar në disa të dhëna të plota mbi stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi gjykon se si çështje e cila ka nevojë të adresohet është evidentimi i përfshirjes së stafit akademik me kualifikim akademik të ndërmjetëm në realizimin e disa lëndëve dhe moduleve në këtë*

<sup>312</sup> Evidencë-2- Statuti UAMD 2018.pdf neni 103, 104,

<sup>313</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf

<sup>314</sup> Evidenca-25- Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.pdf, neni 6, 7

<sup>315</sup> Shënime nga vizita në institucion.

|  | <p><i>program studimi si dhe hartimi i syllabuseve të lëndëve nga anëtarë të stafit të cilët nuk kanë kualifikimin e duhur për të hartuar programin e lëndës. Të dyja këto aspekte shihen me impakt negativë në implementimin e njohurive të thelluara dhe kompetencave profesionale tek studentët e këtij programi studimi.</i></p>   |              |     |     |           |        |        |           |        |        |           |        |        |
|--|--|--------------|-----|-----|-----------|--------|--------|-----------|--------|--------|-----------|--------|--------|
| <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p> | <p>Nga analiza e informacionin të deklaruar në tabelat 12.1-12.3 të RVB<sup>316</sup>, për ngarkesën mësimore të personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="624 573 1378 797"> <thead> <tr> <th>Viti Akdemik</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>89.5 %</td> <td>10.5 %</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>89.5 %</td> <td>10.5 %</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>89.5 %</td> <td>10.5 %</td> </tr> </tbody> </table> <p>Personeli akademik me kohë të pjesshme mbulon gjithsej 180 orë mësimore (10.5%) nga 17100 orë total në auditor dhe pjesa tjetër mbulohet nga personeli akademik me kohë plotë, Referuar standardeve për personelin akademik të IAL-së, ai duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës<sup>317</sup> mësimore për çdo program studimi dhe nga përlllogaritja e orëve në auditor rezulton se për këtë program rezulton se gërma b) e pikës 2 të udhëzimit zbatohet plotësisht.</p> <p>Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor në IAL dhe specifikisht orët suplementare në auditor nuk mund të jenë më shumë se 200 orë<sup>318</sup> dhe me raste specifike ka të përcaktuar procedurën, ndërkohë nga analiza e dokumentacionit të paraqitur rezulton se stafi PAE i angazhuar në këtë program mbulon orë mësimore që variojnë nga minimum 45 (Dr.J.C) orë mësimore në maksimumin 315 orë mësimore (Dr.A.T) duke mos e kaluar mbingarkesën e 200 orëve suplementare. Përsa i përket personelit akademik me kohë të pjesshme, ai mund të mbulojë ngarkesën vjetore 120 orë në auditor dhe nuk mund të ketë orë suplementare<sup>319</sup> dhe në këtë program mësimor ka vetëm një PAK e cila jep 180<sup>320</sup> orë</p> | Viti Akdemik | PAE | PAK | 2020-2021 | 89.5 % | 10.5 % | 2021-2022 | 89.5 % | 10.5 % | 2022-2023 | 89.5 % | 10.5 % |
| Viti Akdemik   | PAE  | PAK          |     |     |           |        |        |           |        |        |           |        |        |
| 2020-2021  | 89.5 %   | 10.5 %       |     |     |           |        |        |           |        |        |           |        |        |
| 2021-2022  | 89.5 %   | 10.5 %       |     |     |           |        |        |           |        |        |           |        |        |
| 2022-2023  | 89.5 %   | 10.5 %       |     |     |           |        |        |           |        |        |           |        |        |

<sup>316</sup> Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf

<sup>317</sup> Vendimit Nr. 418, datë 10.5.2017, Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre, pika 2, gërma b)

<sup>318</sup> Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018, II, pika 1

<sup>319</sup> Udhëzimi 29, datë 10.09.2018, pika 2

<sup>320</sup> Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf, Tabelat 12.1.12.3




|   |   |
|---|---|
|   | <p>mësimore në auditor duke tejkaluar parashikimet e pikës 2 të Udhëzimit 29.</p> <p>Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbajë në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësi bazë, të shpërndarë në 2 semestre, ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrale, ose 3 lëndë vjetore<sup>321</sup>. Masivisht i gjithë stafi është me 2-3 lëndë semestrale<sup>322</sup>.</p> <p><i>GVJ gjykon se ngarkesa e PAE është konform parashikimeve ligjore, ndërsa ngarkesa e të vetmës PAK të angazhuar për këtë program studimi është shumë më e lartë se ngarkesa ligjore, gjë e cila ndikon negativisht në cilësinë e mësimdhënies dhe përgatitjen e psikologëve profesionistë, ndaj GVJ rekomandon të rishihet angazhimi dhe ngarkesa e PAK-së konform parashikimit ligjor të VKM-së "Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë", ku sanksionohet ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të pjesshme, i cili mbulon ngarkesën vjetore në auditor me 120 orë<sup>323</sup> dhe nuk mund të ketë orë suplementare</i></p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p> | <p>Institucioni përgjithësisht garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv<sup>324</sup>, <sup>325</sup>, <sup>326</sup> që janë pjesë e njësisë bazë. Lidhur me stafin e angazhuar në programin e studimit<sup>327</sup>, për të gjithë periudhën e akreditimit vlerësojmë këtë si aspekt pasi të dhënat përgjithësisht dëshmojnë qëndrueshmërinë e personelit akademik<sup>328</sup> efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore<sup>329</sup>.</p> <p>Qëndrueshmëria e personelit akademik garantohet nëpërmjet tipologjisë PAE të stafit në këtë program, personel i cili ka kontrata paafat dhe është i punësuar pranë IAL prej vitesh. Nga vizita në institucion dhe konsultimi me materialet e DVV u</p>  |

<sup>321</sup> Udhëzimi nr.29, datë 10.09.2018, pika 6.

<sup>322</sup> Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf

<sup>323</sup> VKM 29, datw 10.09.2018, chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/Udhezimi-nr.-29-dt-10.9.2018.pdf

<sup>324</sup> Evidenca-8-Struktura e UAMD 2018.pdf

<sup>325</sup> Evidenca-9-Organigrama FE, 2019.pdf

<sup>326</sup> Evidencë-46-Personeli Akademik, me Kontratë dhe Ndihmës Akademik Departamenti Psikologji .pdf

<sup>327</sup> Evidencë-117-Kontratat e punës të Personelit Akademik Departamenti i Psikologjisë.pdf

<sup>328</sup> Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf, Tabela1, 2 dhe 4

<sup>329</sup> Shënime nga vizita në institucion.




|  |   |
|--|---|
|  | <p>onfirmua se dhe ajo prej vitesh kishte të njëjtat marrëdhënie me UAMD. Procedurat për rekrutimin e personelit akademik, janë të reflektuara në aktet normative e rregulative të institucionit<sup>330</sup>,<sup>331</sup> dhe në konformitet me bazën ligjore dhe aktet normative në fuqi.</p> <p>GVJ konstatoi që procedura e rekrutimit është në përputhje me Ligjin 80/2015<sup>332</sup>, Kodin e Punës në RSH dhe aktet ligjore e normative në fuqi. Gjithashtu edhe sektori i burimeve njerëzore ka të standartizuar politikat dhe procedurat për qëndrueshmërinë dhe statusin e personelit<sup>333</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> | <p>Institucioni ndjek një procedurë rekrutimi për personelin akademik transparente<sup>334</sup>, të bazuar në merita dhe me angazhimin e disa sektorëve<sup>335</sup>. UAMD shpall konkursin për vënde të lira punë, sipas strukturës së përgjithshme në nivel institucional, të miratuar nga Bordi i Administrimit dhe njoftimi bëhet me publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike në formë të shkruar dhe elektronike; gjithashtu njoftimet publikohen dhe në faqen ëeb të UAMD-së<sup>336,337</sup>. Sektori i burimeve njerëzore brenda 5 ditësh nga afati i përfundimit të aplikimeve përgatit listën e kandidatëve dhe njofton kryetarin e komisionit <i>ad hoc</i> për tërheqjen e dosjeve të aplikimit. Sipas dokumentacionit ka përgjegjësinë të kujdeset për rekrutimin e stafit me aftësi, njohuri dhe ekspertizë e eksperiencën e duhur për të ndihmuar UAMD në arritjen e objektivave të saj<sup>338</sup>. Kjo zyrë kujdeset që njësia bazë të marr vendimin në bazë të kriterve të përcaktuara nga baza ligjore në fuqi mbi rregullat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik<sup>339</sup>, Ligjin Nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligji për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr.9887 dt.10.03.2008 ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” etj. Procedurat e përcaktuara nga institucioni në lidhje me afatet,</p> |

<sup>330</sup> Evidencë-2- Statuti UAMD 2018.pdf

<sup>331</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf, Kreu V

<sup>332</sup> Evidenca-60-Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt.22\_07\_2015.pdf

<sup>333</sup> Evidenca-25- Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.pdf

<sup>334</sup> <https://uamd.edu.al/mundesipunesimi/>

<sup>335</sup> Evidencë-2- Statuti UAMD 2018.pdf, Neni 45

<sup>336</sup> [chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/09/FormularAplikimi\\_Akademik-1.pdf](chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/09/FormularAplikimi_Akademik-1.pdf)

<sup>337</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf, Neni 103

<sup>338</sup> Evidencë-114-Procedurë për rekrutimin e personelit akademik UAMD.pdf

<sup>339</sup> Evidenca-25- Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.pdf



|   |  |
|---|--|
|   | <p>kriteret e përgjithshme dhe specifike për tu bërë pjesë e stafit akademik të UAMD-së janë konform rregullores për burimet njerëzore dhe rregullores së institucionit, dhe në linjë me udhëzimet dhe legjislacionin për arsimin e lartë në vend. Kriteret shpallen publikisht në faqen online të UAMD-së dhe përzgjedhja bëhet me dy faza. Faza e parë është vlerësimi i dosjes 70 % e vlerësimit total dhe faza tjetër intervista me 30 % të vlerësimit. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve i nënshtrohen intervistës. Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti konform ligjit për arsimin e lartë dhe udhëzimeve të tjera në fuqi. Drejtuesi i njësisë kryesore krijon komision <i>ad hoc</i> i cili në përfundim të shqyrtimit të dosjes së aplikimit dhe intervistës plotëson formularin përmbledhës dhe bën renditjen e aplikantëve sipas përkëve të përfituara<sup>340</sup>. Duke iu referuar përzgjedhjes së stafit akademik në linjë me modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit duhet të kihet parasysh përzgjedhja e stafit me kualifikim akademik brenda profilit të psikologjisë. GVJ konfirmon që institucioni ka miratuar dhe zbaton me rigorozitet procedura rekrutimi dhe vlerësimi që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit.</p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në strukturën akademike dhe ndihmës akademike dhe të infrastrukturës në shërbim të këtij programi<sup>341</sup>, gjujkojmë se UAMD plotëson më së miri nevojat e studentëve të këtij programi studimi. Në lidhje me këtë kriter dhe duke analizuar edhe kurrikulën e programit të studimit<sup>342</sup> konstatojmë se nuk ka orë laboratorike, por institucioni garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor të përshtatshëm për mirëmbajtjen e mjediseve mësimore. Institucioni ka ndërtuar një strukturë të tërë ndihmës akademike dhe sektorë mbështetës<sup>343</sup> të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për mirëmbajtjen e mjediseve në përdorim të studentëve<sup>344</sup>.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion komunikimi me stafin e pranishëm në takim na dha mundësi të qartësohemi plotësisht në lidhje me këtë aspekt. Vërtetohet se ka procedura që ndiqen nga njësitë përkatëse përgjegjëse për infrastrukturë dhe mbarëvajtjen e procesit të realizimit të orëve praktike që synojnë nxitjen e</p>  |

<sup>340</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf, Neni 103, pika 11

<sup>341</sup> Evidenca-8-Struktura e UAMD 2018.pdf

<sup>342</sup> Evidencë-34-Kurrikula Bachelor Psikologji, Plani Mesimor dhe Veprimtarite Formuese.pdf

<sup>343</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf, Seksioni II

<sup>344</sup> Evidencë-71-Infrastruktura UAMD.pdf

|   |  |
|---|--|
|   | kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar.   |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p> | <p>UAMD, nëpërmjet strukturave të saj dhe konkretisht nëpërmjet Departamentit të Psikologjisë<sup>345</sup> dhe Drejtorisë të Burimeve Njerëzore<sup>346</sup> garanton menaxhim efektiv të personelit të angazhuar në programin e studimit “Psikologji”. Sektori i burimeve njerëzore<sup>347</sup> është struktura përgjegjëse për mbajtjen (në kartotekë) të dokumentacionit të plotë dhe të rregullt mbi të dhënat biografike, të kualifikimit dhe të aktivitetit mësimor-shkencor dhe të administratës qendrore, mbi bazën e analizës së të dhënave që disponon; ndjek ndryshimin e numrit të të gjithë personelit në institucion, të pagave përkatëse si dhe realizimit të tyre.; ndjek daljet në pension të të gjithë personelit sipas legjislacionit dhe kryen veprimet përkatëse; nxjerr të dhënat e personelit që i nevojiten drejtuesve të institucionit, si dhe strukturave të tjera në kuadrin e studimeve të aktiviteteve të miratuara nga Rektorati; nxjerr të dhëna mbi personelin e Universitetit “Aleksandër Mosiu” Durrës, kur këto i kërkohen nga drejtuesit e institucionit apo drejtoritë e tjera të Administratës së Rektoratit. Stafit akademik dhe ndihmës kanë dosjet personale me të dhëna të plota<sup>348</sup>. Ky sektor merret me procedurat e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe me stafin ndihmës akademik. Departamenti dhe ky sektor dhe mban evidenca për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër<sup>349</sup>. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik<sup>350, 351, 352, 353, 354</sup> si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. GVJ kontrollon në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik dhe vërejtje se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit.</p> |

<sup>345</sup> Evidencë-10-Rregullore Departamenti Psikologjisë.pdf

<sup>346</sup> Evidenca-25- Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.pdf

<sup>347</sup> Evidenca-25- Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.pdf, Neni 7

<sup>348</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf, Neni 104, pika 2

<sup>349</sup> Evidencë-65-Raport Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.pdf

<sup>350</sup> Evidencë-6-Raport Vjetor UAMD 2021-2022.pdf

<sup>351</sup> Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf

<sup>352</sup> Evidencë-43-Ngarkesa mësimore e personelit akademik 2018-2023.pdf

<sup>353</sup> Evidencë-44-Tabela e udhëheqjeve të temave të diplomave Bachelor Psikologji 2020-2021.pdf

<sup>354</sup> Evidencë-77-CV Stafit Akademik i Angazhuar në Bachelor Psikologji 2022-23 .pdf




|  |   |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> | <p>UAMD ka nënshkruar marrëveshje me një sër institucionesh dhe organizatash të tjera me qëllim krijimin e gjithë infrastrukturës së nevojshme për realizimin e praktikave profesionale, përmbylljen e studimeve të diplomës dhe të aktiviteteve të tjera formuese për programin e studimit “Psikologji”<sup>355, 356</sup>. Rregullorja e praktikës profesionale përcakton detyrat e departamentit, stafit akademik dhe studentëve. Praktikantët mësimorë<sup>357</sup> profesionale realizohen në institucione të ndryshme private ose publike me të cilët universiteti ka marrëveshje<sup>358</sup> por dhe që kanë të specifikuar në organikën e tyre funksionin e psikologut. Institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar. Bazuar në informacionin e dosjes së vet-vlerësimit dhe takimeve apo informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi për përmbushjen e objektivave të këtij program studimi. UAMD-ja ka angazhuar personel akademik, personel akademik dhe kërkues, personel ndihmës akademik dhe personel administrative. Personeli akademik me tituj akademik, “Profesor i Asociuar” gradë shkencore “Doktor i Shkencave” dhe “Master Shkencor” janë angazhuar në role të ndryshme si atë të kordinatorit, udhëheqësit shkencor<sup>359</sup>, supervizorit të praktikës duke mbikëqyrur<sup>360</sup> në sër veprimtarish në funksion të nevojave të këtij programi studimi.</p> |
| <p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë</p>   | <p>Departamenti ka nënshkruar një sër marrëveshjes institucionale<sup>361</sup> të lidhura me institucione dhe organizata në funksion të realizimit të objektivave formuese në funksion të procesit mësimorë. Vlen të theksohet edhe shfrytëzimi i këtyre marrëveshjeve për qëllime të praktikave profesionale<sup>362</sup>, aktivitete të tjera me natyrë ekstrakurrikulare<sup>363, 364, 365</sup> orë të hapura me lektorë të ftuar, takime pune dhe mundësive për mobilitet të stafit<sup>366</sup> dhe studentëve në të cilat janë angazhuar anëtarë të stafit akademik dhe profesionist të institucioneve me</p>   |

<sup>355</sup> Evidencë-49-Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-s.pdf

<sup>356</sup> Evidencë-94-Marrëveshje Bashkëpunimi midis AADF dhe UAMD.pdf

<sup>357</sup> Evidencë-116-Rregullore e Praktikave Profesionale Departamenti Psikologjisë 2019.pdf

<sup>358</sup> Evidencë-129-Marrëveshje Departamenti Psikologji.pdf

<sup>359</sup> Evidencë-44-Tabela e udhëheqjeve të temave të diplomave Bachelor Psikologji 2020-2021.pdf

<sup>360</sup> Evidencë-130- Vlerësimi i mbikëqyrësit për praktikantin Bachelor Psikologji.pdf

<sup>361</sup> Evidencë-129-Marrëveshje Departamenti Psikologji.pdf

<sup>362</sup> Evidencë-116-Rregullore e Praktikave Profesionale Departamenti Psikologjisë 2019.pdf

<sup>363</sup> Evidencë-125-Mobilitete të Studentëve FE.pdf

<sup>364</sup> Evidencë-97-Shembuj aktivitetesh të Publikuara në Facebook Departamenti i Psikologjisë.pdf

<sup>365</sup> Evidencë-62-Shembull Aktiviteti Alumni UAMD.pdf

<sup>366</sup> Evidencë-64- Mobilitetet e Stafit Akademik FE.pdf




| pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | të cilat bashkëpunon <sup>367</sup> . Ndër më të rëndësishmet për këtë program është ajo me Nr.prot.129, datë 31.01.2022 ndërmjet FE, UAMD dhe Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë, neni 2. Këto marrëveshje <sup>368</sup> me disa institucione kyçe për profilin e psikologut janë shfrytëzuar për nevojat e studentëve të programit studimit.   |                      |                       |                      |                       |  |  |   |  |
|--|---|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|--|
| <b>Konkluzione</b>   | <i>GVJ bazuar në dokumentacionit në lidhje me ngarkesën e stafit akademik të angazhuar në këtë programi studimi na lejon që të shprehemi në mënyrë përfundimtare mbi përmbushjen e këtij standarti. Bazuar në dokumentacionin e vetëm të vënë në dispozicion, CV-të e stafit akademik gjykojmë se një pjesë e tyre kanë kualifikimin akademik në profile të përafërta duke mos qenë në linjë me profilin e këtij programi studimi ku janë angazhuar në mësimdhënie në lëndë apo module. Bazuar në sa më sipër GVJ gjykon se ky standart përmbushët kryesisht.</i> |                      |                       |                      |                       |  |  |   |  |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>                         | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>  | Nuk përmbushet       | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |  |  | X |  |
| Nuk përmbushet   | Përmbushet pjesërisht   | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |                      |                       |  |  |   |  |
|  |   | X                    |                       |                      |                       |  |  |   |  |

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve   |
|---|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës është një institucion që siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse <sup>369</sup> . Aktiviteti i tij ushtrohet në dy kampuse në 2 godina, ku Departamenti i Psikologjisë, i cili ofron programin e studimit “Psikologji” e përmbushin këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse <sup>370</sup> . Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral. Personeli akademik ka një zyrë të veçantë, e cila shërben edhe si zyrë mbledhjesh dhe takimesh. IAL disponon gjithashtu auditorë për leksione/seminare, salla kompjuteri dhe laborator, sallë |

<sup>367</sup> <https://uamd.edu.al/stars-eu/>

<sup>368</sup> Evidencë-129-Marrëveshje Departamenti Psikologji.pdf

<sup>369</sup> Evidencë-71-Infrastruktura UAMD.pdf

<sup>370</sup> Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf

|  |  |
|--|--|
|  | <p>interneti, të pajisura me infrastrukturën bazike mësimore. Zyrrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, IT, Biblioteka janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre<sup>371</sup>.</p> <p>Mësimi në Programin e studimit Bachelor në "Psikologji" ka në dispozicion salla leksioni, seminari, zyra dhe një sallë laboratorit të cilat kanë infrastrukturën e duhur për një proces normal të të nxënësve<sup>372</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> | <p>Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor, laptop, whiteboard, platform online dhe të gjitha mjetet e tjera logjistike<sup>373</sup>. Mjediset mësimore në dispozicion të programit të studimit "Psikologji" janë 23 salla për leksion; 23 klasa për seminare; 2 salla për aktivitete promovionale; 2 laboratorë për lëndët; 2 laboratorë informatike; janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore. Labororet e teknologjisë së informacionit që janë në funksion të zbatimit të këtij program studimi, janë të kompletuar me pajisje kompjuterike (videoprojektor dhe kompjutera të lidhur me internet), janë të aksesueshme nga të gjithë studentët dhe teknologji bashkëkohore,<sup>374375</sup>.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të</p>  | <p>Nga vizita në institucion, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit DVV rezulton se mjediset mësimore të ofruara nga UAMD janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme<sup>376</sup>, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike. Programi i studimit kryen aktivitetin e tij në Godinën 1 ku institucioni siguron hapësirë të përshtatshme, të tilla si: laboratore, klasa, zyra dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe teknologji informacioni, siç janë: videoprojektorët, kompjuteret dhe interneti për të realizuar programin e studimit<sup>377</sup>. Mjediset mësimore, auditoret, janë të mirëpajisura me tabela dhe dërrasa dhe në çdo klasë ka të instaluar pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (si PC, videoprojektor, TV,</p>                                     |

<sup>371</sup> Evidencë-71-Infrastruktura UAMD.pdf

<sup>372</sup> Evidenca-52-Tabela e Kapaciteteve, 2019-2020.pdf

<sup>373</sup> Evidenca-52-Tabela e Kapaciteteve, 2019-2020.pdf

<sup>374</sup> Evidencë-115- Licensimi i programeve kompjuterike UAMD.pdf

<sup>375</sup> Evidencë-115- Licensimi i programeve kompjuterike UAMD.pdf

<sup>376</sup> Evidencë-71-Infrastruktura UAMD.pdf

<sup>377</sup> Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf

|   |  |
|---|--|
| <p>programit të studimit në tërësi.</p>   | <p>kamera dixhitale dhe pajisje CD /DVD/VHS). Rrjeti i internetit është shtrirë në të gjithë mjediset e universitetit, në mjediset mësimre dhe në të gjitha mjediset e tjera rrethuese.</p> <p>Në institucion ndodhet dhe zyra e IT, e cila asiston me teknologjinë e informacionit në të gjithë rastet e nevojshme, por gjithashtu asiston dhe studentët me nevoja të veçanta dhe ushtron veprimtari sipas manualit përkatës<sup>378</sup>. Në universitet funksion dhe sistemi Pitagora dhe Cleanscore<sup>379</sup>, i cili është një krijues kuizesh me mjete të zgjuara analize që e bëjnë atë ideal për mësuesit dhe studentët</p> <p>Klasat dhe auditoret e UAMD janë të pajisura infrastrukturen e nevojshme për një proces efektiv të mësimdhënies në përputhje me qëllimet e programit. Gjithashtu në këtë program përdoren metodologjitë teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies sisteme që mundësojnë perditësimin dhe ndërveprimin me materialet e lëndës dhe me pedagogun përgjegjës. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmon se mjediset mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit dhe që garantojnë realizimin e procesit mësimor. Më shumë se 50% e hapësirës anësore të të gjitha sallave ku realizohet mësimi është me dritare, duke garantuar ndriçim natyror dhe ajrosje të mjaftueshme.</p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p> | <p>Profesioni i psikologut dhe programi i studimit i cili i referohet këtij profesioni prezanton një fushë të shkencës të aplikuar dhe si e tillë ndikimi laboratorik nuk është aq i rëndësishëm sa ndikimi praktik, i cili këshillohet të realizohet nëpërmjet seminareve ose në mënyrë më të drejtpërdrejtë nëpërmjet praktikës profesionale në institucione<sup>380</sup>. Në mjediset e institucionit ka pajisje dhe aparatura të cilët vihen në përdorim të studentëve<sup>381</sup> sipas kërkesave të tyre për realizimin e detyrave të kursit ose edhe për aktivitete të tjera jashtëshkollore dhe aktivitete të ndryshme studentore. Labororet e teknologjisë së informacionit që janë në funksion të zbatimit të këtij program studimi<sup>382</sup>, janë të kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe janë të aksesueshëm për të gjithë studentët. Laboratori ishte në dispozicion të studentëve për të realizuar detyrat, disa orë edhe për mësimdhënie edhe për</p>  |

<sup>378</sup> Evidencë-115- Licensimi i programeve kompjuterike UAMD.pdf

<sup>379</sup> Evidencë-146-Shembull Tabelë e rezultateve të studentëve me CleanScore.pdf

<sup>380</sup> Evidencë-13-Rregullore Bachelor Psikologji.pdf

<sup>381</sup> Evidencë-71-Infrastruktura UAMD.pdf

<sup>382</sup> Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | takimet apo projektet e ndryshme studentore. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në një sër aplikacionesh dhe programesh teknologjike si SPSS, Jetstore, ESC apo dhe Office 365. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmon se mjediset e vëna në dispozicion përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve siç janë vidioprojektorët, mjetete audiovozove, interenti apo edhe tabelat e shënimeve, të cilat mundësojnë aftësimin teorik e praktik dhe realizimin e objektivave formues të programit të studimit punonjës social. |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>                         | <i>GVJ konkluton se mjediset mësimore dhe infrastruktura e vënë në dispozicion nga IAL është e përshtatshme, garanton realizimin e procesit mësimdhënës dhe formimin teorik dhe atë praktik, të posaçëm referuar natyrës dhe fushës së studimit në psikologji, duke gjykuar se ky standart përmbushet plotësisht.</i>  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | X                            |

### Standardi IV.3


**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
|--|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | <p>Literatura bazë në gjuhën shqipe<sup>383</sup>, e cila është dhe gjuha e realizimit të këtij programi studimi përfshin tekste të cilat nëse i referohemi syllabuseve të lëndëve mësimore të vënë në dispozicion krijojnë hapsira për përmirësim. Një pjesë e literaturës bazë gjykohet si literaturë joakademike, jo e 5 viteve të fundit, dhe jo e përditësuar duke mos garantuar marrjen e dijeve bashkëkohore.</p> <p>I referohemi këtu literaturës së përdorur për disa lëndë e cila është bazuar në botime të psikologjisë që kryesisht i përket një dekade më parë. Përsa i përket literaturës në formë elektronike<sup>384</sup> në gjuhë të huaj mund të thuhet se është bërë një përpjekje pozitive përmes abonimit në bibliotekën online<sup>385</sup> rezulton se për nevojat e studentëve janë vënë në dispozicion një sër platformash elektronike si ERIC, MEDLINE, Ebsco</p> |

<sup>383</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.pdf

<sup>384</sup> Evidenca-85-Biblioteka Online-Të Dhëna mbi Materialet e Disponueshme.pdf

<sup>385</sup> Evidenca-84-Biblioteka Online-Manual Përdorimi.pdf

|   |   |
|---|---|
|   | <p>Open Dissertation dhe DOAJ (Directory of Open Access Journals) të cilat mund të lehtësojnë aksesin në burime bibliografike të viteve të fundit dhe që janë publikime shkencore të indexuara dhe me faktor impakti. Sfidë për studentët e këtij programi studimi mbetet niveli i njohurive në gjuhën angleze me qëllim që të përfitojnë nga këto mundësi që u krijohen nga insititucioni, të cilat vijnë të përmirësohen<sup>386</sup>.</p> <p><i>GVJ sugjeron se ky aspekt të hapsira për përmirësim duke rishikuar programet e studimit me përmirësime mbi literaturën bazë dhe të detyruar të përditësuar me tekste akademike të 5 viteve të fundit.</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p> | <p>Duke iu referuar dokumentacionit të DVV të shqyrtuar një tjetër aspekt lidhet me kërkesën e fundit për tituj nga ana e njësive bazë për vitin 2022-2023 sipas të cilës ka dhe metodologji për përzgjedhjen e teksteve për këtë departament<sup>387</sup>.</p> <p>Duke iu referuar burime të literaturës në format libër, të depozituar dhe të aksesueshëm lirisht nga stafi dhe studentët e këtij programi studimi kemi<sup>388</sup> të dhëna të përgjithshme të numrit të kopjeve në bibliotekën e institucionit, të cilat janë kryesisht në gjuhën shqipe dhe disa në gjuhë huaj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i titujve fizikë në fond: 7000</li> <li>• Numri i ekzemplarëve: 25.000 (nuk përfshihen masterat (4500); artikujt shkencorë (mbi 4000) dhe librat elektronikë (mbi 30.000)</li> <li>• Numri i teksteve mësimore: 2500</li> </ul> <p>Duke iu referuar relacionit të aktivitetit të bibliotekës rezultojnë se nuk janë bërë blerje librash nga institucioni që prej vitit 2016. Nuk janë bërë investime për shtim hapësirash fizike apo për infrastrukturën në përgjithësi<sup>389</sup>. Situata e tillë e burimeve të literaturës në gjuhën shqipe në dispozicion të programit të studimit të ciklit të parë konsiderohet e papërshtatshme pasi përbëhet nga libra të viteve të hershme të botimit dhe jo në të gjitha rastet kemi tekste të shfrytëzueshme për nevojat akademike, kjo ndër të tjera edhe për cilësinë e dobët të tyre, të njohurive të vjetëruara e të papalikeshme dhe jo të vlefshme për formimin e profesionistëve të ardhshëm të psikologjisë.</p> <p><i>GVJ sygjeron që kjo situatë të adresohet sa më herët. Të përpilohen rregullore dhe të forcohen politikat e institucionit të</i></p> |

<sup>386</sup> Evidencë-89-Plani Strategjik i Bibliotekës 2020-2025.pdf

<sup>387</sup> Evidencë-121-Metodologjia e përzgjedhjes së teksteve Departamenti Psikologji.pdf

<sup>388</sup> Evidencë-87-Relacion për aktivitetin e Bibliotekës UAMD.pdf

<sup>389</sup> Evidencë-87-Relacion për aktivitetin e Bibliotekës UAMD.pdf, fq.4






|   |   |
|---|---|
|   | <i>cilat të përcaktojnë procedurat për përditësimet e literaturës dhe aksesimin e saj nga studentët e programit psikologji.</i>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> | <p>Biblioteka e UAMD<sup>390</sup> është në dispozicion të studentëve dhe operon në të tre kampuset e këtij universiteti<sup>391</sup>. Njësia qendrore e saj është në godinën 1, kampusin universitar, ka një hapsirë prej 238.8 m<sup>2</sup> dhe me 120 vende leximi dhe një mjedis për shfrytëzimin e bibliotekës on-line<sup>392</sup>. Në të gjenden dy salla: salla me fond të hapur, ku përveç fondit të literaturës ofohet dhe internet, fondi i librave i hapur dhe mund të konsultohet lirshëm nga studentët; dhe salla me fond të mbyllur për përdorim literature vetëm në sallën e leximit. Gjithashtu janë në funksionim dhe dy biblioteka të tjera, një në Godinën Universitare në Currila dhe biblioteka në Godinën nr. 2 të kampusit. Biblioteka mbulon një sër shërbimesh si arkivim të çdo kopje të libri të ri fizik që hyn, dixhitalizim të skedarëve, arkivim të punimit të diplomës, vendadresim i stafit dhe studentëve për nevojat që lidhen literaturën mësimore<sup>393</sup>, kërkimore dhe ekstrakurrikulare, me një fond prej 8000 titujsh në huaj dhe në shqip<sup>394, 395</sup>. Orarat për ditët e javës dhe gjatë fundjavës janë 8.00-16.00, sipas një kalendari të miratur nga drejtori i drejtorisë së administrimit dhe shërbimeve akademike<sup>396</sup>.</p> <p>Si një bibliotekë me fonde të hapura dhe hibride, ajo mundëson kërkim të informacionit “online”, në sallën e leximit, skedarë elektronikë, lehtësira në kërkimin bibliografik të informacionit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike pranë kompjuterave të sallës. Biblioteka është lehtësisht e aksesueshme nga të gjithë studentët dhe stafi akademik, numri i të anëtarësuarve fizikë është afërsisht 1100<sup>397</sup>. Gjithashtu nga studentët e programit psikologji shfrytëzohet edhe për aktivtete ekstrakurrikulare. GVJ konfirmon që ambjenti ishte i përshtatshëm me ajër dhe ndriçim natyral, me vendosje të tavolinave në mënyrë që shfrytëzimi i tyre të bëhet në mënyrë të barabartë nga studentët<sup>398</sup>. Studentët kanë të drejtë të</p> |

<sup>390</sup> <https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/>

<sup>391</sup> Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf

<sup>392</sup> Evidenca-84-Biblioteka Online-Manual Përdorimi.pdf

<sup>393</sup> Evidencë-111-Literaturë mbështetëse për Programin Bachelor Psikologji qe gjenden ne

Biblioteken e FE UA.pdf

<sup>394</sup> Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf,

<sup>395</sup> Shënime të vizitës në institucion

<sup>396</sup> Evidenca-86-Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.pdf

<sup>397</sup> Evidencë-87-Relacion për aktivitetin e Bibliotekës UAMD.pdf

<sup>398</sup> Evidenca-83-Rregullore e Bibliotekës.pdf



|   |   |
|---|---|
|   | huazojnë libra dhe të përdorin shërbimet e bibliotekës si gjatë javësh, ashtu edhe gjatë fundjavës.   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> | <p>Biblioteka e Universitetit “Aleksandër Moisiu” funksionon sipas Ligjit Nr. 8576, datë 3.2.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve rregullative të institucionit<sup>399, 400</sup>.</p> <p>Numri i kopjeve fizike të saj është<sup>401</sup>:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i librave që i shërbejnë programeve të studimit: 2500</li> <li>• Numri i librave që i shërbejnë detyrave dhe projekteve: mbi 6500</li> </ul> <p>Literatura bazë në gjuhën shqipe, e cila është dhe gjuha e realizimit të këtij programi studimi përfshin një literaturë e vënë në dispozicion paraqet një sër problemesh. Një pjesë e literaturës bazë gjykohet si e papërshtatshme për tu përdorur pasi nuk është literaturë akademike. Një bazë e literaturës së përdorur është bazuar në botime të psikologjisë që kryesisht janë përkthime amatore që paraqesin probleme në terminologjinë e fushës dhe në shtrembërimin e koncepteve bazë të fushës. Problematikë edhe më shqetësuese është fakti se pavarësisht kërkesave të bibliotekës për shtim fondi asnjë kërkesë nuk është plotësuar<sup>402</sup> dhe nuk janë bërë blerje librash nga institucioni që prej vitit 2016<sup>403</sup>. Nuk janë bërë investime për shtim hapësirash fizike apo për infrastrukturën në përgjithësi. Përsa i përket literaturës në formë elektronike në gjuhë të huaj mund të thuhet se është bërë një përpjekje pozitive përmes abonimit në bibliotekën online. Gjithashtu ka shërbime në platforma dhe link-et për aksesimin e bibliotekave ndërkombëtare online<sup>404</sup>. Biblioteka ka marrëveshje bashkëpunimi si me institucione të huaja të cilat i mundësojnë akses në rrjetet e tyre të bibliotekave online ose abonime të ndryshme ashtu dhe me institucione vendase si Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, shtypshkronja dhe organizata të tjera të fushës<sup>405</sup>.</p> <p><i>GVJ rekomandon që të merren urgjentisht masat e nevojshme nga organet drejtuese të Universitetit në mënyrë që për të gjithë modulet e veprimtarive mësimore jo vetëm ato të</i></p> |

<sup>399</sup> Evidenca-83-Rregullore e Bibliotekës.pdf

<sup>400</sup> Evidenca-84-Biblioteka Online-Manual Përdorimi.pdf


<sup>401</sup> Evidencë-87-Relacion për aktivitetin e Bibliotekës UAMD.pdf

<sup>402</sup> Evidencë-87-Relacion për aktivitetin e Bibliotekës UAMD.pdf, fq. 5

<sup>403</sup> Evidencë-87-Relacion për aktivitetin e Bibliotekës UAMD.pdf, fq. 4

<sup>404</sup> Evidenca-84-Biblioteka Online-Manual Përdorimi.pdf

<sup>405</sup> Evidenca-84-Biblioteka Online-Manual Përdorimi.pdf




|   |   |
|---|---|
|   | <p><i>programit "Psikologji" në bibliotekë të gjenden, tekstet mësimore bazë, literatura ndihmëse, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të përditësuara referuar specifikës së programit të studimit.</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p> | <p>Kapacitetet e bibliotekës garantojnë mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programit të studimit. Biblioteka Universitare, në shtator 2014, instaloi falas Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj. Katalogu ofron një version të avancuar në kërkimin e informacionit. Përveç përshkrimit bibliografik, katalogu ofron falas në formatin elektronik artikuj, teza, kërkimin shkencor dhe disertacionet e stafit akademik të Universitetit "Aleksandër Moisiu". Biblioteka përfaqësohet në Bibliotekën Virtuale të Shqipërisë "COBIB.AL", dhe koleksioni i saj përpunohet nga ana shkencore bibliografike konform standardeve ndërkombëtare duke përdorur UDC (sistemi i klasifikimit), ISBD (International Standard Bibliographic Description), formatin MARC, Z39.50 SRU<sup>406</sup>.</p> <p>Institucioni ofron platformën e bibliotekës digjitale ULibrary në linkun <a href="https://ulibrary.rash.al">https://ulibrary.rash.al</a> si dhe manualin e përdorimit EBSCO. Shërbimet e bibliotekës ofrohen pa pagesë për të gjithë studentët e UAMD-së dhe për personelin e institucionit. Shërbimi i informacionit elektronik ofrohet me e-mail/katalog elektronik. Çdo student ka të drejtën e anëtarësismit falas në bibliotekë dhe te aksesit të platformat online si JSTOR, Open Dissertations.org (Ebsco Open Dissertation), EBSCO, BiblioLabs, DOAJ (Directory of Open Access Journals)<sup>407</sup>.</p> |

<sup>406</sup> <https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/>

<sup>407</sup> <https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/>




|  |  |
|--|--|
| <p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>                        | <p>Biblioteka në mesin 2 të UAMD<sup>408</sup> të saj ka një hapsirë prej 238.8 m<sup>2</sup> dhe me 120 vende leximi. Biblioteka gjithashtu është e pajisur me programet kompjuterike të shërbimeve të bibliotekës dhe me pajisjet teknike si kompjuterat me akses në internet<sup>409</sup>. Në këtë bibliotekë mundësohet shfrytëzimi i sistemeve me bazë “kod në burim të hapur”, si modul i sistemit të integruar për menaxhimin e fondit të Bibliotekës katalogu online.uamd.edu.al<sup>410</sup>; njëkohësisht regjistrimet gjenden edhe pranë Bibliotekës Virtuale të Shqipërisë</p> <p><a href="https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/search?db=udu">https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/search?db=udu</a></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Katalogu Botëror WorldCat <a href="http://www.worldcat.org/">http://www.worldcat.org/</a></li> <li>• Katalogu i Bibliotekës Britanike <a href="http://catalog.bl.uk/">http://catalog.bl.uk/</a></li> <li>• Katalogu i Bibliotekës së Kongresit Amerikan <a href="http://catalog.loc.gov/">http://catalog.loc.gov/</a></li> <li>• Index Translationum <a href="http://databases.unesco.org/xtrans/xtra-form.shtml">http://databases.unesco.org/xtrans/xtra-form.shtml</a></li> <li>• Katalogu përmbledhës i bibliotekave të Francës – CCFr <a href="http://ccfr.bnf.fr/portailccfr/servlet/LoginServlet">http://ccfr.bnf.fr/portailccfr/servlet/LoginServlet</a></li> </ul> <p>Studentët para se të aksesojnë librarinë online duhet të jenë të regjistruar në sistemin Pitagora dhe për këtë ka udhëzime edhe online<sup>411</sup>. Për përdorimin e bibliotekës online në dispozicion të studentëve dhe të të interesuarve është dhe një manual<sup>412</sup>, i cili mundëson shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Shërbimi i informacionit elektronik (me e-mail/katalog elektronik) është e hënë- e diel: 8:00-20:00<sup>413</sup>. Dhe për çdo pyetje apo paqartësi studentët nxiten të kontaktojnë në <a href="mailto:info@uamd.edu.al">info@uamd.edu.al</a>.</p> |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të</p> | <p>Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë nga ora 08.00 – 16.00, në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Sipas punonjësve të bibliotekës ky orar krijon kushte optimale për akses tek fondi i librave. Hapësira fizike dhe kapaciteti i saj i jepnin mundësi një numri të konsiderueshëm studentësh për shfrytëzim të ambjenteve në të njëjtën kohë, dhe duke pasur mundësi për shfrytëzimin e disa</p>  |

<sup>408</sup> Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf

<sup>409</sup> Evidencë-87-Relacion për aktivitetin e Bibliotekës UAMD.pdf

<sup>410</sup> <https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/>

<sup>411</sup> <https://uamd.edu.al/pitagora/>

<sup>412</sup> Evidenca-84-Biblioteka Online-Manual Përdorimi.pdf

<sup>413</sup> <https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/>

|   |   |                       |                      |                       |
|---|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.  | këndeve të saj që të lejonin të punojë në privatësi dhe pa u shpërqëndruar. Të gjithë të interesuarit mundet gjithashtu që të vihen në kontakt me punonjësit e bibliotekës dhe të kërkojnë shërbime dhe informacione edhe më të specializuara në <a href="mailto:info@uamd.edu.al">info@uamd.edu.al</a> .   |                       |                      |                       |
| <b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | <p>Bazuar në dokumentacionin që na është vënë në dispozicion në DVV<sup>414</sup>, <sup>415</sup>, <sup>416</sup>, <sup>417</sup>, <sup>418</sup>, <sup>419</sup>, <sup>420</sup> për programin e studimit “Psikologji”, dhe në mënyrë të veçantë relacionit për aktivitetin e bibliotekës, dhe vizitës në institucion u informuam se njësitë përgjegjëse për programin dhe biblioteka periodikisht kanë hartuar kërkesat për përditësimin e fondit fizik, të cilat nuk janë përmbushur nga institucioni, nga ku rezulton se prej vitit 2016 se nuk është pasuruar fondi i librave.</p> <p>Përsa i përket fondit të librave online ai është rritur dhe përditësuar, kjo dhe falë bashkëpunimeve dhe projekteve; kështu biblioteka dixhitale EBSCOhost numëron akses në një mori platformash online me një fond të pakushtëzuar dhe të përditësuar. Gjithashtu edhe aksesit i pakushtëzuar në JSTORE garanton akses në më shumë se 1000 revista shkencore, mijra libra, qindra raporte në fushën e psikologjisë.</p> |                       |                      |                       |
| <b>Konkluzione</b>  | <i>GVJ bazuar në këtë standart gjykon se dy aspektet që lënë hapsirë për përmirësim janë të lidhura me kërkesat për blerje të rezultojnë nga një analizë dhe përputhshmëri me modulet e programit, të jenë minimalisht tituj të pakten të 5 viteve të fundit, si dhe të jenë të fokusuara kryesisht në gjuhën e programit (shqip) si dhe të përmbushin kriteret për tekste akademike me ISBN. Për sa më sipër gjykojmë se ky aspekt përmbushet kryesisht.</i>   |                       |                      |                       |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | Nuk përmbushet  | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |

<sup>414</sup> Evidenca-83-Rregullore e Bibliotekës.pdf

<sup>415</sup> Evidenca-84-Biblioteka Online-Manual Përdorimi.pdf

<sup>416</sup> Evidenca-85-Biblioteka Online-Të Dhëna mbi Materialet e Disponueshme.pdf

<sup>417</sup> Evidenca-83-Rregullore e Bibliotekës.pdf

<sup>418</sup> Evidencë-87-Relacion për aktivitetin e Bibliotekës UAMD.pdf

<sup>419</sup> Evidencë-89-Plani Strategjik i Bibliotekës 2020-2025.pdf

<sup>420</sup> Evidencë-121-Metodologjia e përzgjedhjes së teksteve Departamenti Psikologji.pdf

|  |  |  |          |  |
|--|--|--|----------|--|
|  |  |  | <b>X</b> |  |
|--|--|--|----------|--|

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

| Kriteret   | Vlerësimi i ekspertëve  |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> | <p>Sipas dokumentacionit të DVV-së institucioni<sup>421</sup> përdor sistemin Piragora<sup>422</sup>, i cili është një platformë elektronike<sup>423</sup> nëpërmjet të cilës krijohen, ruhen, përditësohen dhe saktësohen të dhëna për studentët<sup>424</sup> e regjistruar në këtë universitet nga faza e regjistrimit, ruajtja e vlerësimeve dhe diplomimi. Në këtë program departamentet ndihmëse (sekretari<sup>425</sup>, financë, etj) kanë akses të limituar sipas profilizimit të informacionit<sup>426</sup>. Sektori IT<sup>427</sup> është përgjegjës për procedurën e regjistrimit online të studentëve, i cili publikon afatet, rregullat dhe udhëzimet përkatëse se si do të zhvillohet procesi i regjistrimit; çdo student regjistrohet në këtë universitet nëpërmjet portalit U-Albania dhe vetëm pas regjistrimit sektori IT i pajis studentët e vitit të parë me fjalëkalimin dhe emrin e përdoruesit për të garantuar akses në regjistrat online<sup>428</sup>. Nëpërmjet këtij sistemi studentët mund të aksesojë në llogarinë personale të tij të dhënat akademike dhe të dhëna të tjera sensitive, siç janë ato financiare, po ashtu dhe stafi akademik ka akses vetëm në të dhënat akademike, duke ofruar mundësi përdorni të dhënash vetëm për përmbushjen e funksioneve<sup>429</sup>. Sistemi është i konfiguruar me role të përcaktuara dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënash të centralizuar. Sistemi ofron informacione të ndryshme për vijueshmërinë e vitit aktual akademik.</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin,</p>   | <p>Referuar statutit<sup>430</sup> të universitetit dhe rregullores së tij<sup>431</sup>, administrimi i informacionit menaxhohet sipas strukturave përgjegjëse të institucionit. Ky informacion ruhet në formën hardcopy dhe elektronike në disa njësi të universitetit, siç janë:</p>   |

<sup>421</sup> Evidenca-8-Struktura e UAMD 2018.pdf

<sup>422</sup> Evidencë-128-Regjistrimi i Studentëve UAMD në sistemin Pitagora.pdf

<sup>423</sup> Evidenca-90-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.pdf

<sup>424</sup> Evidenca-93- Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH).pdf

<sup>425</sup> Evidenca-25- Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.pdf

<sup>426</sup> Evidenca-7-Rregullore FE.pdf, Kreu VII

<sup>427</sup> Evidenca-90-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.pdf

<sup>428</sup> Evidenca-7-Rregullore FE.pdf, Neni 84

<sup>429</sup> Evidencë-128-Regjistrimi i Studentëve UAMD në sistemin Pitagora.pdf

<sup>430</sup> Evidencë-2- Statuti UAMD 2018.pdf

<sup>431</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf




|   |  |
|---|--|
| <p>dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>                                    | <p>Departamenti<sup>432</sup>, Fakulteti<sup>433</sup>, Universiteti, Zyra e Burimeve Njerëzore<sup>434</sup>, Sekretaria mësimore<sup>435</sup>, IT<sup>436</sup> dhe një sër Zyrash të tjera të cilat secila sipas funksionit është e mandatuar të menaxhojë, monitorojë, krijoj apo auditoj aktivitete të ndryshme të personelit akademik, ndihmës akademik administrativ apo dhe të tjera veprimtari jashtë universiteti. I gjithë komunikimi në UAMD mundësohet përmes rrjetit të brendshëm të tij dhe sistemit Pitagora<sup>437</sup>, i cili garanton ndarjen në mënyrë të sigurt të informacioneve univeristare dhe burimet kompjuterike prej nga nisen këto informacione.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>   | <p>Institucioni zbaton me rigorozitet detyrimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale që lindin nga Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 dhe gjithë akteteve të tjera ligjore<sup>438</sup> mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve të sektorit privat.</p> <p>Sistemi Pitagora<sup>439</sup> siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Çdo përdorues<sup>440</sup> ka kodin dhe fjalëkalimin e tij në sistemin e menaxhimit të të dhënave.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> | <p>Bazuar në dokumentat e dorëzuar në DVV<sup>441, 442, 443, 444</sup>, dhe vizita në institucion<sup>445</sup>, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion për komunikimin e brendshëm interaktiv të stafit akademik dhe studentëve në platformën Pitagora, e cila siguron akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, akses i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin, regjistrimi i provimeve, vlerësimet nga pedagogu, vlerësimet përfundimtare të lëndës. Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse. Gjithashtu</p>                                 |

<sup>432</sup> Evidencë-10-Rregullore Departamenti Psikologjisë.pdf

<sup>433</sup> Evidenca-7-Rregullore FE.pdf

<sup>434</sup> Evidenca-25- Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.pdf

<sup>435</sup> Evidenca-98-Rregullore për Arshivimin e Dokumentacionit.pdf

<sup>436</sup> Evidenca-90-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.pdf

<sup>437</sup> Evidenca-91-Manuali i Përdorimit të Pitagorës nga Personeli Akademik.pdf

<sup>438</sup> Evidenca-90-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.pdf

<sup>439</sup> Evidencë-128-Regjistrimi i Studentëve UAMD në sistemin Pitagora.pdf

<sup>440</sup> Evidencë-110-Perdorimi i Sistemit Elektronik.pdf

<sup>441</sup> Evidencë-128-Regjistrimi i Studentëve UAMD në sistemin Pitagora.pdf

<sup>442</sup> Evidenca-90-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.pdf

<sup>443</sup> Evidenca-91-Manuali i Përdorimit të Pitagorës nga Personeli Akademik.pdf

<sup>444</sup> Evidenca-93- Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH).pdf

<sup>445</sup> Shënime gjatë vizitës në institucion




|   |  |
|---|--|
|   | <p>departamenti komunikon edhe me platforma të tjera<sup>446</sup>, të hapura e publike, kryesisht ne rrjetet sociale me informacione më të përgjithshme e në kohë reale. Të gjithë përdoruesit kanë akses në informacion dhe mund të menaxhojnë detyra dhe aktivitete në lidhje me punën, sipas rolit dhe pozicionit të tyre të punës. GVJ nga vizita në institucion<sup>447</sup> dhe takimet me stafin akademik dhe studentët e konfirmuan shkëmbimin në kohë reale të informacioneve dhe të njoftimeve që realizoheshin nëpërmjet sistemeve të menaxhimit dixhital.</p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p> | <p>Për të gjithë përdoruesit e tij, sistemi i menaxhimit Pitagora siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik, administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për ta<sup>448</sup>. Të dhënat me më tepër frekuencë janë listat emërore të studentëve, raportimet statistikore mbi kurset, notat, por dhe të dhëna të tjera si oraret dhe frekuentimet dhe kërkesat e tjera ligjore<sup>449</sup>.</p> <p>Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si dhe u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimet të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Po ashtu institucioni ruan dhe komunikimin dhe koordinimin midis stafit akademik dhe studentëve si fizikisht ashtu dhe me anë të kontakteve telefonike dhe e-maileve zyrtare të tyre dhe platformave sociale. GVJ gjatë vizitës në institucion dhe kryesisht gjatë takimit me studentë konfirmoi që të gjithë përdoruesit kanë akses në informacionet e tyre të personalizuara sipas roleve dhe njësive përkatëse. Stafit akademik dhe administrativ çlirohen nga detyrat e lodhshme manuale. Sistemi i menaxhimit u siguron atyre informacione të përditësuar.</p> |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra</p>                                     | <p>Në faqen zyrtare të UAMD-së <a href="https://uamd.edu.al/">https://uamd.edu.al/</a> paraqitet një informacion i plotë mbi filozofinë dhe misionin, partnerët, drejtimin dhe funksionimin, organigramën; guidat për studentët e ardhshëm si dhe mbi programet, së bashku me bio të detajuara të personelit akademik etj. Përmes saj, por edhe rrjeteve sociale, institucioni promovon veprimtaritë e</p>   |

<sup>446</sup> Evidenca-101-Të Dhëna nga faqja Facebook e FE\_.pdf

<sup>447</sup> Shënime gjatë vizitës në institucion

<sup>448</sup> Evidencë-99-Të Dhënat nga Website-i i UAMD-së .pdf

<sup>449</sup> Evidenca-93- Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH).pdf






|   |   |                                     |                                    |                                     |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>prej tyre është gjuha shqipe.</p>              | <p>ndryshme me karakter akademik por edhe social-kulturor. Kjo faqe bën publikimin në dy gjuhë, shqip dhe anglisht<sup>450</sup>.</p> <p>Faqja web paraqet në mënyrë të strukturuar informacione mbi universitetin, pranimet, fakultetet, programet e studimit, për studentët, projektet dhe shërbimet për studentë.</p> <p>Kjo faqe është lehtësisht e aksesueshme <a href="https://uamd.edu.al/departamenti-i-psikologjise/">https://uamd.edu.al/departamenti-i-psikologjise/</a>, dhe programi i studimit “Psikologji”, gjithashtu ka faqen e vet të internetit <a href="https://uamd.edu.al/psikologji/">https://uamd.edu.al/psikologji/</a>. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm dhe në të gjendet informacion i përgjithshëm mbi regjistrimin, objektivat e programit dhe kurrikulat. Universiteti jep informacion të dedikuar për studentët e tij dhe jetën akademike, por i kushton vëmendje dhe aspekteve të tjera zhvillimore rinore nëpërmjet faqes së dedikuar <a href="https://uamd.edu.al/manifesti-studentor/">https://uamd.edu.al/manifesti-studentor/</a></p> <p>Gjatë vizitës GJV konstatoi se informacionet e publikuara në faqen e internetit ishin të përdorshme e të nevojshme për studentët.</p> |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Konkluzione</b></p>                         | <p><i>GJV bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe në informacionet e marra gjatë vizitës në institucion gjykon se UAMD disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional Pitagora dhe e ka vënë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për të gjithë universitetin, ashtu dhe për programin e studimit “Psikologji, ndaj ky standart përmbushet plotësisht.</i></p>  |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p> | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>  | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |
|   |   |                                     |                                    | X                                   |

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<sup>450</sup> Evidenca-100-Thirrje të publikuara në faqen zyrtare të UAMD.pdf



| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> | <p>Bazuar në të dhënat e shqyrtuara nga GVJ, në materialet e DVV-së informohemi se Departamenti ka hartuar planin e financimit të programit të studimit Bachelor në “Psikologji”<sup>451</sup>, për të cilin ka marrë në konsideratë sa më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="635 365 1372 902"> <thead> <tr> <th>Parashikimet</th> <th>Të Ardhura</th> <th>Shpenzime</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Totali vjetor i të ardhurave të pritshme për t’u arkëtuar <sup>452</sup></td> <td>1375000</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Numri i Punonjesve 16</td> <td></td> <td>4678</td> </tr> <tr> <td>Shpenzime për blerje mallrash dhe shërbimesh për funksionimin e institucionit</td> <td></td> <td>3841000</td> </tr> <tr> <td>Shpenzime vjetore për kërkimin shkencor</td> <td></td> <td>1,068</td> </tr> <tr> <td>Preventiv për pajisje elektronike</td> <td></td> <td>330,000</td> </tr> </tbody> </table> <p>Ky parashikim hartohet duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet në drejtimin që ato do përdoren<sup>453</sup>.</p> <p>GVJ eidentoj se Departamenti ka hartuar pasqyra dhe raporte financiare të të ardhurave<sup>454, 455</sup> të cilat përfshihen dhe në plan buxhetin për mbarëvajtjen e programit, ndërsa nuk eidentoi raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi nga universiteti.</p> | Parashikimet | Të Ardhura | Shpenzime | Totali vjetor i të ardhurave të pritshme për t’u arkëtuar <sup>452</sup> | 1375000 |  | Numri i Punonjesve 16 |  | 4678 | Shpenzime për blerje mallrash dhe shërbimesh për funksionimin e institucionit |  | 3841000 | Shpenzime vjetore për kërkimin shkencor |  | 1,068 | Preventiv për pajisje elektronike |  | 330,000 |
|--|---|--------------|------------|-----------|--|---------|--|-----------------------|--|------|---|--|---------|---|--|-------|-----------------------------------|--|---------|
| Parashikimet   | Të Ardhura  | Shpenzime    |            |           |  |         |  |                       |  |      |   |  |         |   |  |       |                                   |  |         |
| Totali vjetor i të ardhurave të pritshme për t’u arkëtuar <sup>452</sup>   | 1375000   |              |            |           |  |         |  |                       |  |      |   |  |         |   |  |       |                                   |  |         |
| Numri i Punonjesve 16  |   | 4678         |            |           |  |         |  |                       |  |      |   |  |         |   |  |       |                                   |  |         |
| Shpenzime për blerje mallrash dhe shërbimesh për funksionimin e institucionit  |   | 3841000      |            |           |  |         |  |                       |  |      |   |  |         |   |  |       |                                   |  |         |
| Shpenzime vjetore për kërkimin shkencor  |   | 1,068        |            |           |  |         |  |                       |  |      |   |  |         |   |  |       |                                   |  |         |
| Preventiv për pajisje elektronike  |   | 330,000      |            |           |  |         |  |                       |  |      |   |  |         |   |  |       |                                   |  |         |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në</p>  | <p>Plani i financimit të programit të studimit<sup>456</sup> përfshin në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si edhe aksesin në bibliotekat on-line.</p>   |              |            |           |  |         |  |                       |  |      |   |  |         |   |  |       |                                   |  |         |

<sup>451</sup> Evidencë-109-Plan Buxheti për Programet e Studimit në Departamentin e Psikologjisë 2022-23.pdf

<sup>452</sup> Evidencë-124- Vendimet për tarifat dhe pagesat studentore.pdf

<sup>453</sup> Evidencë-109-Plan Buxheti për Programet e Studimit në Departamentin e Psikologjisë 2022-23.pdf

<sup>454</sup> Evidencë-124- Vendimet për tarifat dhe pagesat studentore.pdf

<sup>455</sup> Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf, Tabela 18

<sup>456</sup> Evidencë-109-Plan Buxheti për Programet e Studimit në Departamentin e Psikologjisë 2022-23.pdf




| <p>shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p> | <p>Departamenti ka hartuar planin e financimit të progamit të studimit Bachelor në “Psikologji”<sup>457</sup>, për të cilin ka marrë në konsideratë sa më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="624 271 1369 808"> <thead> <tr> <th>Parashikimet</th> <th>Të Ardhura</th> <th>Shpenzime</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Totali vjetor i të ardhurave të pritshme për t’u arkëtuar <sup>458</sup></td> <td>1375000</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Numri i Punonjesve 16</td> <td></td> <td>4678</td> </tr> <tr> <td>Shpenzime për blerje mallrash dhe shërbimesh për funksionimin e institucionit</td> <td></td> <td>3841000</td> </tr> <tr> <td>Shpenzime vjetore për kërkimin shkencor</td> <td></td> <td>1,068</td> </tr> <tr> <td>Preventiv për pajisje elektronike</td> <td></td> <td>330,000</td> </tr> </tbody> </table> <p>Ky plan financimi për progamin Bachelor në “Psikologji” është hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre. Në këtë plan financiar përfshihen shpenzimet operative për blerje mallrash e shërbimesh dhe preventive për pajisje elektronike mbështetëse të procesit mësimor, dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij<sup>459</sup>.</p> | Parashikimet | Të Ardhura | Shpenzime | Totali vjetor i të ardhurave të pritshme për t’u arkëtuar <sup>458</sup> | 1375000 |  | Numri i Punonjesve 16 |  | 4678 | Shpenzime për blerje mallrash dhe shërbimesh për funksionimin e institucionit |  | 3841000 | Shpenzime vjetore për kërkimin shkencor |  | 1,068 | Preventiv për pajisje elektronike |  | 330,000 |
|--|---|--------------|------------|-----------|--|---------|--|-----------------------|--|------|---|--|---------|---|--|-------|-----------------------------------|--|---------|
| Parashikimet   | Të Ardhura  | Shpenzime    |            |           |  |         |  |                       |  |      |   |  |         |   |  |       |                                   |  |         |
| Totali vjetor i të ardhurave të pritshme për t’u arkëtuar <sup>458</sup>   | 1375000   |              |            |           |  |         |  |                       |  |      |   |  |         |   |  |       |                                   |  |         |
| Numri i Punonjesve 16  |   | 4678         |            |           |  |         |  |                       |  |      |   |  |         |   |  |       |                                   |  |         |
| Shpenzime për blerje mallrash dhe shërbimesh për funksionimin e institucionit  |   | 3841000      |            |           |  |         |  |                       |  |      |   |  |         |   |  |       |                                   |  |         |
| Shpenzime vjetore për kërkimin shkencor  |   | 1,068        |            |           |  |         |  |                       |  |      |   |  |         |   |  |       |                                   |  |         |
| Preventiv për pajisje elektronike  |   | 330,000      |            |           |  |         |  |                       |  |      |   |  |         |   |  |       |                                   |  |         |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>  | <p>UAMD kryen auditim të përvitshëm bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstatoi se institucioni kryen auditim të brendshëm, dhe referohet vetëm një raport vjetor i UAMD-së për vitin 2021-2022<sup>460</sup>.</p> <p>Raporti vjetor i institucionit hartohet nga njësia e auditimit të brendshëm<sup>461</sup>, dhe auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur e cila jep siguri objektive. Statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm përcaktohen në Kartën e Auditit të UAMD-së.</p> <p>Auditimi periodik gjendet vetëm për një vit akademik, dhe sygjerohet dokumentimi i auditimit për të gjithë periudhën.</p>   |              |            |           |  |         |  |                       |  |      |   |  |         |   |  |       |                                   |  |         |

<sup>457</sup> Evidencë-109-Plan Buxheti për Programet e Studimit në Departamentin e Psikologjisë 2022-23.pdf

<sup>458</sup> Evidencë-124- Vendimet për tarifat dhe pagesat studentore.pdf

<sup>459</sup> <https://uamd.edu.al/infomacion-mbi-buxhetin/>

<sup>460</sup> Evidencë-6-Raport Vjetor UAMD 2021-2022.pdf

<sup>461</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf, neni 95



|  |   |
|--|---|
|  | Dokumentimi dhe gjendja e financimit gjenden dhe ne faqen web të institucionit <sup>462</sup> .   |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.   | Në dokumentin të ardhurat dhe financimet e Ndryshme <sup>463</sup> të UAMD-së, informohemi mbi të ardhurat nga pushteti vendor/qendror, nga grantet për kërkimin dhe kontratat; tarifat dhe përgjatë shkollimit; sponsorizimet; shërbimet trajnuese; dhe aktivitetet tregëtare, të cilat tregojnë që institucioni ka burime në dispozicion për financimin e programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij, por specifikuat raportim në nivelin e njësisë bazë, mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës nuk u arrit të evidentohet. Nga shqyrtimi i DVV-së evidentohet raporti financiar për shpenzimet dhe të ardhurat e realizuara për vitin akademik 2021-2022 <sup>464</sup> , por raportimet janë ose në nivel universiteti ose në nivel fakulteti, duke mos mundësuar kuptueshmërinë mbi realizimin e buxhetit për këtë program studimi. Gjatë vizitës në institucion na u prezantua dhe procedura që ndjek institucioni.   |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve. | Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion <sup>465</sup> në raportin e GVB-së dhe vizitës pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” GVJ ka konkluduar se raportet financiare të institucionit janë të dokumentuara, por jo të specifikuara për të gjithë programet e studimit të aktivizuara në këtë institucion. Hartimi i një raporti në lidhje me raportimet financiare të deritanishme dhe më specifikuat dhe me planifikimet financiare për periudhën pasardhëse dhe me transparencën financiare i jep mundësi institucionit të këtë një opinion ligjor të pavarur mbi pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit dhe me qëndrueshmërinë financiare. Raporti financiar i cili përgatitet nga Rektorati dhe miratohet nga Bordi i Administrimit bazohet në planifikimet e kryera në programimin financiar. Sipas raportit të planit financiar të programit të studimit Bachelor në “Psikologji” dëshmohet një qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete të mjaftueshme për sigurimin në vijimësi të veprimtarive akademike e institucionit. |
| <b>Konkluzione</b>   | <i>GVJ gjykon se bazuar në evidencat e mësipërme dhe disa aspekteve që lidhen me komponentëve mësimore me të cilat po punohet për t'i përafruar me ligjet në fuqi, nisur nga</i>  |

<sup>462</sup> <https://uamd.edu.al/infomacion-mbi-buxhetin/>

<sup>463</sup> Evidencë-95-Tabela e të Ardhurave UAMD.pdf

<sup>464</sup> Evidenca-103-Raport i Veprimtarisë Financiare UAMD, 2021-2022.pdf

<sup>465</sup> Evidenca-103-Raport i Veprimtarisë Financiare UAMD, 2021-2022.pdf

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <i>angazhimi i njësisë bazë, gjykojmë se në tërësinë e tij ky standard <u>përmbushet kryesisht</u>.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              | X                           |                              |

|  |                       |                              |                             |                              |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |                       |                              |                             | X                            |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

|  |   |
|--|---|
| <b>Standardi V.1</b>   |   |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b> |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.            | Në përputhje me legjislacionin në fuqi, UAMD ka hartuar statutin <sup>466</sup> dhe rregulloren e universitetit <sup>467</sup> , të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik <sup>468</sup> <sup>469</sup> të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore <sup>470</sup> <sup>471</sup> <sup>472</sup> . Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu informacion mbi organikogramën e Fakultetit, dhe strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e kolegjit si edhe një informacion më pak i detajuar shfaqet në faqen e webit të UAMD-së, |

<sup>466</sup> Evidencë-2- Statuti UAMD 2018.pdf

<sup>467</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf

<sup>468</sup> Evidenca-60-Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt.22\_07\_2015.pdf

<sup>469</sup> Evidenca-7-Rregullore FE.pdf

<sup>470</sup> <https://uamd.edu.al/procedura-per-pajisjen-e-studenteve-me-program-studimi-2/>

<sup>471</sup> Evidencë-13-Rregullore Bachelor Psikologji.pdf

<sup>472</sup> Evidencë-10-Rregullore Departamenti Psikologjisë.pdf

|   |   |
|---|---|
|   | <p><a href="https://uamd.edu.al/fakulteti-i-edukimit/">https://uamd.edu.al/fakulteti-i-edukimit/</a>. Ky program studimi është organizuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në fuqi. Dhe të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme e këtij programi studimi. Informacioni për kriteret dhe kuotat e pranimit<sup>473</sup>, procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese dhe është pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve dhe aktiviteteve të Departamentit<sup>474</sup>.</p> <p>GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Konkretisht për regjistrimet në këtë cikël studimi, pranohen studentët bazuar në kuotat e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes së miratiara nga MAS.</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe vizitës në insitucion GVJ konstaton se institucioni mbështetet në rregulloren e tij<sup>475</sup>, procedurën e transferimit (neni 56), për të rregulluar në përputhje me ligjet në vend nga hyrja në dalje. Kandidati duke ndjekur një procedurë të caktuar dhe në afatet ligjore të përcaktuara me ligj mund të kryej ndërprerjen, transferimin e studimeve në përputhje me rregulloren e programit të studimit<sup>476</sup> duke siguruar të drejta të plota për të gjithë. Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme<sup>477</sup> të këtij institucioni. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese dhe është pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve.</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për</p>  | <p>Referuar Udhëzimit<sup>478</sup> të MAS kriteret dhe procedura e pranimit në universitet realizohet nëpërmjet QSHA-së dhe portalit përkatës.</p>   |

<sup>473</sup> <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/KRITERET-UAMD-2023-2024.pdf>

<sup>474</sup> Evidencë-29-Java e Orientimit dhe Guida e Studentit.pdf

<sup>475</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf

<sup>476</sup> Evidencë-13-Rregullore Bachelor Psikologji.pdf, neni 34

<sup>477</sup> Evidenca-7-Rregullore FE.pdf, neni 571

<sup>478</sup> <https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-10-date-15-05-2019-per-procedurat-e-aplikimit-dhe-te-regjistrimit-ne-programet-e-ciklit-te-pare-te-studimeve-ne-programet-e-studimeve-me-karakter-profesional-si-dhe-ne-programet-e-integr/>




|  |  |
|--|--|
| <p>përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>  | <p>Në faqen zyrtare të institucionit<sup>479</sup> janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimit bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dokumentacioni që kërkohet, kohëzgjatja e programit dhe numri i krediteve që fiton studenti. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente. Institucioni me anë të senatit akademik merr vendimet<sup>480</sup> e nevojshme mbi miratimin e kriterëve për pranimin e studentëve në këtë institucion. Kriteret parashikojnë pranime edhe për shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> | <p>Miratimi<sup>481</sup> i kriterëve të pranimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, dhe i pasqyron këto informacione edhe në faqen zyrtare<sup>482</sup> duke i mundësuar aksesin kujtdo që është i interesuar në çdo kohë<sup>483</sup>, në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Senatit. Bazuar në vendimin e senatit për miratimin e kuotave të pranimit për vitin akademik 2022-2023<sup>484</sup> për programin Bachelor në “Psikologji” janë miratuar 60 kuota, ku 50 janë për shtetas shqiptar brenda vendit, 2 kuota për aplikantë për program të dytë studimi, 3 kuota për transferimet e studentëve, 1 koutë për minoritetin Romë dhe Egjiptian, 1 koutë për personat AK dhe të tjerat janë kuota për aplikantët nga trojet shqipfolëse. Në rregulloren mësimore të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Psikologji” ka të specifikuar kriteret që duhet të plotësohen për t'u pranuar në programin e studimit, informacione të cilat janë dhe lehtësisht të aksesueshme<sup>485</sup>.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konfirmon që kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve janë në përputhje me VKM në fuqi dhe ka edhe Vendim senati për kuotat. Edhe procedurat për përparimin e studentëve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e institucionit.</p> |

<sup>479</sup> <https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/>

<sup>480</sup> Evidenca-54-Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studentëve (1).pdf

<sup>481</sup> Evidenca-54-Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studentëve (1).pdf

<sup>482</sup> <https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/>

<sup>483</sup> Evidenca-96-Programi i Transparencës UAMD.pdf

<sup>484</sup> Evidenca-55-Vendim Senati për Shpërndarjen e Kuotave në Ciklet e Studimit UAMD.pdf

<sup>485</sup> Evidenca-101-Të Dhëna nga faqja Facebook e FE\_.pdf




|   |   |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> | <p>GVJ edhe gjatë vizitës në IAL konfirmoi organizimi i ditëve të informimit për maturantët e shkollave të mesme dhe Open Days<sup>486</sup>, kryesisht të rajonit dhe konform një plani. Gjithashtu maturantët informohen për kriteret e pranimit dhe kërkesat për t'u regjistruar<sup>487</sup>. Maturantëve iu jepet mundësia të takohen dhe me stafin akademik të programit të studimit për të cilin kanë interes. Informacione të gjera mbi programet e studimit janë gjithashtu në dispozicion në internet<sup>488</sup>.</p> <p>Institucioni angazhohet përmes një sërë formash në promovimin e programit dhe realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në UAMD Format<sup>489</sup> me të cilat realizohen informimi në lidhje me kriteret e përgjithshme/të veçanta, për t'u regjistruar në programin e "Psikologjisë", janë të shumta, përveç atyre të kërkesës për informim zyrtare edhe në forma të tjera si këshillimi në ambjentet e kampusit<sup>490</sup>, dërgimi i ftesave në emaillet, rrjete sociale<sup>491</sup> etj.</p> |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>            | <p>Kriteret edhe për kandidatët e kategorive të marginalizuara si dhe atyre me aftësi të veçanta apo pakicave e trojeve për vitin akademik pasardhës hartohen nga Departamenti dhe miratohen nga Senati Akdemik sipas kuotave dhe procedurave përkatëse<sup>492</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>  | <p>Referuar ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati shqyrton dhe miraton kriteret e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë<sup>493</sup>,<sup>494</sup> për të interesuarit nga shtetet e tjera, dhe i pasqyron këto informacione edhe në faqen zyrtare duke i mundësuar aksesin kujtdo që është i interesuar në çdo kohë. Për vitin akademik 2022-2023 në këtë program kuotat e parashikuar shpallen dhe bëhen publike, por nga vizita në institucion informohemi se nuk ka interes nga studentë të ardhur nga shtete të tjera.</p>   |

<sup>486</sup> Evidencë-57-Shembuj Publikimesh në Facebook për Procedura të Studimit Psikologji .pdf

<sup>487</sup> Evidencë-99-Të Dhënat nga Website-i i UAMD-së .pdf

<sup>488</sup> <https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/>

<sup>489</sup> Evidenca-96-Programi i Transparencës UAMD.pdf

<sup>490</sup> Evidencë-99-Të Dhënat nga Website-i i UAMD-së .pdf

<sup>491</sup> Evidencë-57-Shembuj Publikimesh në Facebook për Procedura të Studimit Psikologji .pdf

<sup>492</sup> Evidenca-55-Vendim Senati për Shpërndarjen e Kuotave në Ciklet e Studimit UAMD.pdf

<sup>493</sup> Evidenca-54-Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studentëve (1).pdf

<sup>494</sup> Evidenca-55-Vendim Senati për Shpërndarjen e Kuotave në Ciklet e Studimit UAMD.pdf



|  |   |                              |                             |   |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|---|
| <p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p> | <p>Institucioni ka të përfshirë në rregulloren e tij edhe politikat për ndihmimin e studentëve për shtresat e margjinalizuara ekonomikisht për përfitimin e ndihmës së tyre për të rritur cilësinë e pranimit në programin e Bch në psikologji për zhvillimin ekonomik të vendit. Në DVV gjenden Vendime<sup>495</sup> pwr rimbursim tarifash dhe ule pagesash dhe rastet që përfitojnë ulje nga tarifa vjetore e shkollimit si student të shkëlqyer, student me rezultate dhe kërkesave me kriteret të tjera. Nga vizita në institucion u informuam se studentët të cilët i përkisnin shtresave në nevojë të shoqërisë apo ishin ekselentë përfitonin bursa studimi.</p> |                              |                             |   |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>GVJ gjykon se bazuar në evidencat e mësipërme dhe disa aspekteve që lidhen me komponentëve mësimore me të cilat po punohet për t'i përafruar me ligjet në fuqi, nisur nga angazhimi i njësisë bazë, gjykojmë se në tërësinë e tij ky standard <u>përmbushet plotësisht.</u></i></p>   |                              |                             |   |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p>Nuk përmbushet</p>   | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

#### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve  |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> | <p>Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e institucionit<sup>496</sup>. Në faqen web<sup>497</sup> dhe në aktet rregullative të universitetit gjendet informacion i plotë dhe i qartë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. (Neni 17 i Rregullores së programit të studimit Psikologji normon se studenti nuk e kalon vitin pasardhës në qoftë se nuk shlyen 50% të krediteve).</p> <p>GVJ konfirmion se studentët ishin të informuar mbi detyrimet e përgjithshme të programit të studimit si dhe për detyrimet specifike për çdo lëndë nga pedagogu përgjegjës.</p> |

<sup>495</sup> Evidencë-124- Vendimet për tarifën dhe pagesat studentore.pdf

<sup>496</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf; Evidencë-10-Rregullore Departamenti Psikologjisë.pdf; Evidencë-13-Rregullore Bachelor Psikologji.pdf;

Evidenca-7-Rregullore FE.pdf

<sup>497</sup> <https://uamd.edu.al/studentet-dhe-kerkimi-shkencor/>




|  |   |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>      | <p>Për të gjithë studentët e rinj të regjistruar realizohet procesi i pritjes dhe orientimit të kandidatëve, i cili është i përvitshëm në UAMD<sup>498</sup>. Gjatë kësaj jave në hollin e institucionit vendosen vende pritje realizohen takime për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të institucionit. Në aktet normative gjenden dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme<sup>499</sup>. Në çdo lëndë apo modul janë përcaktuar qartë të gjitha informacionet që lidhen me procedurat që ndjek institucioni për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentit<sup>500</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> | <p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuar në të gjithë njësinë e rregulloreve të UAMD-së, dhe specifikisht gjenden edhe në rregulloren e programit të studimit<sup>501</sup>, kreu III “Vlerësimi i studentit”, gjithashtu edhe në rregulloret e tjera të IAL-së<sup>502</sup>, si dhe në syllabusin e çdo lëndë<sup>503</sup> studentët njihen edhe me mënyrën e vlerësimit në çdo lëndë. Transparenca<sup>504</sup> e marrëdhënieve mes stafit dhe studentëve rregullohet dhe me një urdhër të Rektores së UAMD-së. Pedagogu i lëndës, por edhe njëzia bazë përmes strukturave të saj informon studentët e programit të studimit përgjatë fazës së parë të regjistrimit, fillimit të semestrit, në javën orientues në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve. GVJ në takimin me studentët konfirmoi që gjatë javës orientuese studentët e vitit të parë informohen në detaje rreth programit të studimit, përfshirë kriteret dhe procedurat për vlerësimin e njohurive dhe aftësive. Ky informim është i vijueshëm edhe gjatë lëndëve të veçanta, gjithashtu ata konfirmojnë se edhe procesi i adresimit të shqetësimeve të ndryshme mbi vlerësimin ishte shumë i qartë për ta.</p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe</p>                             | <p>Kriteret dhe procedurat e diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e studimeve të UAMD<sup>505</sup>-së, konkretisht në nenet 75-78 si dhe në korpusin tjetër rregullativ, deri në atë të programit (neni 21). Departamenti gjithashtu ka miratuar dhe mbështetet në rregulloren e diplomimit<sup>506</sup> ku</p>  |

<sup>498</sup> Evidencë-29-Java e Orientimit dhe Guida e Studentit.pdf

<sup>499</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf, neni 54-56

<sup>500</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.pdf

<sup>501</sup> Evidencë-13-Rregullore Bachelor Psikologji.pdf

<sup>502</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf; Evidencë-13-Rregullore Bachelor Psikologji.pdf;

Evidenca-7-Rregullore FE.pdf

<sup>503</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjise.pdf

<sup>504</sup> Evidenca-70-Urdhër Rektorati mbi Transparencën e Marrëdhënies Student-Pedagog.pdf

<sup>505</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf

<sup>506</sup> Evidencë-122-Rregullore Diplomimi Departamenti i Psikologjisë.pdf

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| diplomimit në programin e studimit.  | specifikohen edhe modalitetet që nga përzgjedhja e temës dhe e udhëheqësit tëk struktura e temës dhe vlersimi i diplomës, për të mbështetur studentët. Udhëzimi në lidhje me stukturën e temës së diplomës u vihen në dispozicion studentëve në fillim të vitit të tretë. Fazat kohore të mbrojtjes së diplomës përmes provimit me shkrim ose verbalish bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Monitorimin e këtyre procedurave që lidhen me diplomimin e realizojnë si pedagogu i lëndës, koordinatori dhe drejtuesi i njësisë bazë.  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Institucioni ndjek politika që synojnë reklamimin dhe promovimin e tij në vazhdimësi <sup>507</sup> . Në lidhje me tërheqjen e studentëve të rinj <sup>508</sup> çdo fillim vitit akademik UAMD organizon grupe pune, të cilët informojnë studentët me programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët, për t'i ndihmuar ata në vendimarrje. Format si; njoftimet në faqen zyrtare të web <sup>509</sup> , rrjetet sociale, standat e Universitetit dhe guidës së studentit ndërmerren me qëllim tërheqjen e studentëve të interesuar UAMD ka hartar dhe broshura informimi <sup>510</sup> |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>   | <i>GVJ konfirmon se UAMD ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit psikologji të gjithë informacionin e nevojshëm mbi pranimin, programin, vlerësimet dhe kriteret për kalueshmërinë deri në formatin e diplomimit.</i>   |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve   |
|---|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe | Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, listën e programeve dhe të lëndëve, tarifatat e studimit, si dhe parakushtet e lëndëve |

<sup>507</sup> Evidencë-108-Shembuj Aktivitete Promovuese Departamenti Psikologjisë.pdf

<sup>508</sup> Evidencë-106-Urdhër Rektori për promovimin e UAMD tek maturantët 2023.pdf

<sup>509</sup> Evidencë-99-Të Dhënat nga Website-i i UAMD-së .pdf

<sup>510</sup> Evidencë-107-Broshurë Promovimi UAMD.pdf

|   |   |
|---|---|
| <p>kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>  | <p>gjenden në faqen web<sup>511</sup> të universitetit sëbashku me rubrikën Transparenca. Studentët që pranohen në programin e studimit informohen gjatë javës së parë mbi kërkesat dhe kriteret universitare, kohëzgjatjen maksimale të periudhës së studimeve; ndërsa në fillim të çdo viti akademik të tre vitet e studimit informohen hollësisht mbi detyrimet akademike, kohëzgjatjen e programit të studimit dhe periudhën e provimeve. Ndërsa informacioni mbi organigramën e Fakultetit, strukturën e departamentit dhe veprimtarinë e tij, detaje mbi programin e studimit janë të publikuara dhe përditësuara në faqet nw internet tw institucionit. GVJ konfirmoi sa më sipër gjatë takimit me stafin dhe me studentët.</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ-së, iu konfirmua që studentët njihen që ditën e parë me rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit. Nëpërmjet faqes web<sup>512</sup>, gjatë fazës së regjistrimit, gjatë ditëve të orientimit, takimeve informuese me stafin dhe pedagogët, studentët marrin çdo informacion të nevojshëm në lidhje kurrikulën dhe programin e studimit (lëndët), regjistrimet, orarin dhe provimet, regjistrimi për provime dhe vlerësimet e notat përkatëse. Informacion i detajuar për çdo lëndë ju jepet nga pedagogu i lëndës nëpërmjet komunikimit me e-mail ose dhe formafin hard-copy në ditën e parë të prezantimit të syllabusit<sup>513</sup> me informacione specifike për temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.. GVJ e konfirmoi këtë gjatë takimeve që realizoi me stafin dhe studentët.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>                   | <p>Institucioni ka në dispozicion të nevojave profesionale të studentëve një sër zyrash që bashkërendojnë punën me njëra tjetrën si, Zyrën e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës<sup>514</sup> e cila përveç këshillimit të karrirës realizon dhe trajnime e seminarët ndryshme, por dhe panairin e punës dhe informimin për mundësi punësimi<sup>515</sup>. Gjithashtu, kjo zyrë ka hartuar edhe Udhëzuesin e Karrierës, i cili iu vjen në ndihmë studentëve dhe alumnit në procesin e kërkimit dhe aplikimit për punë. Informacioni dhe ushtrimet në të iu vlejné atyre edhe për t'u përgatitur për këshillimin e personalizuar nga këshilluesit e karrierës në UAMD. Vlen të përmendet fakti se studentët e ciklit Bachelor në Psikologji nuk mund të punësohen në këtë</p>   |

<sup>511</sup> <https://uamd.edu.al/>

<sup>512</sup> <https://uamd.edu.al/orari/> ; <https://uamd.edu.al/transparenca/>

<sup>513</sup> Evidencë-37-Silabuset Bachelor Psikologji 2022-2023. Dpt Psikologjiise.pdf

<sup>514</sup> <https://uamd.edu.al/karriera/>

<sup>515</sup> Evidencë-26-Rregullore e Sektorit te Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.pdf

|   |  |
|---|--|
|   | <p>profesion pas përfundimit të studimeve Bachelor, pasi Psikologu është një profesion i rregulluar me ligj, dhe punësimi në profesion ndodh pas përfundimit të dy cikleve të njëpasnjëshme të studimit, sërish institucioni i qëndron pranë studentëve për t'i informuar hap pas hapi.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>Në dispozicion të studentëve është një nga sistemet IT më të mira përsa i përket të gjithë procesit të menaxhimit universitar,<sup>516</sup> sistemi PITAGORA<sup>517</sup>, i cili i siguron akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, aksesit plotë në informacionin, detyrimet dhe literaturën e lëndëve që ndjekin. Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta dhe kështu mund të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë rocesin aakdemik. Aksesit në këtë platform bëhet nëpërmjet kredencialeve të cilat ju jepen studentëve sapo fitojnë status student nga Zyra IT<sup>518</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>           | <p>Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit përmes platformës së menaxhimit të sistemit mësimor "PITAGORA"<sup>519</sup> që përdoret për çështjet akademike të studentëve, si regjistrimi, menaxhimi i studentëve, stafi akademik, degët e studimit, lëndët, syllabuset e lëndëve, materialet e studimit, oraret mësimore, provimet, pagesat studentore, komunikime e njoftime të ndryshme etj. Gjithahtu edhe platforma Google classroom me të gjithë aplikacionet e saj është gjithashtu e aplikueshme nga pedagogët, si një latforë e cila mundëson me shumë mundësi ndërveprimi. Vlen të theksohet se aksesit në internet por edhe në sistemet e sipërcituara është i garantuar nga internet në mjediset e universitetit dhe nga aksesit palimit në kompjuterat e vënë në dispozicion të studentëve në bibliotekën, e cila ndodhet gjithashtu në mjediset e fakultetit. Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Gjatë vizitës në institucion, nga takimi me stafin akademik por edhe grupin e punës na u referua se çdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, të cilët mund ta</p> |

<sup>516</sup> <https://uamd.edu.al/pitagora/>

<sup>517</sup> Evidenca-91-Manuali i Përdorimit të Pitagorës nga Personeli Akademik.pdf

<sup>518</sup> Evidenca-90-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.pdf

<sup>519</sup> Evidenca-93- Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH).pdf




|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në institucion. Për të rritur kanalet e komunikimit, për të qënë sa më praktikë dhe bashkëkohor, përveç kanaleve zyrtare si faqja web e institucionit <sup>520</sup> , <sup>521</sup> dhe komunikimet zyrtare, edhe platformat sociale <sup>522</sup> gjithastu janë përdorur si platforma të aksesueshme e transparente mbi publikimin e informacionit. |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>                         | <i>GVJ konfirmon se studentët ishin të informuar mbi objektivat formues të secilës lëndë; kishin informacion të plotë e të hollësishëm për, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, por nuk kishin informacione përsa i përket studimeve mbi tregun dhe mundësitë e punësimit.</i>   |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
|---|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore edhe mbi numrin e studentëve të diplomuar dhe cilësinë në dalje. Referuar <i>tab.nr.21 të RVB</i> <sup>523</sup> për 3 vitet e fundit akademike konstatohet se numri i studentëve të regjistruar është relativisht me trend rritje të konsiderueshme, kjo në analizë të situatës së përgjithshme të rënies së numrit të studentëve që vijnë në studimet në universitetet në vend. GVJ vizitoi Sekretarinë mësimore ku mbahen rregjistrat në lidhje me rregjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është më i ulët sesa kuotat e miratuara. Sipas drejtuesve të njësisë bazë dhe njësisë kryesore në këtë trend ka ndikuar situata e përgjishme e numrit të studentëve në vend, kryesisht emigracioni. Ndërkohë mesatarja në hyrje ka qënë mbi 8.1 në |

<sup>520</sup> Evidencë-99-Të Dhënat nga Website-i i UAMD-së .pdf

<sup>521</sup> Evidenca-96-Programi i Transparencës UAMD.pdf

<sup>522</sup> Evidencë-57-Shembuj Publikimesh në Facebook për Procedura të Studimit Psikologji .pdf;

Evidencë-97-Shembuj aktivitetesh të Publikuara në Facebook Departamenti i Psikologjisë.pdf;

Evidenca-101-Të Dhëna nga faqja Facebook e FE .pdf

<sup>523</sup> Evidencë-120-Tabela e Numrit të Studentëve FE 2019 2023.pdf; Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf

|  |  |
|--|--|
|  | <p>të tre vitet e fundit akademike. Gjatë vizitës në institucion u vërejtën se sekretaria mësimore administronte, rregjistrin themeltar të studentëve të rregjistruar dhe të transferuar si dhe rregjistrin e arritjeve akademike me lëndë të zgjedhura rastësisht dhe nuk vërejtë rubrika të paplotësuara apo parregullësi në administrimin e tyre.</p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> | <p>Institucioni disponon statistika<sup>524</sup> për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në Bachelor në “Psikologji”<sup>525</sup>, në respektim të kuadrit ligjor e rregullativ. GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet e fundit akademike ishte:</p> <p>Viti 2022-2023 51 studentë, (Nota mesatare H 8.27)<sup>526</sup>;</p> <p>Viti 2021-2022 42 studentë, (Nota mesatare H 8.3); me 2 studentë të çrregjistruar</p> <p>Viti 2020-2021 32 studentë, (Nota mesatare H 8.11);</p> <p>Viti 2019-2020 28 studentë;</p> <p>Viti 2018-2019 44 studentë;</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar në programin BA Psikologji për 3 vitet e fundit akademike është 125 nga të cilët vetëm 1 është student i transferuar. Këto të dhëna janë në formë të shkruar dhe ruhen në Sekretarinë e Fakultetit në mënyrë konfidenciale.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>  | <p>Zyra që merret me regjistrimin e studentëve<sup>527</sup>, sekretaria mësimore<sup>528</sup> janë strukturat e posaçme që merren me ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave statistikore nga hyrja deri në dalje. Punën e tyre e kryejnë edhe përmes Portalit studentor që përdoret për menaxhimin e rekordeve të studentëve e realizojnë edhe përmes sistemit informatik të regjistrave dhe arkivave të të dhënave të plota. Këto të dhëna disponohen për të gjithë studentët e universitetit dhe janë të sigurta, pasi sistemi është pjesë e RASH, i cili garanton sigurinë, si dhe në të kanë akses vetëm personat e autorizuar..</p>   |

<sup>524</sup> Evidencë-20-Tabelat ASCAL.pdf; Evidencë-65-Raportë Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.pdf;

<sup>525</sup> Evidencë-92-Rregullore e Sekretarise.pdf

<sup>526</sup> Evidencë-53-Mesataret hyrëse dhe dalëse Departament i Psikologjisë.docx.pdf

<sup>527</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf

<sup>528</sup> Evidencë-92-Rregullore e Sekretarise.pdf




|   |  |
|---|--|
|   | <p>Studenti ka dosjen personale, e cila ka të gjitha të dhënat që janë marrë në fazën e regjistrimit dhe vazhdojnë të përditësohen në vijim përgjatë viteve të studimit. Personat e autorizuar mbështeten në sistemin informatik për të gjeneruar statistika mbi studentët në mënyrë të shpejtë dhe të saktë.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> | <p>Institucioni ka hartuar një sërë dokumentesh që favorizojnë kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin e sekretarive mësimore si dhe sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit si dhe vlerëson e dokumenton gjendjen dhe saktësinë e dokumentacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtaritë e tyre<sup>529, 530, 531, 532</sup>.</p> <p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kishin akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njësive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. GVJ bëri verifikime të të dhënave të studentëve të rregjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi mangësi.</p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>  | <p>Njësia bazë harton raporte analitike dhe periodike vjetore ku ndër të tjera pika trajton edhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Gjithastu edhe mënyra se si informohen studentët e interesuar kryesisht për puënsimin është rregulluar; edhe aftësimi i tyre për tregun e punës është në vëmendje të institucionit. Të dhënat statistikore mbi mesataren janë lehtësisht të aksesueshme nga sistemi i menaxhimit dhe vëmendje e shtuar duhet ti tregihet në nivel institucional masave që duhet të marren për përmirësimin e treguesve. Për këto ka evidenca si<sup>533, 534, 535</sup>.</p> <p>GVJ konfirmon se institucioni ka sistem për menaxhimin e të dhënave dhe sekretaria mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të detajuara në lidhje me studentët, vlerësimet</p> |

<sup>529</sup> Evidenca-7-Rregullore FE.pdf

<sup>530</sup> Evidenca-90-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.pdf

<sup>531</sup> Evidenca-98-Rregullore për Arshivimin e Dokumentacionit.pdf

<sup>532</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>533</sup> Evidencë-65-Raporte Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.pdf

<sup>534</sup> Evidencë-26-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.pdf

<sup>535</sup> Evidencë-45-Informacion mbi punësimin e studentëve Alumni FE 2021-2022.pdf



|   |   |                             |                            |                             |
|---|---|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
|   | dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit “Psikologji”. Të dhënat ruhen edhe në rregjistra të posaçëm nga pranimi dhe rregjistrimi në programin e studimit deri në diplomimin e tyre, gjithashtu institucioni disponon të dhëna edhe për punësimin e studentëve.  |                             |                            |                             |
| <b>Konkluzione</b>                        | <p><i>GVJ gjykon se bazuar në evidencat e mësipërme, gjykojmë se në tërësinë e tij ky standard <b>përbushet plotësisht</b>.</i></p> <p><i>Institucioni i arsimit të lartë, UAMD angazhohet në mbledhjen, administrimin, përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave të plota në lidhje me studentët që ndjekin programin e studimit, duke përfshirë fazat nga pranimi deri në diplomim, si dhe informacionin e punësimit të tyre. GVJ, duke u bazuar në evidencat e paraqitura, vlerëson se ky standard <b>përbushet plotësisht</b>, dëshmuar nga përkushtimi dhe efikasiteti i institucionit në menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe pasqyrimi i tyre i plotë nëpërmjet këtij procesi.</i></p> |                             |                            |                             |
| <b>Shkalla e përbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përbushet</b>  | <b>Përbushet pjesërisht</b> | <b>Përbushet kryesisht</b> | <b>Përbushet plotësisht</b> |
|   |   |                             |                            | X                           |

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
|---|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre <sup>536</sup> në organet vendimmarrëse <sup>537</sup> si Senatit Akademik, komisionin për garantimin e standarteve dhe cilësisë, GVB <sup>538</sup> , këshillin e etikës, si dhe në këshillin e studentëve <sup>539</sup> , i cili është grupim i studentëve dhe për zgjedh përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UAMD-së <sup>540</sup> . Përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është e përcaktuar në sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore, në statusin <sup>541</sup> e vetë institucionit. |

<sup>536</sup> Evidenca-7-Rregullore FE.pdf – Kreu X; Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf; Evidencë-10-Rregullore Departamenti Psikologjisë.pdf

<sup>537</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>538</sup> Evidencë-21-Vendim Dekanati për Krijimin e GVB-ve mbi akreditimin e Programeve FE.pdf

<sup>539</sup> Evidencë-105-Këshillat studentorë UAMD 2022.pdf

<sup>540</sup> Evidencë-26-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.pdf

<sup>541</sup> Evidencë-2- Statuti UAMD 2018.pdf



|   |   |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>                                  | <p>Në të gjitha strukturat dhe sektorët apo zyrat në të cilat përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e studentëve<sup>542</sup>. Ato janë pjesë aktive e mbedhjeve të senatit akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë<sup>543</sup>, dhe janë në brendësi të punës së tyre në këtë veprimtari<sup>544</sup>. Studentët janë të përfshirë në grupime studentore në lidhje me fushën e studimit dhe sipas interesave personale. Studentët janë të përfshirë në grupime të ndryshme studentore. Në lidhje me vlerësimin e stafit akademik studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogut përmes pyetësorëve<sup>545</sup> dhe përmes takimeve në grup.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p> | <p>Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe është e gatshme të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre<sup>546</sup>. Është në praktikën e kërrij departamenti dhe në përvojën e deritanishme të realizojë takime dhe fokus grupe<sup>547</sup> me studentët për të nxitur përfshirjen e tyre në proceset akademike ekstrakurrikulare. Nëpërmjet pedagogëve mentorë studentëve ju është dhënë një mundësi me tepër për t'u shprehur dhe për të dhënë sygjerimet dhe kontributin e tyre për përmirësimin e e programit të studimit<sup>548</sup>. Vlen të theksohet fakti se ky program studimi nuk ka shumë vite që është hapur dhe në përgjithësi drejtimi psikologji është relativisht i ri në vendin tonë, ndaj gjykohet se është herët për të vlerësuar këtë aspekt edhe pse takimi me kordinatorët e programit nxit dhe sygjerimet dhe mundësitë për përmirësim<sup>549</sup>. Një tjetër aspekt që lidhet me përfshirjen e tyre janë dhe ftesat për takime për aktivitetet të ndryshme, të cilat gjithashtu një forum i hapur kontributi i të gjithë aktorëve<sup>550</sup>.</p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë</p>   | <p>Rregulloret e brendshme të programit të studimit “Psikologji” si dhe ato të IAL-së ju mundësojnë studentëve një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve</p>   |

<sup>542</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>543</sup> Evidencë-21-Vendim Dekanati për Krijimin e GVB-ve mbi akreditimin e Programeve FE.pdf

<sup>544</sup> Evidencë-5-Kodi i Etikës UAMD.pdf

<sup>545</sup> Evidencë-48-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit nga studentët.pdf


<sup>546</sup> Evidencë-48-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit nga studentët.pdf

<sup>547</sup> Evidencë-145-Shembull Fokus Grup me Studentë Bachelor Psikologji për Cilësinë e Mësimdhënies.pdf

<sup>548</sup> Evidencë-58-Shembull i Ndarjes së Mentorimit në Departamentin e Psikologjisë.pdf

<sup>549</sup> Evidencë-133-Përcaktimi koordinorëve të programeve të studimit Departamenti Psikologji.pdf

<sup>550</sup> Evidencë-78-Kalendari i Aktiviteteve të Departamentit Psikologjisë 2022-2023 (2).pdf; Evidencë-79- Model thirrje për konferencë FE .pdf; Evidencë-97-Shembuj aktivitetesh të Publikuara në Facebook Departamenti i Psikologjisë.pdf

|  |  |                             |                            |                             |
|--|--|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | duke shtuar përdorimin e teknologjisë edhe në vlerësimin dhe kontrollin e dijeve <sup>551</sup> . Në drejtim të ndershmërisë së kryerjes së procesit janë sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu <sup>552</sup> , zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm. Studentët kanë mundësi të parashtrojnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës apo nëpërmjet faqes web të IAL ( <a href="https://uamd.edu.al/sherbimet-qe-ofrohen-nga-ap/">https://uamd.edu.al/sherbimet-qe-ofrohen-nga-ap/</a> ). |                             |                            |                             |
| <b>Konkluzione</b>   | <i>GVJ konstatoi se institucioni kishte ndërtuar kuadrin rregullator për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese, dhe nga takimi me studentë u evidentuan raste kur ata ishin të përfshirë në procesin e hartimit, miratimit, rishikimit apo të përmirësimit të programit të studimit "Psikologji" bazuar në evidencat e mësipërme, ky standard <b>përbushet plotësisht</b>.</i>  |                             |                            |                             |
| <b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përbushet</b>   | <b>Përbushet pjesërisht</b> | <b>Përbushet kryesisht</b> | <b>Përbushet plotësisht</b> |
|  |  |                             |                            | <b>X</b>                    |

#### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
|--|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | UAMD ka krijuar strukturën e vet <sup>553</sup> , e cila u siguron studentëve mbështetjen e nevojshme akademike, duke vënë në dispozicion burimet dhe plotëson kërkesat që iu duhen për të pasur sukses në universitet (Sekretaritetë, Zyra e IT, Zyra e Financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI). Statuti <sup>554</sup> dhe rregulloret <sup>555</sup> e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore. Në |

<sup>551</sup> Evidencë-146-Shembull Tabelë e rezultateve të studentëve me CleanScore.pdf

<sup>552</sup> Evidencë-69-Shembull i formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti.pdf

<sup>553</sup> Evidenca-8-Struktura e UAMD 2018.pdf

<sup>554</sup> Evidencë-2- Statuti UAMD 2018.pdf

<sup>555</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf; Evidenca-7-Rregullore FE.pdf; Evidencë-10-Rregullore Departamenti Psikologjisë.pdf

|   |  |
|---|--|
|   | <p>godinën e fakultetit të edukimit ka njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit ndaj studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve siç është Njësia Bazë, Zyra e çështjeve studentore dhe ajo Alumni, apo dhe Mentorët e studentëve<sup>556</sup>. Këto struktura ofrojnë një sër shërbimesh për studentët përgjatë të gjitha fazave të studimit në UAMD dhe vijnë edhe pas përfundimit të studimeve përmes shërbimeve që këto zyra ofrojnë për alumnit e saj<sup>557</sup>. Strukturat në shërbim të studentëve nga hyrja në dalje, të informimit, trajnimit dhe mbështetjes në punësim janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe kjo konfirmohet edhe nga vetë studentët në takimin që u realizuar me ta dhe me studentët alumni.</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>                      | <p>Njësia Bazë<sup>558</sup>, Mentorët<sup>559</sup>, dhe Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës<sup>560</sup> janë zyra të posaçme që mbulojnë shërbimet që ju nevojiten studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. UAMD funksionin mbi një strategji të miratuar komunikimi<sup>561</sup> duke aplikuar dhe standartet më të lart të transparencës<sup>562</sup>. Megjithatë Zyra e Komunikimit Alumnit dhe Karrierës është përgjegjëse specifike për komunikimin, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe vijnë bashkëpunimet e mëtejshme me ta përmes mbështetjes së Alumnit në lidhje me trajnime, intershipe dhe ofertave të punës.</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit</p> | <p>Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës<sup>563</sup>, nëpërmjet sektorit të karrierës dhe alumnit, i cili jo vetëm mban kontakte dhe krijon rrjetin alumni të UAMD-së, por organizon edhe aktivitetet dhe krijon bashkëpunimet e duhura për të diplomuarit e këtij institucioni. Punonjësit e kësaj zyre mirëpresin studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin</p>  |

<sup>556</sup> Evidenca-59-Mbi Organizimin e Tutorialit të Mentorimit në UAMD .pdf; Evidencë-26-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.pdf; Evidencë-92-Rregullore e Sekretarise.pdf

<sup>557</sup> Evidencë-26-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.pdf

<sup>558</sup> Evidencë-10-Rregullore Departamenti Psikologjisë.pdf

<sup>559</sup> Evidenca-59-Mbi Organizimin e Tutorialit të Mentorimit në UAMD .pdf

<sup>560</sup> Evidencë-26-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.pdf

<sup>561</sup> Evidencë-104-Strategjia e Komunikimit UAMD.pdf

<sup>562</sup> Evidenca-96-Programi i Transparencës UAMD.pdf

<sup>563</sup> Evidencë-26-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.pdf




|   |   |
|---|---|
| <p>mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>  | <p>në tregun e punës. Sektori<sup>564</sup> është në shërbim të studentëve<sup>565</sup> duke ofruar informacion në lidhje me mundësitë e punësimit, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Zyra<sup>566</sup> organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, takime periodike për të marrë mendime, ndarë eksperiencë në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës. Këto aktivitete<sup>567</sup> orientojnë studentët në përzgjedhjen e profilit, dhe më pas në lehtësimin e përzgjedhjes së institucioneve të zhvillimit të praktikës profesionale në linjë me programin e studimit. Seminare të hapura, lektorë të ftuar janë pjesë e promovimit të profesioneve të ndryshme për studentët e saj<sup>568</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p> | <p>Sektori i Komunikimit, Alumni dhe Karrierës<sup>569</sup> është një strukturë e ngritur, e cila funksionon në bazë të statutit të UAMD-së, që ka si objektiv të punës së saj mbështetjen e studentëve përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe më tej përgjatë viteve të punësimit. Shpesh luan një rol të rëndësishëm në orientimin e studentit drejt mundësive të punësimit, por edhe në drejtim të ofrimit të këshillimit për karrierën me qëllim vlersimin më objektiv të mundësive që student ka në dispozicion. Kjo zyrë vendos kontakte me Alumnit e UAMD-së me qëllim gjurmimin dhe mbledhjen e informacioneve mbi punësimin e tyre e duke evidentuar rastet e suksesit si dhe duke i ardhur në ndihmë atyre që janë të papunë për t'i informuar mbi mundësi punësimi dhe praktikash<sup>570</sup> si dhe Ftesën për Alumnit e suksesshëm për të zhvilluar orë të hapura leksioni apo seminaresh për studentët ku të tregojnë mbi eksperiencat e tyre profesionale dhe karrierën e tyre të suksesshme<sup>571</sup>.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u mundësua dhe takimi me studentë alumbi të këtij programi, të cilët vijonin të mbanin kontakte me këtë departamenti dhe ishin pjesë aktive e aktiviteteve që zhvilloheshin.</p> |

<sup>564</sup> Evidencë-26-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.pdf

<sup>565</sup> Evidencë-29-Java e Orientimit dhe Guida e Studentit.pdf

<sup>566</sup> Evidencë-80-Trajnim për Studentë Zyra e Karrierës UAMD.pdf; Evidencë-105-Këshillat studentorë UAMD 2022.pdf

<sup>567</sup> Evidencë-142-Takim Alumni Departamenti i Psikologjisë, 2023.pdf

<sup>568</sup> Evidencë-63-Udhëzues i Karrierës UAMD.pdf

<sup>569</sup> Evidencë-26-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.pdf

<sup>570</sup> Evidencë-66-DATABAZË PUNËSIMESH ALUMNI UAMD.pdf

<sup>571</sup> Evidencë-62-Shembull Aktiviteti Alumni UAMD.pdf




|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <i>GVJ konstatoi se UAMD-ja ka të sanksionuara procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Specifikisht procedurat për asistimin e studentëve të sanksionuara në rregulloret e institucionit janë orientuar tek Sektori i Kominikimit, Alumnit dhe Karrierës, i cili është duke vijuar punën, për orientimin dhe këshillimin e studentëve dhe për të cilët ka vlerësime pozitive nga vetë studentët</i> |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>                         | <i>GVJ gjykon se bazuar në evidencat e mësipërme ky standard <u>përmbushet plotësisht</u>.<br/><br/>UAMD ka implementuar procedura dhe njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin, dhe menaxhimin e ankimimeve dhe problematikave, duke siguruar një veprimtari të përhershme dhe lehtësisht të arritshme për studentët. Bazuar në evidencat e paraqitura, GVJ vlerëson se ky standard <u>përmbushet plotësisht</u>.</i>   |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

|   |                       |                              |                             |                              |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |                       |                              |                             | X                            |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

|   |  |
|---|--|
| <b>Standardi VI.1</b>   |  |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b> |  |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të                                   | Në raport me politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit kemi disa element të dallueshëm lidhur me korrektësinë e institucionit në raport me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si strukturë mbështetëse e UAMD-së. Institucioni ka miratur Komisionin e Përhershëm të Garantimit |

|  |   |
|--|---|
| <p>fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>  | <p>të Standarteve dhe Cilësisë, i cili është një komision i përhershëm që do të drejtojë këtë proces, ku janë përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme dhe një student<sup>572</sup>. Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë: - Senati Akademik - Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC) -Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DKSC)/Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL) - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC) Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti) - Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.) - Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc.) Këto struktura e realizojnë punën e tyre duke u mbështetur në një dokument të rëndësishëm për funksionimin siç është Rregullorja për Funksionimin dhe Sigurimin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë<sup>573</sup>. Gjithashtu, institucioni ka hartuar edhe disa dokumente të tjera të cilat qartësojnë dhe rritin procesin e cilësisë së mësimdhënies<sup>574, 575, 576</sup>.</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p> | <p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPGSC) është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision ndjek përmirësimin e cilësisë në UAMD, duke shërbyer si një garanci e shtuar në kuadrin e SBSC. KPGSC, në rolin e një komisioni të përhershëm, kërkon në mënyrë të vazhdueshme informacione dhe raporte lidhur me çështjet e cilësisë dhe programeve të studimit nga NjSBC. Kjo e fundit, ka si funksion kryesor bashkëpunimin dhe asistimin e këtij Komisioni. KPGSC mbikëqyr dhe pranon raportet 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga NjSBC dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm. DKSC mund të përcjellë sipas rastit, apo pas kërkesës së KPGSC dokumentacione apo informacione të ndryshme që zotërohen nga Drejtoria. Kjo njësi ka autonomi</p>  |

<sup>572</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>573</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>574</sup> Evidencë-50-Vlerësimi i Performancës së mësimdhënies nga Kolegu apo Eprori Departamenti Psikologjisë.pdf

<sup>575</sup> Evidencë-73-Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të personelit akademik dhe njësiv.pdf

<sup>576</sup> Evidencë-145-Shembull Fokus Grup me Studentë Bachelor Psikologji për Cilësinë e Mësimdhënies.pdf




|   |   |
|---|---|
|   | <p>operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit, ajo organizon punën në bashkëpunim me njësitë bazë, për kontrollin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes rregullores të saj<sup>577</sup> të veprimit synon kryesisht vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të institucionit (UAMD), vlerësimin të cilësisë së programeve të studimit, vlerësimin e cilësisë së studentëve, vlerësimin e cilësisë së personelit që për këto qëllime të realizojë monitorim të vazhdueshëm të punës së stafit akademik dhe administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët. Pjesë e këtyre veprimtarive do të jenë zyra e burimeve njerëzore, njësisë për kërkimin shkencor, departamentet dhe zyra e kujdesit për studentët, zyra e karrierës, kordinatorët dhe senati akademik<sup>578579</sup>.</p> <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se në strategjinë e zhvillimit institucional ka politika që synojnë përmirësimin e cilësisë për programin e studimit. Departamenti i plotëson raportin e vlerësimin të programit. Në këtë raport paraqiten të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshme të realizuara, planet për ndryshimet dhe përmirësimet në të ardhmen, feedbacku i marrë nga studentët, nga personeli akademik i përfshirë në programin e studimit, të dhëna mbi ecurinë e studentëve etj<sup>580</sup>.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p> | <p>UAMD lidhur me këtë standard realizon çdo semestër, apo çdo fundviti akademik, një sërë veprimtarish si vlerësimi i pedagogut nga studenti<sup>581</sup>, trajtimi i ankesave të studentëve si dhe vetëvlerësimi i performancës së personelit akademik si nga kolegët edhe nga drejtuesit<sup>582</sup>. Rezultatet e këtyre sondazheve iu vihen në dispozicion drejtuesit të njësisë kryesore dhe përgjegjësit të departamentit me qëllim reflektimin për të ardhmen. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe ai i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se</p>  |

<sup>577</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf


<sup>578</sup> Evidenca-81-Formulari i Vetëvlerësimin të Personelit Akademik, 2019.pdf

<sup>579</sup> Evidencë-68-Formulari i Vlerësimin të Stafit Akademik nga Studentët.pdf

<sup>580</sup> Evidencë-18- Rezultatet mbi Anketimin e Studentëve, Stafit Akademik dhe Administrativ mbi Institucionin.pdf

<sup>581</sup> Evidencë-48-Formulari i Vlerësimin të Programit të Studimit nga studentët.pdf

<sup>582</sup> Evidencë-50-Vlerësimi i Performancës së mësimdhënies nga Kolegu apo Eprori Departamenti Psikologjisë.pdf






|  |  |
|--|--|
|  | <p>institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi ku përfshihen pyetësorët dhe fokus grupet e realizuara me studentët<sup>583</sup>. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program me qëllim përmirësimin e cilësisë. Vlerësohet puna e bërë nga institucioni në këtë drejtim<sup>584</sup>. Personeli akademik i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit nuk ushtron detyra në pozicione drejtuese në institucion dhe janë figura me integritet në njësinë bazë.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</b></p> | <p>Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente. Kuadri rregullator dhe politikat e institucionit<sup>585</sup> në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish të mbledhjes së informacionit në funksion të realizimit të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm<sup>586</sup>. Mekanizmat monitorues dhe kontrollues janë transparente dhe bëhen publike duke u evidentuar në faqen e UAMD-së<sup>587</sup>. Gjithashtu GVJ duke iu referuar dokumentacionit të dorëzuar si dhe vizitës në institucion, konstatohet se institucioni është i interesuar të vlerësojë cilësinë, ta raportojë atë por dhe të ruajë dhe respektojë të dhënat e privatësisë, lirinë dhe etikën akademike –profesionale. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente<sup>588</sup> dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e UniBa. Raportet nuk janë pasqyruar të plota dhe periodike<sup>589</sup> dhe justifikimi ishte për shkak të menaxhimit të faqes së web nga RASH dhe vështirësive teknike të përditësimit të saj.</p> |

<sup>583</sup> Evidencë-145-Shembull Fokus Grup me Studentë Bachelor Psikologji për Cilësinë e Mësimdhënies.pdf

<sup>584</sup> Evidenca-22-Komisioni i Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë FE UAMD.pdf; Evidencë-17-Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>585</sup> Evidenca-70-Urdhër Rektorati mbi Transparencën e Marrëdhënies Student-Pedagog.pdf

<sup>586</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>587</sup> <https://uamd.edu.al/mekanizmat-kontrollues-dhe-monitorues/>

<sup>588</sup> <chrome-extension://efaidnbmninnibpcapjpcglclefindmkaj/https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-2021-2022.pdf>,


<sup>589</sup> Shënime të mbajtura në vizitën në institucion




|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> | <p>Universiteti ka arritur të ngrerë një sërë mekanizmash për të promovuar shembujt më të mirë të studentëve që kanë studiuar në programe të ndryshme studimi në UAMD. Për këtë është përdorur faqja e web si dhe publikimet në media sociale dhe aktivitete që Departamenti ka realizuar. Në to paraqiten rastet e studentëve më ekselentë në programe të ndryshme studimi<sup>590</sup>. Nga ana tjetër, institucioni në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, krijon grupe përmes delegimit të përgjegjësisë, strukturave përgjegjëse dhe mbështet punën e grupit përgjatë kryerjes së detyrës. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit përdoret nga vet institucioni edhe për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Nga vizitat në institucion kërkua të na vihej në dispozicion preiodiciteti i vlerësimeve, takimet apo mbledhjet e realizuara në departament për të adresuar problematikat e evidentuara dhe si ishin marrë masat dhe cila ishte situata aktuale; por ende nuk kemi në dispozicion materialet dhe përmirësimet e realizuara.</p> |                              |                             |                              |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>GVJ gjykon sa me sipër se mbi bazën e të gjithë treguesve të paraqitur më lart kjo pikë e standardit të jetë <b><u>përmbushur kryesisht</u></b>.</i></p> <p><i>UAMD ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, duke hartuar udhëzues të posaçëm për zhvillimin e metodave dhe monitorimit. Megjithatë, ka nevojë për një angazhim më të madh në drejtim të prezantimit të gjetjeve dhe bërjes publike të rezultateve për të gjitha palet e interesuara. Kjo dëshmon se UAMD ka një strukturë dhe udhëzime të miratuara për monitorimin e cilësisë, por gjithashtu thekson nevojën për një transparencë dhe komunikim më të hapur në lidhje me rezultatet dhe përmirësimet e arritura në mësimdhënie. GVJ, duke u bazuar në të gjithë treguesit e paraqitur më lart, vlerëson se kjo pikë e standardit është <b><u>përmbushur kryesisht</u></b>.</i></p>  |                              |                             |                              |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p>Nuk përmbushet</p>   | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
|   |   |                              | X                           |                              |

|   |                                      |
|---|--------------------------------------|
| <p><b>Standardi VI.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b></p> |                                      |
| <p><b>Kriteret</b></p>  | <p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> |

<sup>590</sup> Evidencë-142-Takim Alumni Departamenti i Psikologjisë, 2023.pdf




|   |   |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>                            | <p>UAMD në raport me politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin<sup>591</sup> dhe rregulloren e institucionit ka ndërtuar disa element të dallueshëm lidhur me korrektësinë e institucionit në raport me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë<sup>592</sup> si strukturë mbështetëse e UAMD-së. Gjithashtu universiteti ka miratuar edhe planin e zhvillimit strategjik për zhvillimin sa më të strukturuar e transparent të tij<sup>593</sup>. Institucioni ka ndërtuar dhe Njësinë Bazë të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Edukimit<sup>594</sup>, i cili është një komision i përhershëm që do të drejtojë këtë strukturë, ku janë përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme. Struktura në fjalë e realizon punën e saj duke u mbështetur në një dokument të rëndësishëm për funksionimin e saj siç është Rregullorja për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë<sup>595</sup>.</p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> | <p>Misioni i Universiteti “Aleksandër Moisiu”, është të rris prestigjin dhe të sjell shkencë dhe punësim, nëpërmjet ofrimit të programeve të studimit në të tre ciklet e studimit, të studiuarit<sup>596</sup>. Plani strategjik i UAMD-së evidenton se universiteti është i përkushtuar për të siguruar cilësi dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet procedurave efektive menaxhimi dhe organizimi të strukturave, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike dhe kërkimore si edhe të veprimtarisë menaxheriale të Universitetit<sup>597</sup>. UAMD ka ndërtuar strukturat përbërëse të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe përgjegjësitë e secilit prej tyre, si në nivel institucional adhtu dhe në atë të njësisë kryesore<sup>598</sup>. Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: - Senati Akademik - Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC) - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DKSC)/Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL) - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC)</p> |

<sup>591</sup> Evidenca-8-Struktura e UAMD 2018.pdf

<sup>592</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>593</sup> Evidencë-3-Plani Strategjik UAMD 2020-2025\_.pdf

<sup>594</sup> Evidenca-22-Komisioni i Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë FE UAMD.pdf

<sup>595</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>596</sup> Evidencë-3-Plani Strategjik UAMD 2020-2025\_.pdf

<sup>597</sup> Evidencë-12-Plani Strategjik Departamenti Psikologjisë 2020-25.pdf ; Evidencë-3-Plani Strategjik UAMD 2020-2025\_.pdf

<sup>598</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf



|  |  |
|--|--|
|  | <p>Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti) - Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.) - Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc.) Struktura e Njësive e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë është njësi e pavarur në nivel institucional që ka si qëllim monitorimin, vlerësimin, dhe zhvillimin e përmirësimit e cilësisë së veprimtarisë së UAMD-së. Ligji për Arsimin e Lartë përcakton krijimin e një Njësie për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NjBSC) për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e kërkesave arsimore. Në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD) rolin e NjBSC-së e realizon DKSC-ja. Politikat që ndjek FE për sigurimin e cilësisë së brendshme Sistemi i brendshëm i menaxhimit të cilësisë sigurohet nëpërmjet: • Strukturave organizative të UAMD dhe FE. • Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (GSBC) në UAMD. • Grupi për vlerësimin e brendshëm të cilësisë (GVBC) të Fakultetit të Edukimit.<sup>599</sup></p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p> | <p>Institucioni ka aplikuar për akreditim për programin e studimit në ASCAL konform rregullave në fuqi në vendin tonë<sup>600</sup>. Ka ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për përmbushjen dhe plotësimin e procedurave të akreditimit<sup>601</sup>. ASCAL ka ngritur grupin e punës, i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit për këtë program studimi, por jo vetëm<sup>602</sup>. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se UAMD i ka kushtuar një rëndësi të veçantë rekrutimit të stafit akademik dhe është duke i mbështetur ata me financime për avancimin në arritje me tituj e grada shkencore<sup>603</sup>. Për sigurimin e cilësisë institucioni përdor instrumentet e ndryshme si pyetësorë me studentët, stafin akademik, takimet në grup për të garantuar ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë<sup>604</sup> nëse është e nevojshme.</p>  |

<sup>599</sup> Evidencë-19-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë\_së Brendshme, FE.pdf


<sup>600</sup> RVB Bachelor Psikologji.pdf

<sup>601</sup> Evidencë-21-Vendim Dekanati për Krijimin e GVB-ve mbi akreditimin e Programeve FE.pdf

<sup>602</sup> Urdhër Për përcaktimin e eksperteve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti Aleksander Moisiu Durrës.

<sup>603</sup> Evidenca-82-Vendim i Senatit Akademik nr.32 mbi Menaxhimin e Fondit Bazë të Kërkimit Shkencor nga Njësia.pdf

<sup>604</sup> Evidencë-145-Shembull Fokus Grup me Studentë Bachelor Psikologji për Cilësinë e Mësimdhënies.pdf




|   |   |                              |                             |  |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|--|
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p> | <p>Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes organizimit të saj<sup>605</sup> të veprimit synon që për këto qëllime të realizojë monitorim të vazhdueshëm të punës së stafit akademik dhe administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin<sup>606</sup> përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët. Pjesë e këtyre veprimtarive do të jenë zyra e burimeve njerëzore, njësisë për kërkimin shkencor, departamentet dhe zyra e kujdesit për studentët, zyra e karrierës, kordinatorët dhe senati akademik<sup>607</sup>. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se në strategjinë e zhvillimit institucional<sup>608</sup> ka politika që synojnë përmirësimin e cilësisë për programin e studimit. Departamenti i plotëson raportin e vlerësimit të programit. Në këtë raport paraqiten të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshme të realizuara, planet për ndryshimet dhe përmirësime në të ardhmen, feedbacku i marrë nga studentët, nga personeli akademik i përfshirë në programin e studimit, të dhëna mbi ecurinë e studentëve, etj<sup>609</sup>.</p> |                              |                             |  |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><b><u>GVJ gjykon se bazuar në evidencat e mësipërme ky standard përmbushet plotësisht.</u></b></p> <p><i>Në konkluzion, Institucioni i arsimit të lartë UAMD demonstroi një përkushtim të qëndrueshëm ndaj sigurimit të cilësisë së programit të studimit, përmes hartimit dhe zbatimit të politikave dhe procedurave transparente. Analiza e evidencave nga GVJ konfirmon se ky standard përmbushet plotësisht, reflektuar në angazhimin e institucionit për të ndjekjen e procedurave të akreditimit për programin e studimit.</i></p>   |                              |                             |  |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p>Nuk përmbushet</p>   | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p> |

**Standardi VI.3**

<sup>605</sup> <https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/>

<sup>606</sup> Evidencë-31-Strategjia e Ndërkombëtarizimit UAMD.pdf

<sup>607</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funkionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>608</sup> Evidencë-23-Plani Strategjik Bachelor Psikologji 2020-2025 .pdf

<sup>609</sup> Evidencë-65-Raporte Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.pdf




**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve  |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> | <p>GVJ evidenton se komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë, një komision që ngrihet e funksionon në nivel institucional dhe funksionon si organ kolegjal<sup>610</sup> monitoron punën e departamentit dhe stafit akademik përmes aktiviteteve mbikëqyrëse në lidhje me vlersimin e përputhshmërisë së silabuseve e me standardet e institucionit<sup>611</sup> për lëndët që zhvilloheshin në programet e studimit. NjBSC në nivel Fakulteti, realizon në mënyrë autonome objektivat dhe masat e vendosura nga NjBSC në nivel institucional. Në realizimin e këtyre objektivave NjBSC në nivel Fakulteti kërkon dosjen e programeve të studimit nga koordinatorët e programeve. Në realizimin e objektivave të akreditimit NjBSC në nivel Fakulteti bashkëpunon me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit, duke u koordinuar nga NjBSC në nivel Institucional. Dokumentacioni i NjBSC në nivel Fakulteti i përcillet Dekanit dhe NjBSC në nivel Institucional<sup>612</sup>.</p> <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, por edhe në një sërë dokumentash që tregojnë anagazhimin e institucionit<sup>613</sup> në hartimin e një plani strategjik<sup>614</sup>, i cili bazohet në investimin në cilësinë e mësimdhënies, me qëllim që procesi i transferimit të dijeve të jetë gjithnjë e më i harmonizuar me njohuritë më të përparuara kombëtare dhe ndërkombëtare; në favorizimin e metodologjive të reja dhe mësimdhënia inovative, që e pozicionojnë studentin në qendër të procesit duke inkurajuar të menduarin kritik, përgatitjen për tregun e punës dhe promovimin e dialogut student-pedagog; si dhe në krijimin e një modeli të përmirësuar të garantimit të cilësisë së mësimdhënies. Konstatohet se institucioni për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit angazhon titullarët, lektorët e lëndëve dhe asistent-lektorët në azhurnimin e syllabuseve në përputhje me ligjet në fuqi. Në</p> |

<sup>610</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>611</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>613</sup> Evidencë-78-Kalendari i Aktiviteteve të Departamentit Psikologjisë 2022-2023 (2).pdf

<sup>614</sup> Evidencë-3-Plani Strategjik UAMD 2020-2025 .pdf

|  |   |
|--|---|
|  | <p>DVV evidentohet vetëm një raport vlerësimi<sup>615</sup>, ku dokumentohet se rezultatet e vlerësimit (mungon periodizciteti) dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> | <p>Theksohet se njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë<sup>616</sup> përmes Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pas realizimit të procesit monitorues, i propozon Senatit akademik për miratim instrumentat e cilësisë, format e publikimit të rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit, si dhe i propozon për miratim Senatit Akademik raportin e brendshëm të cilësisë së institucionit<sup>617618</sup>. Kjo nënkupton që departamentet mund të argumentojë dhe qartësojnë disa aspekte që lidhen me konstatimet e këtij komisioni. GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni dokumenton në formë shkresore rezultatet dhe raportet e vlerësimeve<sup>619</sup>. Procedura që ndiqet është e tillë që pas përfundimit dhe mbledhjes së të dhënave informacioni / raporti i dërgohet Rektoratit dhe çdo njësie bazë me qëllim marrjen e masave për përmirësim të mundshme në të ardhmen. Këto diskutohen dhe në mbledhje të Senatit Akademik. GVJ nga informacioni i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion<sup>620</sup> konstaton se formati i raporteve të vlerësimit përfshin të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të</p>   | <p>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion por dhe atë të aksesueshëm lehtësisht nga faqja web e institucionit<sup>621</sup> në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, IAL përdor metoda të drejtpërdrejta<sup>622</sup>, rishikim të raporteve të akreditimit</p>   |

<sup>615</sup> Evidencë-36-Raport vjetor Fakulteti i Edukimit 2018-2019.pdf

<sup>616</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funkionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>617</sup> Evidencë-6-Raport Vjetor UAMD 2021-2022.pdf

<sup>618</sup> <https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/> (Relacion i NJSBC. (SHKARKO)

<sup>619</sup> Evidencë-65-Raportet Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.pdf

<sup>620</sup> Evidencë-65-Raportet Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.pdf

<sup>621</sup> <https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/> (Pyetësor mbi mësimdhënien online. (SHKARKO)

<sup>622</sup> Evidenca-59-Mbi Organizimin e Tutorialit të Mentorimit në UAMD .pdf




|  |  |
|--|--|
| <p>drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> | <p>të programeve të mëparshme<sup>623</sup>, shkrimi i raporteve të programeve të reja, ngritjen<sup>624</sup> dhe trajnimin e grupeve të punës<sup>625</sup>. Grupi i punës në kryerjen e vlerësimit bazohet në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të syllabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësimit të pedagogëve<sup>626</sup>, studentwve<sup>627</sup> si dhe përmes vlerësimeve paralele<sup>628</sup> të provimeve apo detyrave të studentëve. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, u konstatua se institucioni për kryerjen e vlerësimit<sup>629</sup>, përdor metoda e instrumente të ndryshme të tilla si: pyetësori i studentëve, mentorimet e studentwve<sup>630</sup>, takimet në grup<sup>631</sup> që zhvillohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Instrumentat janë të hartuara në mënyrë të tillë që masin dhe vlerësojnë të gjithë komponentët e programit të studimit<sup>632</sup>. Për të realizuar vlerësimin e programit “Psikologji” përdoren disa metoda të drejtpërdrejta si vlerësimi i cilësisë së programit<sup>633</sup> e provimeve, vëzhgimet në auditor nga titullarët e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, rishikimi periodik i programit, vlerësimi i arritjeve në mësimdhënie, vlerësimi i arritjeve të studentëve.</p> <p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, apo në dokumentacionin e shqyrtuar në DVV konstaton se ndër metodat e drejtpërdrejta të përdorura nga institucioni përfshihen vlerësimet e drejtpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare<sup>634</sup>, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore për secilën lëndë si dhe rishikimit të kurrikulave në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës apo edhe kërkesave të personelit akademik apo studentëve. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit</p> |
|--|--|

<sup>623</sup> Evidencë-65-Raporte Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.pdf

<sup>624</sup> Evidencë-133-Përcaktimi koordinatorëve të programeve të studimit Departamenti Psikologji.pdf

<sup>625</sup> Evidencë-112-Urdhër nr.20 për Ndryshimin dhe Përshtatjen e Kurrikulave, FE.pdf

<sup>626</sup> Evidencë-69-Shembull i formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti.pdf

<sup>627</sup> Evidencë-68-Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët.pdf

<sup>628</sup> Evidencë-146-Shembull Tabelë e rezultateve të studentëve me CleanScore.pdf

<sup>629</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>630</sup> Evidencë-58-Shembull i Ndarjes së Mentorimit në Departamentin e Psikologjisë.pdf

<sup>631</sup> Evidencë-145-Shembull Fokus Grup me Studentë Bachelor Psikologji për Cilësinë e Mësimdhënies.pdf

<sup>632</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>633</sup> Evidencë-48-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit nga studentët.pdf

<sup>634</sup> Evidencë-53-Mesataret hyrëse dhe dalëse Departament i Psikologjisë.docx.pdf



|  |  |
|--|--|
|  | <p>përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të silabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësim të didaktikës përmes vlerësimit të stafit akademik nga një koleg me tituj, si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve.</p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p> | <p>UAMD në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit “Psikologji” realizon çdo semestër një sërë veprimtarish si vlerësimi i pedagogut nga studenti, relacioni për monitorimin e silabuseve, ankesat e studentëve si dhe vetëvlerësimi i performancës së personelit akademik<sup>635</sup>. Këto sondazhe i vihen në dispozicion përgjegjësit të departamentit me qëllim reflektimin për të ardhmen. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi ku përfshihen pyetësorët dhe fokus grupet e realizuara me studentët<sup>636</sup> të cilat zhvillohen në baza periodike dy herë në vit pyetësorë dhe një herë në vit fokus grupe. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program me qëllim përmirësimin e cilësisë. Vlerësohet puna e bërë nga institucioni në këtë drejtim.</p> |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><b><u>GVJ gjykon se bazuar në evidencat e mësipërme ky standard përmbushet plotësisht.</u></b></p> <p><i>UAMD përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, duke përfshirë mësimdhënien, stafin akademik dhe vlerësimet e studentëve. GVJ konstaton se institucioni ka ndërmarrë metoda të</i></p>   |

<sup>635</sup> Evidencë-68-Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët.pdf; Evidencë-48-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit nga studentët.pdf; Evidencë-143-Pyetësor për vlerësimin e praktikës mësimore nga studentët Departamenti Psikologji.pdf; Evidencë-50-Vlerësimi i Performancës së mësimdhënies nga Kolegu apo Eprori Departamenti Psikologjisë.pdf; Evidencë-130-Vlerësimi i mbikëqyrësit për praktikantin Bachelor Psikologji.pdf; Evidencë-141-Pyetësor për marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet për praktikat profesionale dhe .pdf; Evidencë-144-Anketim me Përfaqësues të Institucioneve që kanë Marrëveshje me Departamentin Psikologji.pdf; Evidencë-30-Pyetësor për Alumni UAMD.pdf

<sup>636</sup> Evidencë-145-Shembull Fokus Grup me Studentë Bachelor Psikologji për Cilësinë e Mësimdhënies.pdf

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <i>përshatshme të vlerësimit, duke përfshirë sondazhe, intervista dhe vlerësime të ndryshme për të përmirësuar cilësinë. Bazuar në evidencat, GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | X                            |

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
|--|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | GVJ konstaton se institucioni përpiqet të parashikojë dhe garantojë politika dhe procedura që sigurojnë rritjen e brendshme të cilësisë <sup>637</sup> , kjo duke përfshirë edhe aktorë të brendshëm <sup>638</sup> dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit <sup>639</sup> . Nga informacioni i paraqitur në DVV dhe në raportin e GVB-së, si dhe në atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni garanton dhe bashkëpunon me ekspertë të jashtëm duke ruajtur dhe mbajtur në konsideratë përmirësimin e vazhdueshëm të parametrave të cilësisë. Për këtë ekzistojnë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit <sup>640</sup> që departamenti ka me institucione dhe organizata me të cilat bashkëpunon. |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe   | GVJ konkludon se referuar rregullores për funksionimin e brendshëm të cilësisë <sup>641</sup> dhe përmes shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga informacioni i paraqitur në DVV dhe atë të siguruar në takimet gjatë vizitës në institucion, detyrat dhe përgjegjësitë konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të përfshira në çështjet e cilësisë janë të parashikuara në kuadrin rregullor <sup>642</sup> të cilësië. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë përmes   |

<sup>637</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>638</sup> Evidencë-133-Përcaktimi koordinatorëve të programeve të studimit Departamenti Psikologji.pdf

<sup>639</sup> Evidenca-123-Marrëveshje Bashkëpunimi për Programin Erasmus, UAMD.pdf

<sup>640</sup> Evidencë-129-Marrëveshje Departamenti Psikologji.pdf

<sup>641</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>642</sup> Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf; Evidencë-10-Rregullore Departamenti Psikologjisë.pdf; Evidenca-7-Rregullore FE.pdf

|   |  |
|---|--|
| <p>garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>  | <p>aktiviteteve që ndërmerr, që nga ngritja e grupit të punës së vlerësimit të brendshëm dhe aktiviteteve të tjera synon të garantojë sigurimin e cilësisë. Për arritjen e këtij qëllimi janë angazhuar në realizimin e projekteve koordinatori i projektit, grupi i punës nga institucioni me anëtarë të cilët janë të profileve dhe mbulojnë punën në struktura të ndryshme si zyra e kurrikulës, komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë, njësia për kërkimin shkencor dhe angazhimin e anëtarëve të departamenteve dhe të studentëve sipas rastit dhe aktiviteteve në realizimin e detyrave të ndryshme.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p> | <p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit “Psikologji”, në përbërjen e grupit të vlerësimit të brendshëm janë të përfshirë anëtarë të personelit akademik<sup>643</sup> dhe studentë<sup>644</sup>. Departamenti është përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë përmes mbështetjes me informacione dhe akses në të gjitha dokumentat që disponon, grupit të vlerësimit të brendshëm. Personeli ndihmës akademik e administrativ ka mbështetur punën e grupit të vlerësimit të brendshëm përmes informacionit dhe statistikave që lehtësojnë procesin. Nga takimet në institucion me stafin akademik, administrativ, studentë, ata konfirmojnë se vetë ata realizojnë dhe janë pjesëmarrës në hartimin dhe plotësimin e pyetësorve dhe takime me studentët, ndërkohë që kjo evidentohet edhe në vlerësimin e strukturuar.</p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>   | <p>Kuadri rregullator dhe kodi i cilësisë<sup>645</sup> së këtij institucioni respekton integritetin akademik dhe shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve, duke garantuar pjesëmarrje të drejtë dhe sigurisht duke ju mundësuar instrument të adresimit të shqetësimeve<sup>646</sup>. Personeli akademik i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit<sup>647</sup> nuk ushtron detyra në pozicione drejtuese në institucion dhe janë figura me integritet në njësinë bazë. Gjithashtu edhe përfshirja e studentëve të nivelit bachelor në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve.</p>  |

<sup>643</sup> Evidencë-21-Vendim Dekanati për Krijimin e GVB-ve mbi akreditimin e Programeve FE.pdf

<sup>644</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funkionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>645</sup> Evidenca-61-Kodi i Cilësisë.pdf

<sup>646</sup> Evidencë-19-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, FE.pdf; Evidencë-17-Rregullore për Funkionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf; Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf; Evidencë-10-Rregullore Departamenti Psikologjisë.pdf; Evidenca-7-Rregullore FE.pdf

<sup>647</sup> Evidencë-21-Vendim Dekanati për Krijimin e GVB-ve mbi akreditimin e Programeve FE.pdf




|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> | <p>Pjesë aktive e procesit të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit Bachelor në “Psikologji” janë punonjës të UAMD. Në përbërjen e GVB janë vetëm anëtar të brendshëm të departamentit<sup>648</sup>. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm apo bashkëpunëtorëve të ndryshëm, me të cilët departamenti bashkëpunon është realizuar për procese të veçanta, siç është praktika<sup>649</sup>, apo bashkëpunimet me universitete dhe kolegë të bashkëpunimeve të huaja,<sup>650</sup>; <sup>651</sup>, dhe mund të ishte një mundësi e mirë edhe realizimi i vlerësimit të programit tërësor nga ekspertë të jashtëm, kjo për të siguruar pa anësinë për marrjen e vlerësimeve që do të përmirësonin cilësinë e këtij programi studimi dhe do të.</p> |                              |                             |                              |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><b><u>GVJ gjykon se bazuar në evidencat e mësipërme ky standard përmbushet plotësisht.</u></b></p> <p><i>GVJ vlerëson se detyrat dhe përgjegjësitë për cilësinë janë të parashikuara dhe ndërmarra në përputhje me rregulloren dhe dokumentacionin e paraqitur. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, përmes ngritjes së grupit të punës dhe aktiviteteve të tjera, synon të sigurojë cilësinë duke përfshirë studentët, koordinatorë, grupin e punës, dhe anëtarët e strukturave të ndryshme. GVJ, bazuar në evidencat e mësipërme, konkludon se ky standard për cilësi përmbushet plotësisht.</i></p>   |                              |                             |                              |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p>Nuk përmbushet</p>   | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
|   |   |                              |                             | X                            |


|   |   |
|---|---|
| <p><b>Standardi VI.5</b></p>  |   |
| <p><b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p> |   |
| <p><b>Kriteret</b></p>  | <p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>  |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe</p>   | <p>Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe të</p> |

<sup>648</sup> RVB Bachelor Psikologji.pdf

<sup>649</sup> Evidencë-141-Pyetësor për marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet për praktikant profesional dhe .pdf

<sup>650</sup> Evidencë-94-Marrëveshje Bashkëpunimi midis AADF dhe UAMD.pdf

<sup>651</sup> Evidenca-123-Marrëveshje Bashkëpunimi për Programin Erasmus, UAMD.pdf;




|  |  |
|--|--|
| <p>veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>                        | <p>drejtuara nga Kodi I Cilësisë<sup>652</sup>. Politikat e institucionit<sup>653</sup> në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish të mbledhjes së informacionit në funksion të realizimit të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm<sup>654</sup>. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e UAMD<sup>655</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> | <p>GVJ duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB<sup>656</sup>, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se institucioni është i interesuar të ruajë dhe respektojë të dhënat e privatësisë, lirinë dhe etikën akademike –profesionale. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente<sup>657</sup> dhe bëhen publike, por ishte e pamundur nga ana jnë të evidentoheshin në faqen ëeb të UAMD-së. Raportet të cilat na u vunë në dispozicion edhe në vizitën në institucion janë pasqyruar të plota pa ndërhyrje në shmangien e dajles së të dhënave për personat që janë pjesë e të dhënave që kanë kontribuar në drejtim të mësimdhënies në këtë program studimi këto vite, megjithatë të dhënat personale të stafit akademik japin informacion mbi kualifikimin e titujt që mbajnë, nuk evidenca që na japin mundësi të gjykojmë mbi çënimin e lirisë për të dhënat personale.</p> <p><i>GVJ sygjeron që meqë ky program akreditohet për herë të parë, nuk mund të gjenden raportet e mëparshme, ndërsa përsa i përket raporteve të tjera periodike dhe analizave të punës së departamentit, të shihet mundësia e publikimit të tyre, sigurisht duke mbajtur në konsideratë mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim që aktorët e interesuar të kanë mundësi të njihen me këto raporte.</i></p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e</p>   | <p>GVJ konstaton se UAMD sigurohet që raportet dhe rezultatet e vetëvlerësimit të programit të përfshijnë edhe të dhëna mbi masat e marra, mbështetur kjo në dokumentacionin e dorëzuar si RVB<sup>658</sup> dhe gjatë vizitës në institucion. Institucioni në këto dokumenta kryen dhe adresimin e masave që duhen analizuar dhe reflektuar<sup>659</sup>. Grupi i vlerësimit të brendshëm ka paraqitur</p>   |

<sup>652</sup> Evidenca-61-Kodi i Cilësisë.pdf

<sup>653</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>654</sup> <https://uamd.edu.al/transparenca/>

<sup>655</sup> <https://uamd.edu.al/vendime/>

<sup>656</sup> Evidencë-36-Raport vjetor Fakulteti i Edukimit 2018-2019.pdf; Evidencë-65-Raport Vjetore për Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore të Departamentit të Psikologjisë.pdf

<sup>657</sup> Evidencë-6-Raport Vjetor UAMD 2021-2022.pdf

<sup>658</sup> Evidencë-6-Raport Vjetor UAMD 2021-2022.pdf

<sup>659</sup> Evidencë-36-Raport vjetor Fakulteti i Edukimit 2018-2019.pdf




|  |  |                       |                      |                       |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| mangësive e dobësive të evidentuara.   | rezultatet e vlerësimit të tij për këtë program studimi. Në përmbyllje të raportit të tij ka një analizë mbi pikat e forta dhe afirmimet dhe pikat e dobëta. Ka një tendencë për t'u fokusuar në evidentimit e pikave të forta dhe afirmimet më tepër, dhe përse i përket sugjerimeve për masat që mund të ndërmerren në drejtim të pikave të dobëta mbeten të paqarta format sesi mund të ndihmohet njësia bazë dhe kryesore, por edhe institucioni për të përmirësuar ato në të ardhmen.   |                       |                      |                       |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.     | Institucioni në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë <sup>660</sup> , krijon grupin përmes delegimit të përgjegjësive, strukturave përgjegjëse dhe mbështet punën e grupit përgjatë kryerjes së detyrës. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit përdoret nga vet institucioni <sup>661</sup> për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Ashtu sic ndërmerren reagime nga ana e njësisë bazë në lidhje me pikat e dobëta të evidentuara nga grupi i vlerësimit të brendshëm   |                       |                      |                       |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Angazhimin e stafit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë e kërkon baza ligjore në funksion të cilësisë në mësimdhënie si edhe nga rregulloret <sup>662</sup> e UAMD dhe statuti <sup>663</sup> , një sër strukturash të ngritura me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë përfshijnë në përbërje të tyre (KSBC, GVB). Të gjitha këto struktura që monitorojnë dhe dokumentojnë gjetjet e tyre, i ndajnë me strukturat e tjera me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. |                       |                      |                       |
| <b>Konkluzione</b>   | <b><u>GVJ</u> gjykon se bazuar në evidencat e mësipërme ky standard përmbushet plotësisht.</b><br><i>Strukturat që monitorojnë dhe dokumentojnë gjetjet e tyre ndajnë informacionin me strukturat e tjera për të siguruar ndërgjegjësim dhe përmirësim afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. GVJ, bazuar në evidencat e mësipërme, vlerëson se ky standard për cilësi përmbushet plotësisht.</i>   |                       |                      |                       |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | Nuk përmbushet   | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |

<sup>660</sup> Evidenca-61-Kodi i Cilësisë.pdf

<sup>661</sup> Evidencë-17-Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf

<sup>662</sup> Evidencë-19-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë\_së Brendshme, FE.pdf; Evidencë-17-Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf; Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.pdf; Evidencë-10-Rregullore Departamenti Psikologjisë.pdf; Evidenca-7-Rregullore FE.pdf

<sup>663</sup> Evidencë-2- Statuti UAMD 2018.pdf




|  |  |  |  |          |
|--|--|--|--|----------|
|  |  |  |  | <b>X</b> |
|--|--|--|--|----------|

| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  |                       |                              |                             | <b>X</b>                     |

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" të Institucionit të Arsimit të Lartë Publik, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Praktika të mira, të ndërmarra nga institucioni në drejtim të përfshirjes së stafit akademik dhe studentëve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Gama e gjerë e marrëveshjeve të bashkëpunimit në drejtim të praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi.
3. Përfshirja e alumnit dhe supervizorëve të institucioneve të praktikës profesionale në vlerësimin e kurrikulës së këtij programi studimit.
4. Abonimi në bibliotekat online dhe platformat elektronike në funksion të procesit të mësimdhënies.
5. Literaturës Bazë për një pjesë të lëndëve mësimore është depozituar në sistemin elektronik Cobiss dhe e aksesueshme nga studentët online apo pranë bibliotekës së njësisë kryesore në cdo kohë.
6. Klima pozitive në komunikimin midis stafit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi.
7. Nxitja e shkëmbimeve në arsimin e lartë për stafin akademik dhe studentët, përmes Erasmus +

**Pika të dobta**

1. Personeli akademik i programit Bachelor në "Psikologji" edhe pse ka tituj akademikë dhe grade shkencore në përputhje me ligjet aktuale, megjithatë duke qenë nga profile të ndërmjetme, mund të ndodhin kufizime në ekspertizën e tyre në disiplinën e psikologjisë, që mund të ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe përmbushjen e objektivave programore.
2. Hartimin e një pjese të moduleve dhe lëndëve mësimore nga titullarë që i përkasin kategorisë Lektor i parë (Dr) dhe Asistent Lektor (Msc) mund të çënojnë cilësinë në mësimdhënë;
3. Disa mangësi në një pjesë të syllabuseve të lëndëve mësimore si, temat mësimore jashtë tipologjisë dhe emërtimit të lëndës, dublimi i temave mësimore në lëndë të ndryshme, dhe literatura bazë e para një dekade mund të çënojnë njohuritë dhe zhvillimin e kompetencave profesionale.







Rekomandimet e paraqitura më poshtë nga grupi i vlerësimit të jashtëm mbështeten te pikat e forta dhe mundësitë e institucionit, për të ndërhyrë dhe përmirësuar pikat e dobëta dhe pengesat në drejtim të konsolidimit dhe zhvillimit në linjë me standartet europiane të programit të studimit "Bachelor" në "Psikologji"

### **Rekomandime**

1. Përzgjedhja e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi duhet të jetë në një profil kualifikimi në psikologji, me qëllim që të jenë në gjendje të zhvillojnë kompetenca profesionale dhe shprehi pune tek studentët në linjë me profilin për të cilin po studiojnë.
2. Titullarët e angazhuar në hartimin e syllabuseve të lëndëve mësimore duhet t'i përkasin kategorisë "Profesor," në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, me qëllim që të ndihmojnë në sigurimin e cilësisë së lartë të mësimdhënies dhe në përmbushjen e detyrimeve ligjore për një kornizë akademike cilësore në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" në UAMD.
3. Njësinë bazë të rriste vëmendjen në drejtim të monitorimit të syllabuseve mësimore duke treguar kujdes në mënyrën sesi harmonizohen temat mësimore të trajtuara në lëndë të ndryshme në linjë me emërtimin e lëndës dhe fokusin e saj, gjithashtu përdorimi i literaturës në gjuhën shqipe dhe të huaj, të përfshijë disa element sigurie që ruajnë standartet e cilësisë së njohurive akademike që u ofrohen studentëve.



**Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle "Bachelor" in "Psychology ", of the Public Institution of Higher Education, "Aleksandër Moisiu" University, Durrës.**


**Strengths and affirmations:**

1. Good practices undertaken by the institution in terms of the involvement of academic staff and students in national and international projects.
2. The wide range of cooperation agreements in the direction of the professional practices of the students of this study program.
3. Involvement of alumni and supervisors of professional practice institutions in the evaluation of the curriculum of this study program.
4. Subscription to online libraries and electronic platforms in the function of the teaching process.
5. The basic literature for a part of the educational subjects is deposited in the Cobiss electronic system and accessible by students online or at the main university library at any time.
6. Positive climate in communication between academic staff and students of this study program.
7. Encouraging exchanges in higher education for academic staff and students, through Erasmus +

**Weaknesses:**

1. The academic staff of the Bachelor program in "Psychology" even though they have academic titles and scientific degrees in accordance with current laws, however, being from intermediate profiles, limitations may occur in their expertise in the discipline of psychology, which may affect the quality of teaching and the fulfillment of programmatic objectives.
2. The drafting of a part of the modules and educational subjects by holders of the category of First Lecturer (Dr) and Assistant Lecturer (Msc) can be done by any of them.
3. Some deficiencies in a part of the syllabuses of educational subjects such as educational topics outside of typology and nomenclature of subjects, duplicating educational topics in different subjects, and basic literature from a decade ago can affect knowledge and development of professional competencies.

**The recommendations presented below by the external evaluation team are based on the strengths and opportunities of the institution, to intervene and improve the weaknesses and obstacles toward consolidation and development in line with European standards of the study program "Bachelor" in " Psychology".**



**Recommendation:**

1. The selection of academic staff engaged in this study program must be based on a qualification profile in psychology, in order to be able to develop professional competencies and work habits in students in line with the profile for which they are studying.
2. The holders engaged in the drafting of the syllabuses of the educational programs must apply to the "Professor" category, in accordance with Law 80/2015 on Higher Education, with the aim of helping to ensure the high quality of teaching and fulfilling of legal obligations for a quality academic framework in the first cycle Bachelor's study program in "Psychology" at UAMD.
3. To increase the level of awareness in the direction of monitoring educational syllabuses by taking care of how the educational topics covered in different subjects are harmonized in line with the subject's name and its focus, as the use of literature in Albanian and foreign languages, to include some security elements that maintain the quality standards of academic knowledge offered to students.




**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT   | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS |                       |                      |                       |
|---|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|   | Nuk përmbushen                                 | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| <b>I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>   |  |                       |                      | X                     |
| <b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR</b>         |  |                       | X                    |                       |
| <b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>   |  |                       |                      | X                     |
| <b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b> |  |                       |                      | X                     |

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)




|  |  |  |  |          |
|--|--|--|--|----------|
| <b>V. STUDENTËT DHE<br/>MBËSHTETJA E<br/>TYRE</b>                                |  |  |  | <b>X</b> |
| <b>VI. SIGURIMI I<br/>CILËSISË SË<br/>PROGRAMIT TË<br/>STUDIMIT<br/>BACHELOR</b> |  |  |  | <b>X</b> |
| <b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>   |  |  |  | <b>X</b> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



